



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 shtator 2023  
Nr. ref.: AGJ 2262/23

## AKTGJYKIM

në

### rastet nr. KO216/22 dhe KO220/22

Parashtrues të kërkesës

KO216/22, Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;  
KO220/22, Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

### Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

### Parashtruesit e kërkesave

- Kërkesa KO216/22 është dorëzuar nga Isak Shabani, Bekim Haxhiu, Enver Hoxhaj, Hajdar Beqa, Ganimete Musliu, Eliza Hoxha, Ariana Musliu-Shoshi, Rashit Qalaj, Mergim Lushtaku, Hisen Berisha dhe Elmi Reçica, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), të cilët i përfaqëson Përparim Gruda.

2. Kërkesa KO220/22 është dorëzuar nga Arben Gashi, Doarsa Kica-Xhelili, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Kujtim Shala, Vlora Dumoshi, Rrezarta Krasniqi, Valentina Bunjaku Rexha, Lumir Abdixhiku dhe Besian Mustafa, deputetë të Kuvendit, të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK), të cilët i përfaqëson Shkëmb Manaj (në tekstin mëtejme të referuar bashkërisht si: parashtruesit e kërkesave).

### **Ligji i kontestuar**

3. Parashtruesit e kërkesës KO216/22 kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar) si dhe kushtetutshmërinë e neneve 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar, të miratuar me Vendimin e Kuvendit [nr. 08-V-454] të 22 dhjetorit 2022. Ndërsa, parashtruesit e kërkesës KO220/22, kontestojnë kushtetutshmërinë e nenit 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe paragrafit 2 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar, si dhe kërkojnë shpalljen e pavlefshme të tij në tërësi për shkak të shkeljeve procedurale gjatë votimit për miratimin e tij.

### **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar, për të cilën parashtruesit e kërkesave pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të saktësuara më lart të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesit e kërkesave pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
5. Përveç kësaj, (i) parashtruesit e kërkesës KO216/22, kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që Ligji i kontestuar të *“pezullohet ex-lege dhe nuk dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*; ndërsa (ii) parashtruesit e kërkesës KO220/16 kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme në lidhje me kërkesën e tyre pasi që do të mbrohej interesi publik, duke theksuar, mes tjerash, se *“mosvënia e masës së përkohshme do të kishte pasoja të pariparueshme për rreth 1600 nëpunësit civil të pozitave të nivelit të mesëm drejtues [...]”*.

### **Baza juridike**

6. Kërkesat bazohen në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe

43 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

7. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

### **Procedura në Gjykatë**

8. Më 30 dhjetor 2022, parashtruesit e kërkesave i dorëzuan kërkesat në Gjykatë.
9. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës KO216/22: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkua që të njoftojë deputetët e Kuvendit lidhur me kërkesën; dhe (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit. Këtyre të fundit i'u kërkua që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit, që përcakton: *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Presidentja dhe Kryetari i Kuvendit po ashtu u njoftuan se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 23 janar 2023; ndërsa Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit i'u kërkua që deri më 23 janar 2023, të dorëzojë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e kërkesës. Po ashtu, në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës KO216/22 edhe: (i) parashtruesit e kërkesës KO216/22; (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit); dhe (iv) Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Punëve të Brendshme ose MPB), të cilëve iu kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesit, nëse kanë, deri më 23 janar 2023.
10. Më 11 janar 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR.KSH KO216/22], për rastin KO216/22, caktoi gjyqtarin Enver Peci Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë). Po të njëjtën ditë, Kryetarja, për rastin KO220/22, përmes Vendimit [Nr. GJR.KSH KO220/22], caktoi gjyqtarin Radomir Laban, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
11. Më 13 janar 2023, Kryetarja, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [KO216/22 dhe KO220/22], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO220/22 me kërkesën KO216/22. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht atë KO216/22.
12. Më 16 janar 2023, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës KO220/22, bashkimin e kërkesave KO216/22 dhe KO220/22, si dhe Urdhrit për bashkim të tyre: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv)

- Kryeministrin; (v) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Avokatin e Popullit); si dhe (vii) Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilëve iu kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesat e bashkuara të parashtruesve, nëse kanë, deri më 30 janar 2023.
13. Më 19 janar 2023, Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: ZRRE), iu drejtua Gjykatës me komente përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  14. Më 20 janar 2023, Kuvendi ia dorëzoi Gjykatës dokumentacionin relevant përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  15. Më 23 janar 2023, Kryeministri dorëzoi komentet e tij përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  16. Më 30 janar 2023, Avokati i Popullit dorëzoi komentet e tij përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  17. Në të njëjtën ditë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejme: grupi parlamentar i LVV), përmes deputetit Valon Ramadani, dorëzoi komentet përkatëse përkitazi me Ligjin e kontestuar.
  18. Më 7 shkurt 2023, Gjykata njoftoi për pranimin e komenteve lidhur me kërkesat KO216/22 dhe KO220/22: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Kryeministrin; (v) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (vi) Avokatin e Popullit); si dhe (vii) Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilëve iu kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me komentet e pranuar, nëse kanë, deri më 14 shkurt 2023. Gjykata nuk pranoi komente nga palët brenda afatit të përcaktuar.
  19. Më 4 maj 2023, Gjykata iu drejtua Forumit të Komisionit të Venecias, me pyetjet vijuese lidhur me rastet KO216/22 dhe KO220/22:
    - a) *A parasheh korniza ligjore për shërbimin civil në vendin tuaj që për punësim për pozita specifike në shërbim civil/administratë shtetërore, përveç kualifikime të nevojshme siç janë shkollimi dhe përvoja e punës, të plotësojnë edhe kriterin e “përshtatshmërisë”? Nëse përgjigja në këtë pyetje është “Po”, pozitat specifike dhe vet definicioni i “përshtatshmërisë”, a përcaktohen me ligj të miratuar nga Parlamenti apo me akte nënligjore?;*
    - b) *Legjislacioni në vendin tuaj, a përcakton sistem të shërbimit civil të karrierës apo pozitës (post-based system)? Më konkretisht, zyrtarët publikë të nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët në vendin tuaj, a kanë mandat të përhershëm të punësimit apo mandat të caktuar kohor, pas së cilit nëse të njëjtit nuk rizgjidhen, e humbin pozitën në shërbim civil? Në këtë aspekt, a keni pasur praktikë kur një pozitë me mandat të përhershëm, përmes ligjit është transformuar në pozitë me mandat të caktuar kohor?;*
    - c) *Nëse vendi juaj ka kaluar reformë të administratës shtetërore duke kaluar prej sistemit të karrierës në atë të pozitës, si është rregulluar çështja e ndryshimit nga mandati i përhershëm në mandat me kohë të caktuar? Në rast të reformës, a i kanë humbur pozitën e tyre personat që janë prekur nga kjo reformë menjëherë apo pas një kohe të caktuar? Për pasojë, të njëjtit a e kanë humbur edhe statusin e zyrtarit publik/nëpunësit civil?; dhe*
    - d) *Gjithashtu, a ka gjykata juaj, praktikë relevante gjyqësore sa i përket çështjeve të lartcekura.”*

20. Ndërmjet 4 majit 2023 dhe 25 majit 2023, Gjykata ka pranuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) përgjigje nga gjykatat kushtetuese dhe ato ekuivalente të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, respektivisht nga: Gjykata Kushtetuese e Lihtejshtajnit, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë Hercegovinës, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë, Gjykata Kushtetuese e Austrisë, Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, Tribunali Kushtetues i Polonisë, Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, Këshilli Shtetëror i Holandës, Gjykata Supreme e Suedisë, Gjykata Kushtetuese e Kirgizisë dhe Gjykata Supreme e Meksikës.
21. Më 5 korrik 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga Gjyqtari raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
22. Më 2 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues lidhur me pranueshmërinë e kërkesave dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe shqyrtimin e saj në merita.
23. Po atë ditë Gjykata vendosi që: (i) njëzëri të deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, të konstatojë që procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iii) njëzëri, se kriteri i “*përshtatshmërisë*” i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iv) njëzëri, të konstatojë se formulimi “*si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre*” i pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (v) njëzëri, të konstatojë se formulimi “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*” i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (vi) njëzëri, të konstatojë se paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (vii) me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, të konstatojë se neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (viii) njëzëri, të konstatojë se paragrafi 6 i nenit 67 (Lista e pritjes) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (ix) njëzëri, të konstatojë se paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (x) njëzëri, të konstatojë se paragrafi 2 i nenit 104 (Shfuqizimi) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (xi) me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, të shpallë që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje: (a) pa formulimin “*përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo*” në paragrafin 2 dhe “*përshtatshmëria dhe/apo*” në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik); (b) pa formulimin “*si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre*” të pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe pa paragrafin 2 të nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe pa nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 të paragrafit 1 dhe pa paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike); (c) pa formulimin “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*” të paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës); (d) pa paragrafin 6 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe pa paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik); (e) pa paragrafin 6 të nenit 67 (Lista e pritjes); (f) pa paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare); dhe (g) pa paragrafin 2 të neni 104 (Shfuqizimi); (xii) me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, të urdhërojë, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, Kuvendin e Republikës së Kosovës, që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme: (a) për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; (b) për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; dhe (c) për plotësimin dhe ndryshimin e nenit 6 (Nëpunësja/i civil me status të veçantë) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në raport me Agjencitë e Pavarura sipas nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; dhe (xiii) njëzëri, të refuzojë kërkesën për masën e përkohshme.

## Përmbledhja e fakteve

24. Iniciativës për miratimin e Ligjit të kontestuar i kishte paraprirë Aktgjykimi i 9 korrikut 2020, i Gjykatës në rastin [KO203/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku u konstatua që nenet e caktuara të tij nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe që Kuvendi duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën III të dispozitivit të po këtij Aktgjykimi, përkatësisht atyre të saktësuara në kapitullin VII lidhur me Sistemin e Drejtësisë, kapitullin VIII lidhur me Gjykatën Kushtetuese dhe kapitullin XII lidhur me Institucionet e Pavarura.
25. Më 23 nëntor 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), në mbledhjen e saj të 109-të, me Vendimin Nr. 04/109, miratoi Projektligjin për Zyrtarët Publikë.
26. Më 24 nëntor 2022, Projektligji për Zyrtarët Publikë iu shpërnda deputetëve të Kuvendit për shqyrtim.

27. Më 2 dhjetor 2022, Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejme: Komisioni funksional), miratoi raportin e tij përkitazi me Projektligjin për Zyrtarët Publikë, duke i propozuar Kuvendit miratim e tij në parim.
28. Më 9 dhjetor 2022, Kuvendi, pas procedurës së leximit të parë, në prezencë të 62 (gjashtëdhjetë e dy) deputetëve, me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, e miratoi në parim, Projektligjin për Zyrtarët Publik.
29. Më 15 dhjetor 2022, Kuvendi përmes Vendimit [Nr. 08-V-449], vendosi që shqyrtimi i Projektligjit për Zyrtarët Publikë të bëhet në procedurë të përsheptuar në përputhje me nenin 123 (Shmangie nga Afatet Procedurale) të Rregullores së Kuvendit dhe ngarkoi Komisionin funksional si dhe Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsion; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Integrim Evropian; si dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (në tekstin e mëtejme: Komisionet e përhershme), që në afatet e përcaktuara në Vendim e lartcekur, përkatësisht deri më 21 dhjetor, në orën 12:00, të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.
30. Më 20 dhjetor 2022, Komisioni funksional, miratoi raportin e tij përkitazi me Projektligjin për Zyrtarët Publikë, duke i propozuar 13 (trembëdhjetë) amendamente në projektligjin në fjalë.
31. Më 20 dhe 21 dhjetor 2022, komisionet e përhershme përveç (i) Komisionit për Buxhet dhe Financa; dhe (ii) Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtuan projektligjin dhe amandamentet e propozuara dhe vlerësuan se të njëjtat janë pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, si dhe vlerësuan që çështjet e rregulluara në projektligjin në fjalë, nuk rregullohen me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
32. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e kishte shqyrtuar Projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, brenda afatit të përcaktuar me Vendimin e Kuvendit [Nr. 08-V-449] të 15 dhjetorit 2022.
33. Më 21 dhjetor 2022, raporti përfundimtar i Komisionit funksional, së bashku me 17 (shtatëmbëdhjetë) amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit, me rekomandimin që Projektligji për Zyrtarët Publikë, bashkë me amendamentet e propozuara të miratohet.
34. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se më 22 dhjetor 2022, në orën 9:00, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi projektligjin dhe amandamentet e propozuara dhe vlerësoi se të njëjtat nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
35. Në të njëjtën ditë, në orën 10:00, Kuvendi mbajti seancën plenare, me 64 (gjashtëdhjetë e katër) vota për, asnjë kundër dhe një (1) abstenim, e miratoi Ligjin e kontestuar.

## **Dispozitat e kontestuara të Ligjit Nr. 08/L-97 për Zyrтарët Publikë dhe dispozitat relevante të tij që ndërlidhen me ato të kontestuara**

### **Neni 2 Fusha e zbatimit**

- “1. Ky ligj zbatohet për zyrtaren/in publik në institucionin publik të Republikës së Kosovës.*
- 2. Përjashtimisht, marrëdhënia e punës së zyrtares/it publik rregullohet ndryshe, vetëm kur parashihet shprehimisht me këtë ligj.*
- 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.”*

### **Neni 3 Përjashtime nga fusha e zbatimit të ligjit**

- “1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim:*
- 1.1. të zgjedhurat/it;*
  - 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre;*
  - 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji;*
  - 1.4. të emëruarat/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitate përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji.*
- 2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë si në vijim:*
- 2.1. gjyqtaret/ët dhe prokuror/etët*
  - 2.2. personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo organizatës tjetër pasardhëse;*
  - 2.3. të punësuarat/it në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë;*
  - 2.4. të punësuarat/it në Policinë e Kosovës;*
  - 2.5. të punësuarat/it në Doganën e Kosovës;*
  - 2.7. të punësuarat/it në Njësinë për Inteligjencë Financiare;*
  - 2.8. drejtorin/in apo anëtarët/ët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatorë;*
  - 2.9. personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo komunës.”*

### **Neni 5 Kategoritë e zyrtares/it publik**

- “1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë:*
- 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil;*
  - 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik;*
  - 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artist dhe kulturës;*
  - 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe*
  - 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.*
- 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës*



së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë.

[...]

6. Zyrtarja/i i Kabinetit është zyrtarja/i publik që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, të Kryetares/it të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të Kryetares/it të Gjykatës Kushtetuese, Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, të Zëvendëskryeministres/it, të Ministres/it ose të titullares/it të institucionit të pavarur kushtetues, si dhe të Kryetares/it dhe nënkryetares/it të Komunës. Zyrtarja/i i kabinetit ushtron detyrën e udhëheqëses/it të kabinetit, si dhe stafit teknik dhe mbështetës të kabinetit. Statusin e zyrtares/it të kabinetit e kanë edhe nëpunëses/it të cilët ushtrojnë detyrat për nënkryetaren/in e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për grupin parlamentar”

## **Neni 6** **Nëpunësja/i civil me status të veçantë**

“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjese:

1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës;

1.2. anëtarët/et e shërbimit të jashtëm;

1.3. zyrtarët/et e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror;

1.4. anëtarët/et e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike;

1.5. të punësuarat/it në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjenci të saj;

1.6. të punësuarat/it në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e saj, përjashtimisht Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës;

1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës;

1.8. të punësuarat/it në Byrone Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim:

2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim;

2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj;

2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave;

2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional;

2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve;

2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë;

2.7. disiplinën dhe vlerësimin.

3. Në rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë.

4. Të punësuarat/it e administrates në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidentes, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.

5. Me rastin e krijimit të agjencive, institucioneve, funksioneve dhe pozitave të reja, institucioni publik në të cilin krijohet pozita e re, përjashtimisht Presidenten e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratë publike përcaktimin e

kategorisë së zyrtares/it publik për atë funksion, pozitë apo emërtesë në bazë të ekuivalencës.”

#### **Neni 7**

#### **Parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik**

“1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese.  
2. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it së kabinetit bëhet përmes emërimit të drejtpërdrejtë nga titullarja/i e kabinetit përkatës.”

#### **Neni 9**

#### **Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik**

“1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

2. Përrjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohet përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

[...]

5. Përshtatshmëria dhe/apo kriteret specifike shtesë për emërim në pozitë sipas këtij neni, për të punësuarat/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen nuk janë kriteret të detyrueshme për themelimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it të kabinetit.”

#### **Neni 12**

#### **Qeveria e Republikës së Kosovës**

“1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës:

- 1.1. miraton dhe koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre; dhe
- 1.2. miraton aktet nënligjore të autorizuarra për zbatim të këtij ligji.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjendjen e zyrtareve/ëve publik deri më 31 mars për çdo vit kalendarik, për vitin paraprak.

[...]”

### **Neni 13**

#### **Ministria përgjegjëse për administratë publike**

- “1. Ministria përgjegjëse për administratë publike ka këto përgjegjësi:*
- 1.1. harton, propozon, koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për zyrtarën/in publik;*
  - 1.2. mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për zyrtarët/et publik në institucionet e administratës shtetërore;*
  - 1.3. propozon dhe monitoron zbatimin e politikave për paga për zyrtarët/et publik dhe funksionarët/et publik;*
  - 1.4. mbështet dhe këshillon institucionet në zbatimin e këtij ligji;*
  - 1.5. përgatit deklaratë të perputhshmërisë me këtë ligj, për çdo projektakt të propozuar nga institucionet e tjera, që ka të bëjë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik;*
  - 1.6. organizon sipas planifikimit procedurat e pranimit për institucionet e administratës shtetërore në pajtim me këtë ligj;*
  - 1.7. planifikon, vendos dhe kryen sistemin e nëpunësëve/eve civil, të cilat/et kanë përfunduar mandatin, në pajtim me këtë ligj;*
  - 1.8. miraton dhe monitoron zbatimin e programeve të trajnimit për nëpunëset/it civil;*
  - 1.9. kërkon dhe merr nga institucionet e Republikës së Kosovës çdo informacion të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës;*
  - 1.10. administron dhe mirëmban Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;*
  - 1.11. harton dhe miraton udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtarët/et publik;*
  - 1.12. harton politikat e angazhimit të praktikantëve/eve në administratën publike;*
  - 1.13. harton planin e përgjithshëm të personelit;*
  - 1.14. përgatit dhe publikon raportin vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore.*
- 2. Ministria përgjegjëse për administratë publike themelon njësi administrative përgjegjëse që ushtron kompetencat e dhëna me këtë ligj.*
- 3. Përgjegjësite e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.9. të këtij neni, për aq sa kanë të bëjnë me nëpunësen/in në shërbimit publik, kryhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për politikat shtetërore për shërbimin përkatës publik.*
- 4. Çdo institucion që merr në punë zyrtarë/e publik, si dhe çdo funksionarë/e publik dhe zyrtarë/e publik, që ka kompetenca menaxheriale vendimmarrëse, ose që ka informacion në këtë fushë, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për administratë publike.*
- 5. Ministria përgjegjëse për administratë publike është i vetmi institucion i administratës shtetërore që ka kompetencë për të ofruar shpjegime lidhur me përcaktimet e këtij ligji.”*

### **Neni 15**

#### **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

*“Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është organ i pavarur, që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil sipas Kushtetutës dhe Ligjit përkatës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.”*

### **Neni 19**

#### **Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore**

*“[...]*

4. Çdo institucion publik është i obliguar që të gjitha veprimet dhe procedurat lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore t'i kryejë përmes SIMBNj. Presidenca e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Sistemi i Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, shfrytëzojnë SIMBNj- në, por vet administrojnë me modulet që krijohen për institucionin e tyre.

[...]

7. Rregullat për përmbajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e SIMBNj-së, miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për administratë publike, duke respektuar pavarësinë kushtetuese.”

### **Neni 27**

#### **E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës**

“1. Zyrtarja/ri publik ka të drejtë të informohet për procedurat dhe vendimet lidhur me marrëdhënien e saj/tij te punës.

2. Zyrtarja/i publik ka te drejtë të qasjes në dosjen e saj/tij individuale dhe të kërkojë ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave në dosje.

3. Nëpunësja/i civil ka te drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës ne shërbimin civil, ne rastet e parapara sipas këtij ligji.

4. E drejta e ankimit ne KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil.

5. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHCK sipas paragrafit 3. dhe 4. të këtij neni, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit përkatës ne fuqi.

6. Nëpunësja/i e shërbimit publik dhe nëpunësja/i teknik dhe mbështetës ka të drejtë të paraqesin ankesë në Inspektoratin e Punës. Pas shterimit të së drejtës së ankimit në Inspektoratin e Punës, mund të iniciohet kontest pune në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.”

### **Neni 37**

#### **Marrëdhënia e punës në shërbimin civil**

[...]

7. Procedurat për zbatimin e paragrafit 3.të këtij neni, për nëpunësen/in në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

### **Neni 38**

#### **Klasifikimi i pozitave në shërbimin civil**

[...]

7. Procedurat sipas paragrafit 6. të këtij neni, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 39**  
**Procedura e pranimit në Shërbimin Civil**

“[...]

15. Rregullat për procedurën e konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve, për për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 40**  
**Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale**

“[...]

7. Rregullat për krijimin dhe përbërjen e Komisionit, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 41**  
**Emërimi në pozitë të kategorisë profesionale**

“[...]

3. Procedurat për emërimin në kategorinë profesionale për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 42**  
**Komisioni i pranimit për kategorinë e specialistes/it**

“[...]

7. Rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 43**  
**Emërimi në pozitë të kategorisë së specialistes/it**

“[...]

3. Procedurat për emërimin në kategorinë e specialistes/it për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 44**  
**Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese**

“[...]

7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.

[...]

12. Rregullat për procedurën e rekrutimit dhe vlerësimin e kandidatëve për nivelin e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 45**

#### **Komisioni i pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese**

[...]

7. Rregullat për themelimin, funksionimin dhe vendimmarrjen e komisioneve, si dhe kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e anëtareve/ëve të komisionit për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 46**

#### **Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues**

“1. Kandidatja/i për pozitën e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, e/i vlerësuar nga komisioni i pranimit me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 % të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohet kandidate/at fitues dhe emërohet në pozitën përkatëse për një mandat me kohëzgjatje prej katër (4) vitesh me të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë.

2. Kandidatja/i i përzgjedhur sipas paragrafit 1. i këtij neni, emërohet në detyrë nga njësia përgjegjëse.

3. Vazhdimi i mandatit, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, miratohet nga njësia përgjegjëse, me propozim të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në performancën e saj/tij gjatë mandatit. Për institucionet e tjera shtetërore, vendimi për vazhdimin e mandatit merret nga njësia përgjegjëse pas propozimit nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë.

4. Propozimi për vazhdim të mandatit bëhet të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit.

5. Vazhdimi i mandatit, në rastin e institucioneve komunale miratohet nga një komision ad hoc që përbëhet nga udhëheqësja/i i drejtpërdrejtë dhe dy (2) përfaqësues të njësisë përgjegjëse.

6. Vazhdimi i mandatit sipas këtij neni bëhet, nëse në fund të mandatit të parë mesatarja e performancës së mandatit të nëpunëses/it civil është vlerësuar së paku me vlerësimin “arrin pritshmëritë”.

7. Pas përfundimit të mandatit të dytë, ose në rast të mos vazhdimit të mandatit në pajtim me këtë nen, nëpunësja/i civil ka të drejtë të konkurrojë për të njëjtën pozitë që e ka mbajtur.

8. Të emëruarat/it në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese, që kanë qenë në shërbimin civil para emërimit në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese, sistemohen nga njësia përgjegjëse në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që plotësojnë kriteret për emërim në pozitën në fjalë.

9. Përjashtimisht paragrafit 8. të këtij neni, të emëruarit në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese, që nuk kanë qenë në shërbimin civil, pas përfundimit të mandatit lirohen nga shërbimi civil.

10. Deri në emërimin në një pozite të kategorisë profesionale, nëpunësja/i civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji.

11. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e kategorisë profesionale, të caktuar nga njësia përgjegjëse, përbën shkak për lirim të nëpunëses/it nga shërbimi civil.
12. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton me akt nënligjor rregullat për zbatimin e këtij neni.
13. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 47**

#### **Pranimi në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese**

[...]

13. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 48**

#### **Komisioni i pranimit për kategorinë e lartë drejtuese**

[...]

9. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 49**

#### **Emërimi dhe mandati në pozitën e nivelit të lartë drejtues**

[...]

15. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

#### **Neni 52**

#### **Vlerësimi i rezultateve në punë**

“1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësive të njësisë.

[...]

13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë:

- 13.1. arritje e jashtëzakonshme;
- 13.2. tejkalon pritshmëritë;
- 13.3. arrin pritshmëritë;

13.4. ka nevojë për përmirësim;

13.5. e papranueshme.

[...]

15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nënparagrafit 13.4. dhe 13.5., përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NJMBNJ-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë.

[...]

19. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

### **Neni 53**

#### **Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësen/in e kategorisë së lartë drejtuese**

[...]

7. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

### **Neni 54**

#### **Pamjaftueshmëria profesionale**

“ 1. Pamjaftueshmëria profesionale nënkupton mungesën e plotë të aftësive të nëpunëses/it civil për të përmbushur detyrat e punës të lidhura me pozitën e saj/tij, mungesën e përsëritur të saktësisë dhe përkushtimit, mungesën e përsëritur të përmirësimit profesional në realizimin e detyrave.

[...]

3. Masat që mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për pamjaftueshmëri profesionale janë:

3.1. ndjekje e detyrueshme e trajnimit për përmirësimin të aftësive profesionale;

3.2. transferimi në një pozitë tjetër;

3.3. inicim i procedurës në Komision Disiplinor.”

### **Neni 57**

#### **Masat disiplinore**

[...]

2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë:

[...]

2. 4. ulja në pozitë;

[...]

2. 7. largimi nga shërbimi civil.”



**Neni 60**  
**Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor**

[...]

12. Procedura dhe rregullat për zbatim të këtij neni, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 63**  
**Transferimi i përkohshëm**

[...]

8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 65**  
**Transferimi i përhershëm për interes të institucionit**

[...]

8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 66**  
**Transferimi në rast të shuarjes apo ristrukturimit**

[...]

8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 67**  
**Lista e pritjes**

“1. Nëpunëset/it civil që pas shuarjes apo ristrukturimit të institucionit nuk janë transferuar sipas nenit 66 apo rasteve të tjera të parapara me ligj nuk mund të sistemohen, do të vendosen në listën e pritjes.

2. Ministria përgjegjëse për administratë publike, kujdeset për sistemimin e nëpunëseve/ve civil në pritje në kategori të njëjtë të shërbimit civil, si dhe trajnimin për pozitën përkatëse ku sistemohet.

3. Refuzimi për t'iu nënshtruar trajnimit, sipas pikës 2. të këtij neni, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

4. Nëse brenda afatit prej nëntë (9) muajsh nëpunësja/i civil nuk ricaktohet në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

5. Të drejtat dhe detyrimet sipas këtij neni vlejné për aq kohë sa nëpunësja/i civil në listën e pritjes nuk ka marrëdhënie tjetër pune.

6. Të drejtat dhe detyrimet e nëpunëseve/ve civil në pritje, duke përfshirë pagat dhe trajnimin e tyre, përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të

ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa.”

**Neni 69**  
**Pezullimi sipas detyrës zyrtare**

“[...]

4. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

**Neni 74**  
**Lirimi nga Shërbimi Civil**

“1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me lirim nga shërbimi civil, në këto raste:

[...]

1.3. pas dy (2) vlerësimeve “e papranueshme” të rezultateve në punë” dy (2) herë radhazi. Si herë e dytë radhazi konsiderohet edhe vlerësimi i veçantë;

[...]”

**Neni 84**  
**Vlerësimi i rezultateve të punës**

“[...]

5. Në rastin e vlerësimit periodik të nëpunëses/it të shërbimit publik në nivelin “e papranueshme” sipas paragrafit 13, nënparagrafit 13.5. të nenit 52 të këtij ligji, ajo/ai i nënshtrohet vlerësimit të veçantë.

[...]”

**Neni 88**  
**E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik**

“1. Nëpunësja/i i shërbimit publik mund të ankohet kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënies e punës. Të drejtën e ankesës e kanë dhe kandidatët në procedurë rekrutuese në shërbimin publik.

2. Ankesa sipas paragrafit 1. të këtij neni paraqitet sipas afateve të përcaktuara në ligjin për procedurën administrative nga dita e pranimi të vendimit përfundimtar.

3. Shqyrtimi i ankesave është në kompetencë të Inspektoratit të Punës.

4. Pas shterimit të drejtës së ankimit në Inspektoratin e Punës, nëpunësja/i mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.”

**Neni 98**  
**Rekrutimi i decentralizuar**

“1. Pavarësisht dispozitave të këtij ligji, procedura e centralizuar e rekrutimit për shërbyeset/it civil që zhvillohet nga njësi përgjegjëse në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, do të fillojë të zbatohet tetëmbëdhjetë (18) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në periudhën sipas paragrafit 1 të këtij neni, NjMBNj e institucionit përkatës do të zhvillojë procedurën e rekrutimit.

3. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për procedurën e rekrutimit, themelimit të komisionit, vlerësimin dhe emërimin të kandidatëve sipas këtij neni.”

### **Neni 99 Dispozitat kalimtare**

“1. Nëpunësja/i civil në marrëdhënie pune ë shërbimin civil, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësveve civil sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës/ës civil sipas nenit 2, paragrafi 3. të këtij ligji, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Më së voni një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të shpallet procedura e rekrutimit sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik, përjashtimisht për pozitat të cilat kanë qenë të lira dhe janë plotësuar gjatë fazës transitore të rekrutimit sipas nenit 98 të këtij ligji.

3. Në procedurën e shpallur të rekrutimit sipas paragrafit 2. të këtij neni, gëzon të drejtën e konkurrimit edhe zyrtarja/i publik që ka qenë e/i emëruar në atë pozitë deri në momentin e shpalljes së procedurës së rekrutimit për pozitën në fjalë.

4. Nëse zyrtarja/i publik si në paragrafin 3. të këtij neni, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit nuk shpallet fitues për emërim në pozitën përkatëse apo nuk ka konkurruar fare, ajo/ai do të sistemohet në kategorinë profesionale, me kusht që plotëson kriteret për emërim në pozitën në fjalë.

5. Zyrtarja/i publik si në paragrafin 4. të këtij neni, do të përfitojë kompensim që është i barabartë me diferencën ndërmjet pagës bazë të pozitës drejtuese që ka ushtruar dhe pagës së kategorisë profesionale ku sistemohet, në:

5.1. 100% të diferencës në pagë, gjatë vitit të parë pas sistemimit në kategorinë profesionale;

5.2. 75 % të diferencës në pagë, gjatë vitit të dytë pas sistemimit në kategorinë profesionale;

5.3. 50% të diferencës në pagë, gjatë vitit të tretë pas sistemimit në kategorinë profesionale;

5.4. 25 % të diferencës në pagë, gjatë vitit të katërt pas sistemimit në kategorinë profesionale.

6. Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, sipas paragrafit 5. të këtij neni, nëpunësja/i civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e kategorisë profesionale, përbën shkak për lirimin e nëpunës/it nga shërbimi.

7. Të drejtat nga paragrafët 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni vlejné vetëm një herë, për periudhën dhe rrethanat e përcaktuara sipas këtyre paragrafëve.

8. Për pozitat e lira të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues për të cilat është shpallur dhe përfunduar procedura e rekrutimit sipas nenit 98 të këtij ligji, zyrtarja/i publik është emëruar në atë pozitë gjatë periudhës transitore, konsiderohet se mandatin e parë për pozitën përkatëse e fillon në momentin e emërimit të saj/tij në atë pozitë.

[...]

### **Neni 104 Shfuqizimi**

“1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet:

1.1. Ligji Nr. 03L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;

1.2. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; dhe

1.3. Ligji Nr. 08/L-128 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.”

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO216/22**

36. Parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se nenet: 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 77 [Komisionet], 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
37. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO216/22 lidhur me mospërputhshmërinë e neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet për (i) shkeljet procedurale gjatë miratimit të ligjit të kontestuar në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës; dhe mospërputhshmërinë e: (ii) nenit 9 të Ligjit të kontestuar me nenet 7 dhe 101 të Kushtetutës; (iii) nenit 12 të Ligjit të kontestuar me nenin 4 të Kushtetutës; (iv) nenit 46 të Ligjit të kontestuar me nenet 3, 7, 16 dhe 19 të Kushtetutës; dhe (v) nenit 99 të Ligjit të kontestuar me nenet 3, 7, 22 dhe 49 të Kushtetutës; si dhe (vi) kërkesën për masë të përkohshme.
- (i) *Pretendimet për shkeljet procedurale gjatë miratimit të ligjit të kontestuar në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës*
38. Lidhur me procedurën e miratimit të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“Ligji i kontestuar në pikëpamje procedurale nuk i ka përmbushur kërkesat e shqyrtimit parlamentar në komisionet e përhershme parlamentare të Kuvendit sepse duke u trajtuar në procedurë të përsheptuar – shmangie nga afatet procedurale të parapara me paragrafin 4 të nenit 34 par. 4, nenin 52, par. 1 dhe nenin 76, par.3 dhe 8 të Rregullores së Kuvendit, është miratuar pa u shqyrtuar fare në Komisionin e Përhershëm për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.”* Rrjedhimisht, të njëjtit konsiderojnë se me këtë rast Kuvendi është ai që: *“[...] me miratimin e ligjit kontestues, ka shkelur edhe vendimin nr. 08-V-449, të datës 15 dhjetor 2022, sipas të cilit, përveç përgjegjësi të përcaktuara për Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në pikën 1.3 të këtij vendimi, ka paraparë shprehimisht që komisionet e përhershme të shqyrtojnë projektligjin deri më datë 21 dhjetor, ora 12:00.”*
39. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“[...] ligji i kontestuar është miratuar në procedurë parlamentare që ka rezultuar me shkelje esenciale të dispozitave të Rregullores së Punës së Kuvendit – duke cenuar dhe Nenin 77 [Komisionet] dhe Nenin 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*
40. Parashtruesit e kërkesës po ashtu konsiderojnë se: *“[...] ligji i kontestuar, në pikëpamje procedurale, bie ndesh edhe me nenin 76 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione), të Rregullores [së Kuvendit], në të cilën shprehimisht është paraparë detyrimi që Komisionet e përhershme të shqyrtojnë projektligjin me amandamentet eventuale të propozuara”.*

(ii) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 9 të Ligjit të kontestuar me nenet 7 dhe 101 të Kushtetutës*

41. Përkitazi me kriterin e “përshtatshmërisë” për emërim në pozita specifike të zyrtares/it publik, të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës pohojnë se: *“Përdorimi i termit “përshtatshmëria” si kriter shtesë për punësim shkon kundër parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, elemente këto të sundimit të ligjit sipas Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias”, i cili parim gjen zbatim në nenin 7 të Kushtetutës.*
42. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se: *“Termi “përshtatshmëri” si kriter shtesë për punësim hapë rrugën për abuzim dhe arbitraritet gjatë procedurave të rekrutimit, sepse do të jetë mjet në duart e komisioneve të pranimit që të vendosin pro ose kundër një kandidati dhe jo në respektim të parimit të meritës”.*
43. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ky kriter *“[...] do të duhej të ishte specifik, i përcaktuar në ligj dhe jo me një akt nënligjor të Qeverisë”* dhe në këtë kontekst, theksojnë paragrafin 1 të nenit 101 të Kushtetutës. Sipas parashtruesve të kërkesës: *“[...] shërbimi civil përbën mekanizëm profesional, neutral ndaj politikës, civil dhe meritës, i përhershëm”.*

(iii) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 12 të Ligjit të kontestuar me nenin 4 të Kushtetutës*

44. Në lidhje me paragrafin 1 të nenit 12 të Ligjit të kontestuar, i cili, ndër të tjera, përcakton se Qeveria miraton dhe koordinon politikën e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është në papajtueshmëri me nenin 4 të Kushtetutës sepse, sipas tyre, *“[...] lejon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të qeverisë në punësimet në Kuvend, në gjyqësor dhe institucionet e tjera të pavarura, pavarësia e të cilave është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe elaboruar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (GJK), të datës 9 korrik 2020, AGJ: 1582/20, çështja nr. KO203/19, përkatësisht me paragrafët 205, 206, 207 të këtij aktgjykimi.”*

(iv) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 46 të Ligjit të kontestuar me nenet 7, 16 dhe 19 të Kushtetutës*

45. Përkitazi me paragrafin 1 të nenit 46 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton mandatin me kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh me të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë për pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, parashtruesit e kërkesës pohojnë se rregulli i tillë *“[...] nuk gjen zbatim në asnjë vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe bie ndesh me Parimet e Administratës Publike të SIGMA-së që zbatohen për vendet candidate dhe potencialisht candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian siç është edhe Kosova”.*
46. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i referohen Raportit të SIGMA-s për Ligjin e kontestuar, dhe theksojnë si në vijim: *“Sipas rekomandimeve të SIGMA-s, mandatet e kufizuara kohore për të gjithë të nëpunësit e nivelit të ulët të mesëm drejtues paraqesin një shkallë të lartë jo stabiliteti, cenim të rritjes profesionale të shërbimit civil”.*
47. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se rregulli i tillë bie në kundërshtim me nenin 120 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërin anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër (në tekstin e mëtejme: MSA), përmes të cilës Kosova ka marrë zotim ndaj Bashkimit Evropian për reformimin e administratës publike në pajtim me parimet e

SIGMA-s, si dhe këtë, sipas tyre, e ka konstatuar edhe Shefi i Zyrës së BE-së në letrën e tij të 14 dhjetorit 2022, ku, ndër të tjera, rekomandon që: “[...] të mos procedohet me këtë iniciativë në rend të parë për shkak të rrezikut të madh në sigurimin e jo stabilitetit të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike.[...] Hedhja e dyshimeve për kompetencat e të gjithë drejtuesve aktualë dhe detyrimi i tyre për t’iu nënshkruar një procedure të re rekrutimi, dërgon një sinjal të dëmshëm për të gjithë nëpunësit civilë. Ky hap i pajustificuar do të krijojë kaos në administratë, për më tepër kjo gjendje e fluksit do të zgjatët, pasi që nuk është e mundur të organizohen qindra rekrutime në një periudhë ditore apo javësh (janë mbi dy mijë pozicione në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese në Kosovë)”.

48. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës shtojnë se “[...] ligji i kontestuar nuk mund të jetë në kundërshtim me MSA-në, si marrëveshje e ratifikuar në Kuvend, së këndejmi obligim ndërkombëtar për Kosovën, pasi që, sipas nenit 16 paragrafit. 3 të Kushtetutës shprehet zotimi se: Republika e Kosovës respekton të Drejtën Ndërkombëtare”. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se përmes MSA-së, “[...] Kosova ka marr për detyrim të harmonizojë legjislacionin e saj të brendshëm me të Drejtën e Bashkimit Evropian, pjesë e saj është edhe Karta për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian”, ku në nenin 30 (Mbrojtja në rast të shkarkimit të pajustificueshëm) të saj, përcaktohet se: “Çdo punëtor ka të drejtën e mbrojtjes nga largimi i pajustificuar nga puna, në përputhje me të drejtën e komunitetit, ligjet dhe praktikat kombëtare”.
49. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës përmendin nenin 7 të Kushtetutës, ku nënvizohet parimi i sundimit të ligjit, i cili sipas Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias, përmban kategorinë e “Ligjshmërisë”, në të cilën bën pjesë nënkategoria “Marrëdhëniet ndërmjet të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme”, që kërkon në mënyrë të qartë që shtetet të respektojnë parimet e tyre ndërkombëtare, kjo përfshin edhe detyrimin që me rastin e miratimit të ligjeve të mos cenojnë ato detyrime. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Neni 46 i ligjit të kontestuar përmban dispozita që bien ndesh me nenin 7 të Kushtetutës, sepse shkelin parimin e sundimit të ligjit të mbrojtur me këtë nen, i cili duhet interpretuar në frymën dhe gërmën e Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias”.
- (v) Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 99 të Ligjit të kontestuar me nenet 7, 22 dhe 49 të Kushtetutës
50. Në lidhje me paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar, i cili parasheh se më së voni prej 1 (një) viti, për të gjitha pozitat e nivelit të mesëm dhe ulët drejtues do të shpallet procedura e rekrutimit sipas radhës së planifikuar, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “[...] të gjithë personat që mbajnë pozitat e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, do t’i humbin vendet e tyre të punës, pasi që për pozitat e tyre do të shpallen konkurset publike”. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas nenit 67 të ligjit të kontestuar të njëjtit “[...] vendosen në listë të pritjes, por nëse brenda afatit prej 9 (nëntë) muajsh ata nuk ricaktohet në ndonjë pozitë tjetër të shërbimit civil, kjo përbën shkak për lirim nga detyra. Pra, ata do të mbesin pa punë”.
51. Parashtruesit e kërkesës potencojnë se këto pozita i kanë fituar përmes legjislacionit të mëparshëm, respektivisht Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejme: Ligji paraprak për Shërbimin Civil) dhe aktualisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Ligji aktual për Zyrtarët Publikë). Në këtë kontekst, të njëjtit pohojnë se “Detyrimi i imponuar për të iu nënshtruar procedurës së rekrutimit për këta nëpunës civil, të cilët procedurën e tyre të rekrutimit e kanë kryer shumë kohë më parë në bazë të ligjit të mëparshëm për shërbimin civil, ushtrimin e funksionit e kanë bërë për vite apo dekada, përbën shkelje të së drejtës ligjore të fituar, cenon pritshmëritë

*legjitime dhe në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit të mishëruara në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të elaboruara në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias.” Për rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se: “Të gjithë nëpunësit civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, duke qenë të emëruar me aktemërim të përhershëm, pra, pa mandat të kufizuar kohor, kanë krijuar pritje legjitime”, të cilat, sipas tyre, janë nënkategori e “sigurisë juridike” të Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias, e ku parimi i sundimit të ligjit është një nga vlerat që e mbrojnë neni 7 i Kushtetutës.*

52. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“Detyrimi i tillë ndaj nëpunësve civil që kanë themeluar marrëdhënie pune, sidomos rreziku që ata edhe mund të humbin vendin e punës, përbën shkelje të garancioneve kushtetuese të së drejtës në punë, të përcaktuara me nenin 49 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili përcakton se: “E drejta e punës garantohet”.*
53. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës ngritin çështjen e të parimit *“të drejtave të fituara”*, andaj, i referohen Aktgjykimit [nr. 832] të vitit 1987 të Tribunalit Administrativ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (në tekstin e mëtejshëm: ONP), i cili thekson se *“[...] ndryshimi i një rregulli në dëm të një zyrtari dhe pa pëlqimin e tij përbën shkelje të një të drejte të fituar ku struktura e kontratës së emërimit është ndryshuar ose ka dëmtim të ndonjë afati themelor të emërimit në konsideratë të të cilit zyrtari e ka pranuar emërimin”.* Të njëjtit citojnë në këtë drejtim edhe nenin 155 [Ndalimi i Efekteve Retroaktive të Akteve Juridike] të Kushtetutës së Sllovenisë, i cili përcakton se: *“Ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike nuk mund të kenë efekt prapaveprues. Vetëm ligji mund të përcaktoj që disa nga dispozitat e tij kanë efekt prapaveprues, nëse një gjë e tillë diktohet nga interesi publik dhe me kusht që asnjë e drejtë e fituar nuk cenohet”.*
54. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se: *“[...] marrëdhënia e punës së nëpunësit civil nuk është me një subjekt politik apo me Qeverinë, por me shtetin”.* Në këtë aspekt, sipas tyre, me legjislacionin paraparak, *“[...] shteti ju ka ofruar aktemërimet të përhershme (pa mandat të kufizuar kohor), ndërsa tani shteti vendos të ndryshojë këtë rregull përmes nxjerrjes së ligjit të kontestuar duke i shpallur pozitat e tyre në konkurs publik dhe duke i detyruar ata që, për pozitën e tyre të i nënshtrohen sërish procedurës së rekrutimit, dhe me këtë, duke i rrezikuar ata të mbesin papunë”.* Parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“Kjo qartazi bie ndesh me pritshmëritë legjitime, që ata kanë ndërtuar në mënyrë shumë të arsyeshme dhe të drejtë, bazuar në “premtimin” që shteti u ka dhënë atyre me ligjet që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të atyre të drejtave ligjore”,* në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila është e zbatueshme drejtpërdrejtë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

*(iv) Lidhur me pezullimin e zbatimit të Ligjit të kontestuar*

55. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata, *“[...] që pa paragjykim ndaj pranueshmërisë ose meritave të kërkesës, të informojë palët e përfshira që ligji kontestues i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 5 i Kushtetutës, pezullohet ex-lege dhe nuk dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”.*
56. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk është në përputhshmëri me nenet 4, 7, 16, 19, 22, 49 dhe 101 të Kushtetutës.

## Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO220/22

57. Parashtruesit e kësaj kërkesë pretendojnë se neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe paragrafi 2 i nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
58. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO220/22 lidhur me mospërputhshmërinë e neneve të lartcekura të Ligjit të kontestuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës, përkatësisht pretendimet për mospërputhshmërinë (i) e nenit 46 të ligjit të kontestuar me Kushtetutën; dhe (ii) nenit 99 të kontestuar me Kushtetutën; si (iii) shkeljet procedurale gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar, përfshirë (iv) kërkesën për masë të përkohshme.
- (i) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 46 të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën*
59. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 46 i Ligjit të kontestuar bie në kundërshtim edhe me nenet 3, 7, 16, 19, 21, 22, 24, 46, 49, 53 dhe 101 të Kushtetutës. Të njëjtit pretendojnë se përmes kësaj dispozite të kontestuar “[...] shkatërrohet sistemi i karrierës në shërbimin civil të Republikës së Kosovë dhe në vend të tij vendoset sistemi i bazuar në pozita të përkohshme me mandat për të gjitha pozitat e nivelit të mesëm dhe të ultë drejtues, duke e goditur kështu në esencë shërbimin civil, si trup profesionale, e paanshme dhe e pavarur nga ndikimi drejtpërdrejtë politik,” si dhe, ndër të tjera, theksojnë që ky ligj: “[...] nuk reformohen shërbimin civil dhe administratën publike në përgjithësi, përkundrazi e degradon atë. E gjithë reforma e mbështetur nga BE dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar për avancimin e rolit të shërbimit civil, me Ligjin për Zyrtaret Publik, kthehet në pikën zero, duke i bërë dëme të pa riparueshme sistemit të karrierës në shërbimin civil”.
60. Tutje, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, theksojnë se: “Edhe SIGMA-s, edhe Zyra e BE-së, edhe shoqëria civile, edhe partitë opozitare, madje edhe Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit e ka kundërshtuar këtë Ligj gjatë fazës së hartimit në Qeveri si dhe gjatë procedurës parlamentare, duke vënë theksin se në këtë formë goditet shërbimi civil, i njëjti rrezikon të politizohet skajshëm për shkak të mundësive të ndryshimeve me mandat të pozitave kyçe në shërbim”. Po ashtu, të njëjtit pohojnë se: “[...] përcaktimi i mandatit 4 vjeçar për pozitat e mesme dhe të ulëta drejtuese ndikon tejet negativisht në stabilitetin e shërbimit civil, neutralitetin politik, profesionalizimin e shërbimit civil, në zbatimin e politikave zhvillimore afatmesme dhe afatgjata për shkak të mungesës së memories institucionale dhe përvojës administrative”.
61. Parashtruesit e kërkesës vënë në pah se në pjesën hyrëse të Kushtetutës: “[...] është shprehur synimi i popullit të Kosovës për integritet evropian [...]”, rikujtojnë detyrimin e saj, përmes nenit 120 të MSA-së, “[...] për zhvillim të mëtejshëm të një administrate publike profesionale efiçente dhe llogaridhënëse [...]”, si dhe theksojnë kundërshtimin e drejtpërdrejtë të Zyrës së Bashkimit Evropian, të cilët për ligjin e kontestuar shprehen si në vijim: “Ligji i ri për zyrtarët publikë është problematik përkitazi me sigurimin e një shërbimi civil të bazuar në merita që mund të menaxhojë në mënyrë efektive burimet njerëzore, pasi shton liri të tepruar veprimi në procedurat e rekrutimit, transferimit si dhe në procedurat disiplinore të nëpunësve civilë, duke bërë shërbimin civil potencialisht të cenueshëm ndaj politikimit”.



62. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Ligji i kontestuar: “[...] rrezikon proceset integruese të Kosovës në Bashkim Evropian, sepse reforma bë administratën publike është njëra nga parakushtet thelbësore për proceset integruese të shtetit tonë”, si dhe konsiderojnë se: “[...] është shkelje kushtetuese sepse marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës dhe të njëjtat janë të zbatueshme”.
- (ii) *Pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 99 të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën*
63. Në lidhje me paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretendojnë se: “Nëpunësit civilë aktual të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues kanë akt emërime të përhershme në pozitat që mbajnë brenda shërbimit civil. Pra, ata kanë një të drejtë të fituar dhe një marrëdhënie pune me shtetin, e cila ndërlidhet edhe me nivelin e pagës së tyre dhe planifikimeve duke u bazuar në page, e cila konsiderohet një e drejtë pronësore e fituar”.
64. Parashtruesit e kërkesës po ashtu theksojnë se: “Largimi kolektiv i rreth 1600 nëpunësve civil të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, është në kundërshtim me parimet kushtetuese sepse cenon sigurinë juridike të zyrtarëve aktual publik, pa një vlerësim të performancës së tyre në pajtim me legjislacionin aktual të mbështetur në sistemin e karrierës”. Specifikisht, të njëjtit konsiderojnë se “[...] ndërprerja e marrëdhënies së punës me Ligjin për Zyrtarët Publik brenda një periudhe një vjeçare, është shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut, është cenim i të drejtave pronësore që ndërlidhet me vlerën e pagës në pozitën e fituar dhe cenim i sigurisë juridike”.
65. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës citojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GEDNJ) (rastet e GJEDNJ-së, [Hasani kundër Kroacisë](#), nr. 20844/08, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 shtatorit 2010, dhe [Asmundsson kundër Islandës](#), nr. 60669/00, Aktgjykim i 12 tetorit 2004) dhe asaj të Gjykatës, gjegjësisht, rastin e Gjykatës KO219/19, rast i cituar më lart, përkatësisht paragrafët 302 dhe 303 të tij, ku sqarohen aspektet relevante të së drejtës së pronës dhe pritjeve legjitime të të gjithë personave të cilët mund të preken nga ndryshimet ligjore si në vijim: “[...] gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, të kenë parasysh aspektet relevante të drejtat e pronës dhe pritjeve të të gjithë personave të drejtat e të cilëve preken nga çfarëdo lloj amendamenti, plotësimi ose ndryshimi ligjor”.
- (iii) *Pretendimet për shkeljet procedurale gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar*
66. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shkelur Rregulloren e Punës së Kuvendit, në procedurën e miratimit të ligjit në fjalë, në atë mënyrë që ka proceduar në seancë plenare për votim amendamente të cilat nuk kanë kaluar në komisionet e përhershme të Kuvendit [...]”, të cilat komisione sipas parashtruesve të kërkesës, janë “kategori kushtetuese”, të përcaktuara në nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës.
67. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë si në vijim: “Kemi të bëjmë me vënien në lajthitje të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me vërtetësinë e amendamenteve dhe procedurën e ndjekur në lidhje me to. Këto amendamente janë votuar në seance plenare dhe janë bërë pjesë e ligjit”.

68. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës pohojnë se: “Në dokumentet zyrtare nga seanca plenare e Kuvendit të Kosovës lidhur me votimin e ligjit në fjalë, do të shihni se janë dy dokumente të ndryshme me amendamente të ndryshme nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, për ilustrim shihni dokumentet: Raport me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik me nr. protokollin 08/3241/L-197, datë 20.12.2022, si dhe dokumenti tjetër Raport për Projektligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik me nr. protokollin 08/3252/L-197, datë 21.12.2022. Krahaso psh. Amendamentin 10 të këto dy dokumente të sipërsënuara, kemi të bëjmë me dy tekste/ përmbajtje të ndryshme të amendamenteve. Për më shumë shih edhe vërejtjen e Shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së z. Arben Gashi lidhur me këtë shkelje procedurale të bërë në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.”

(iv) Kërkesa për masë të përkohshme

69. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme në lidhje me kërkesën e tyre pasi që do të mbrohej interesi publik, me arsyetimin si në vijim: “a). Mosvënia e masës së përkohshme do të kishte pasoja të pariparueshme për rreth 1600 nëpunësit civil të pozitive të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues të cileve do t’ju ndërpritet marrëdhënia e tyre e punës; b). Për më tepër, si rrjedhojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për rreth 1600 nëpunësit civil të pozitive të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, të njëjtëve do të kishin pasoja në uljen e pagave, duke ju shkaktuar probleme financave në kohën e krizës së inflacionit të lartë në shtetin tonë si dhe në planifikimet dhe obligimet e tyre si debitor, duke llogaritur në pagën aktuale; c). Hapja automatike e konkurseve, transferimi në pozite tjetër pa pëlqimin e nëpunësit si dhe emërimet e nëpunësve të rinj në këto pozita do të kishte pasoja të pariparueshme për individë që aktualisht i mbajnë këto pozita sepse të punësuarit aktual në këto pozita në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë rrezikojnë të humbin vendin e punës për të cilin kanë akt emërim të ligjshëm të përhershëm, pa ju nënshtruar një vlerësimi paraprak të performancës së tyre, duke cenuar kështu sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë si parime dhe të drejta themelore të garantuar për çdo qytetarë të Republikës së Kosovës me Kushtetutë dhe ligj.”

70. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që (i) të shpallë Ligjin e kontestuar, respektivisht nenin 46 dhe paragrafin 2 të nenit 99 të tij, që nuk është në përputhshmëri me nenet 3, 7, 19, 21, 22, 24, 46, 49, 53, 55 dhe 101 të Kushtetutës; dhe (ii) të shpallë të pavlefshme këto dispozita të Ligjit të kontestuar si dhe në tërësinë e tij për shkak të shkeljeve procedurale të Rregullores së Kuvendit dhe neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës.

### **Komentet e dorëzuara nga Kryeministri më 23 janar 2023**

71. Më 23 janar 2023, Kryeministri në emër të Qeverisë, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, si dhe bashkëngjiti dokumentet në vijim: (i) Parimet e Administratës Publike të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (në tekstin e mëtejme: OECD/SIGMA), botim i janarit 2023; dhe (ii) Memorandumin shpjegues të Projektligjit për Zyrtarët Publikë së bashku me dy shtojcat e saj, gjegjësisht, a) Tabelën ilustruese me të gjeturat e Raportit të Progresit ndër vite në Shërbimin Civil (2008-2021); dhe b). Tabelën e komenteve nga procesi i konsultimit për Projektligjin për Zyrtarët Publikë.

72. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e Kryeministrit përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlihdhen me (i) nenin 9 të Ligjit të kontestuar; (ii) nenin 12 të Ligjit të kontestuar; (iii) nenin 46

të Ligjit të kontestuar; (iv) paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar; dhe (v) “interesin e përgjithshëm”.

(i) *Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO216/22 për nenin 9 të Ligjit të kontestuar*

73. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se me nenin 9 të Ligjit të kontestuar është cenuar parimi i sigurisë juridike, Kryeministri, ndër të tjera, konsideron, se “[...] pretendimi i tillë është i pabazuar sepse përshtatshmëria nuk cenon sigurinë juridike dhe nuk e vë në dyshim kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar”. Kryeministri thekson se “[...] parimi i sigurisë juridike nuk ka karakter absolut dhe, në veçanti, duhet të balancohet me interesin e përgjithshëm publik”, duke u thirrur në një paragraf të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjegjësisht vendimet nr. 26, datë 02.11.2015, dhe nr. 37, datë 13.06.2012, të cilët përcaktojnë si në vijim: “[...] parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore [...]”.
74. Tutje, Kryeministri në komentet e tij, thekson se “[...] Ligji i kontestuar është pjesë e konceptit të së drejtës administrative dhe nuk ka nivelin e njëjtë të domosdoshmërisë për parimin e parashikushmërisë siç do të mund të kishte në legjislacionin penal”, dhe se ky parim “[...] për aq sa është i nevojshëm është përmbushur në tërësi, përkatësisht në nenin 99, paragrafin 3, 4 dhe 5”.
75. Për më tepër, Kryeministri pohon se: “[...] interesi i përgjithshëm publik është i rëndësishëm primare. Kjo për shkak se kriteret e përshtatshmërisë e kanë për qëllim plotësimin e pozitive në sektorin në sektorin publik me individë të përshtatshëm në kuptim të integritetit në raport me pozitën përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë për pozitat specifike”, dhe se “Përshtatshmëria është element i interesit të përgjithshëm publik për reformën në administratën publike që është parakusht për qeverisje të mirë, transparencë, llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet.”
76. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se specifikat e “kriterit të përshtatshmërisë” duhet të parashihen me ligj dhe jo akt nënligjor, Kryeministri thekson praktikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në tekstin e mëtejme: SHBA), që dëshmon se përcaktimi i kriterëve të përshtatshmërisë mund të bëhet edhe përmes aktit nënligjor dhe jo detyrimisht me ligj. Në këtë drejtim, Kryeministri ka përmendur Kodin e Rregulloreve Federale, seksionin 731.202 (b) (Criteria for making suitability determinations, specific factors [Kriteret për përcaktimet e përshtatshmërisë, faktorët specifik]), i cili është akt nënligjor ku përcaktohen kriteret e përshtatshmërisë për punësimin në shërbimin civil.

(ii) *Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO216/22 për nenin 12 të Ligjit të kontestuar*

77. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës së neni 12 i Ligjit të kontestuar është në pajtueshmëri me nenin 4 të Kushtetutës, Kryeministri pohon se parashtruesi i kërkesës “[...] nuk ofron asnjë argument se pse ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën”. Kryeministri, ndër të tjera, konsideron se: “Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ngritja e pretendimit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konstatuar shkelje të neneve kushtetuese”.
78. Në këtë kontekst, Kryeministri thekson se “[...] kapitulli II i Ligjit të Kontestuar përcakton se si dhe nga kush bëhet administrimi i zyrtarëve publikë, ndërsa neni 12 e përcakton Qeverinë si organin kryesor për miratimin dhe koordinimin e politikave të përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarit publik nga fushë-veprimtaria e vet

*kushtetuese*”, dhe tutje që: *“Ky përcaktim në asnjë moment nuk e cenon nenin 4 të Kushtetutës sepse nuk duhet të lexohet i ndarë nga nenet e tjera të Ligjit të Kontestuar [...]”*. Në këtë drejtim, Kryeministri citon nenet e Ligjit të kontestuar që përmbajnë autorizimet specifike për institucionet e pavarura kushtetuese, të cilat kanë prerogativën e nxjerrjes së akteve të veçanta që burojnë nga ky ligj.

(iii) *Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për nenin 46 të Ligjit të kontestuar*

79. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës se neni 46 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së dhe neneve 3, 7, 16, 19, 21, 22, 24, 46, 49, 53 dhe 101 të Kushtetutës, Kryeministri i konsideron qartazi të pabazuara për shkak se në juridiksionin e Gjykatës *“[...] nuk është i përfshirë kontrolli kushtetues i ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare”*, dhe as këto të fundit nuk janë objekt kontrolli i kushtetutshmërisë.
80. Pavarësisht komenteve të lartcekura, Kryeministri argumenton se Ligji i kontestuar është në përputhje me nenin 120 të MSA-së, për arsye se çështjet e profesionalizimit, e efikasitetit dhe llogaridhënies, të meritokracisë, llogaridhënies në procedurat rekrutuese garantohej me nene specifike të Ligjit të kontestuar. Kryeministri po ashtu thekson se neni 120 i MSA-së specifikon se *“[...] bashkëpunimi do të përqendrohet ndër të tjera në zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, gjë që garantohej përmes Ligjit të Kontestuar, i cili i mundëson çdo të punësuarit të avancojë në pozitë përmes konkurseve të hapura dhe publike”*.
81. Në këtë drejtim, Kryeministri thekson se: *“[...] karriera taksativisht nuk mund të zhvillohet vetëm përmes një sistemi”*. Në këtë kontekst, Kryeministri para Gjykatës prezanton të dhënat krahasuese për konceptin e zhvillimit të karrierës në shërbimin civil, që bazuar në praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian mund të jetë: sistem i karrierës, sistem dual apo sistem i pozitës. Sipas këtyre të dhënave të cilat krahasojnë shtetet që, ndër vite, janë përcaktuar për sistemet respektive, gjegjësisht të dhënat e vitit 2018 në raport me vitin 2021, rezulton sipas komenteve të parashtruara se shtetet anëtare të BE-së kanë një trend të largimit nga sistemi i karrierës drejt sistemeve të tjera, p.sh. që nga viti 2018, Danimarka ka kaluar nga sistemi i karrierës në atë të pozitës.
82. Kryeministri po ashtu pohon se: *“Lidhur me pretendimet e parashtruesit se nuk janë marrë parasysh parimet e SIGMA-s, kur përmenden ndikimi politik dhe të ngjajshme duhet vërejtur se mungon referenca e saktë”*. Në këtë aspekt, Kryeministri thekson se *“[...] për dijeni të Gjykatës Kushtetuese se parimet lidhur me fushën e administratës publike të këtij instituti profesional që bashkëpunon me BE-në janë në zhvillim e ndryshim dhe aktualisht janë publikuar “Draft revised Principles of Public Administration, 16 January 2023”, për të cilat Republika e Kosovës Qeveria është ftuar për të ofruar komente”*.
83. Kryeministri shton se në frymë të transparencës, hartuesi i Ligjit të kontestuar është konsultuar me palët e interesit dhe se ka adresuar një numër të madh të komenteve, respektivisht, nënvizon se: *“Nga përafërsisht nëntëdhjetë e tre (93) komente të SIGMA-s nuk janë pranuar dhe adresuar më pak se katërmëdhjetë (14) komente, pra më pak se 15% të tyre”*.

(iv) *Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar*

84. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se paragrafi 2 i nenit 99 të Ligjit të kontestuar bie në kundërshtim me nenet 7, 22, 46 dhe 49 të Kushtetutës, Kryeministri, ndër të tjera, thekson se “*Në Ligjin e Kontestuar të miratuar nga Kuvendi nuk ka asnjë dispozitë që bie ndesh me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut*”. Kryeministri pretendon se “[...] të gjithë personat që mbajnë pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues nuk do të humbin punën e për më tepër, nuk do t’iu ndërpritet marrëdhënia e punës pa afat të caktuar, sipas aktit të emërimit”.
85. Kryeministri pohon se: “*E drejta e fituar në formën që pretendojnë parashtruesit nuk ndërlidhet me nenin 49 të Kushtetutës*”, e cili garanton të drejtën e punës. Kryeministri gjithashtu thekson se: “[...] nuk përfshihet as në Kushtetutë, as në Konventat ndërkombëtare dhe as në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, privilegjin për të mbajtur përgjithmonë një pozitë të caktuar drejtuese”.
86. Në këtë kontekst, Kryeministri potencon se: “*Marrëdhënia e punës siç përcaktohet në secilin aktëmërim buron nga statusi i të qenit nëpunës civil dhe jo me pozitën përkatëse në administratën publike*” dhe se e njëjta nuk mund të konsiderohet e drejtë e fituar. Në lidhje me këtë, Kryeministri thirret në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (respektivisht, rastet e GJEDNJ-së, [Marckx kundër Belgjikës](#), nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1976 dhe [X kundër Gjermanisë](#), nr. 7705/76, Aktvendim për papranueshmëri i 5 korrikut 1977) si dhe atë të Gjykatës (gjegjësisht rastin e Gjykatës [KI189/19](#), me parashtrues Alban Miftaraj, Aktvendim për papranueshmëri i 17 dhjetorit 2020), ku thekson se kjo jurisprudencë nuk: “[...] afirmon të “drejtën e fituar” për të garantuar përfitimin e benefiteve nga puna që kryhet në të ardhmen”. Respektivisht, Kryeministri konsideron se: “[...] pritshmëritë legjitime trajtohen në rastet e posedimit, pasuritë dhe pronës ekzistuese. Në asnjë rast nuk ndërlidhet pozita në shërbimin civil me posedimin dhe pasurinë ekzistuese”.
87. Për më tepër, Kryeministri shton se “[...] neni 99 dhe 67 i ligjit të kontestuar respekton të drejtën e fituar, parashikueshmërinë dhe pritjet legjitime si elemente të sigurisë juridike, për faktin se edhe në rastet kur nëpunësi nuk rezulton kandidat i suksesshëm për pozitën e caktuar drejtuese nëpunësit publik, për një periudhë të caktuar kohore (4 vite) i garantohet e drejta e pagës në përputhje me pozitën që ka gëzuar sipas ligjit.”

(v) *Përkitazi me interesin e përgjithshëm*

88. Kryeministri thekson se “[...] interesi i përgjithshëm publik i përcaktuar nga autoriteti publik në këtë rast përfshin por pa u kufizuar në krijimin e një administrate efikase, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe mbi bazën e meritokracisë për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve si e mirë e përbashkët e të gjithë shoqërisë”.
89. Po ashtu, Kryeministri përmend se: “*Një aspekt tjetër thelbësor i interesit publik është hapja e mundësisë për përfshirjen e grave, komuniteteve jo shumicë dhe personave me aftësi të kufizuar në pozita drejtuese të mesme dhe të ulëta të shërbimit civil siç mundëson përmbajtja e ligjit të kontestuar*”. Në këtë kontekst, ai citon statistikën e pjesëmarrjes së grave në pozita të larta të nivelit drejtues që është 19 (nëntëmbëdhjetë) %, në nivelin e mesëm 16 (gjashtëmbëdhjetë) % dhe në nivelin e ulët 30 (tridhjetë) %.
90. Në fund, Kryeministri konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës “[...] janë qartazi të pabazuara dhe së këndejmi nenet e kontestuar nga të njëjtët janë tërësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat ndërkombëtare të përfshira në të dhe që respektohen nga Republika e Kosovës.”

## Komentet e dorëzuara nga Avokati i Popullit më 30 janar 2023

91. Më 30 janar 2023, Avokati i Popullit dorëzoi komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, ku fillimisht theksoi se ka pranuar ankesë nga Sindikata e Administratës së Kosovës, me kërkesën që Ligji i kontestuar të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën.
92. Avokati i Popullit, ndër të tjera, pohon se: *“[...] ka vërejtur se me ligjin e kontestuar janë marrë parasysh shumica e qëndrimeve të Gjykatës Kushtetuese të paraqitura përmes Aktgjykimit KO 203/19, mirëpo edhe përkundër këtij fakti, është akoma e nevojshme të sqarohen disa çështje që Avokati i Popullit vlerëson se Gjykata Kushtetuese duhet t'i ketë parasysh gjatë vlerësimit të Kërkesës KO 216/22.”*
93. Në lidhje me nenin 9 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit thekson se: *“[...] ka vërejtur se me LZP-në, për pozitat specifike të zyrtares/it publik/e mund të kërkohej përshtatshmëria si dhe/apo kritere specifike shtesë (neni 9, paragrafi 2)”. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit pohon se ka vërejtur që me Ligjin e kontestuar “[...] nuk është përcaktuar se cilat pozita konsiderohen pozita specifike, për të cilat duhet të kërkohej përshtatshmëria dhe kriteret specifike shtesë”, andaj, i njëjti konsideron se: “[...] norma ashtu siç është e përcaktuar në nenin 9, paragrafi 2, është e paqartë dhe mund të prodhojë pasiguri juridike [...]je bën të pamundur edhe parashikimin e normës, elemente këto të sundimit të ligjit”.*
94. Përkitazi me nenin 12 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit, ndër të tjera, pretendon se ky nen *“[...] nuk e përcakton kufizimin e kompetencës së Qeverisë ndaj personelit të institucioneve të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 4, të po të njëjtit ligj, e që rezulton me cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve si dhe cenimin e pavarësisë organizative të institucioneve të pavarura kushtetuese”. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se: “[...] Kuvendi i Republikës së Kosovës në këtë rast ka dështuar ta zbatonte kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në paragrafin 115, si dhe konstatimet e përcaktuara në paragrafët 134 dhe 135 të Aktgjykimit KO 203/19”.*
95. Lidhur me nenin 46 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit konsideron se: *“[...] vendosja e udhëheqësve të ulët dhe të mesëm drejtues nga pozita e karrierës në pozitën mandatare, jo vetëm që e cenon qëndrueshmërinë e shërbimit civil, por edhe pritshmërinë legjitime, sepse themelimi i marrëdhënies së punës është realizuar nëpërmjet rregullave (legjislacionit) të cilat e kanë garantuar kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës pa afat”. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit, thekson, ndër të tjera, si në vijim:*
- “Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNJ-së (shih rastet Kopecky v. Slovakia, aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, §45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794198, § 73, GjEDNj 2002-VIJ), "pritshmëria legjitime" duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e nëpunësve civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, bazohet në të drejtën e fituar nga dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, gjatë periudhës sa ky ligj ka qenë në zbatim.”*
96. Për më tepër, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh *“[...] qëndrimet e Gjykatës të paraqitura në paragrafët 177, 178 dhe 185 në Aktgjykimin KO171/18, thekson se përshtatshmërisht me situatën e theksuar më sipër, edhe në rastin konkret dallimi në trajtim i nëpunësve civil të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me nëpunësit e tjerë*

*drejtues, për sa i përket çështjes së kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, rezulton me cenimin e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës”.*

97. Në fund, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që (i) të vlerësojë nëse paragrafi 2 i nenit 9; (ii) paragrafi 1 i nenit 12; dhe (iii) neni 46 i Ligjit të kontestuar janë në përputhje me Kushtetutën, respektivisht ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë organizative të institucioneve të pavarura kushtetuese, si dhe nenet 7 dhe 24 të Kushtetutës.

**Komentet e dorëzuara nga deputeti Valon Ramadani, në emër të grupit parlamentar të LVV-së, të 30 janarit 2023**

98. Më 30 janar 2023, z. Valon Ramadani, deputet i Kuvendit, dorëzoi në Gjykatë komentet e grupit parlamentar të LVV-së në lidhje me rastet KO216/22 dhe KO220/22.
99. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e Grupit Parlamentar të LVV-së përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe Ligjin e kontestuar, duke përfshirë ato që ndërlidhen me (i) pjesën procedurale dhe atë materiale, gjegjësisht (ii) nenin 9 të Ligjit të kontestuar; (ii) nenin 12 të Ligjit të kontestuar; (iii) nenin 46 të Ligjit të kontestuar; dhe (iv) paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar.

*(i) Përkitazi me pretendimet për shkeljet procedurale gjatë miratimit të Ligjit të kontestuar*

100. Në lidhje me pretendimet për shkelje procedurale gjatë shqyrtimit dhe miratimit të Ligjit të kontestuar, grupi parlamentar i LVV-së fillimisht i konsideron qartazi të pabazuara dhe që bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, nuk janë çështje kushtetuese dhe kështu nuk mund të jenë objekt i vlerësimit para saj.

101. Grupi Parlamentar i LVV-së pohon se neni 77 i Kushtetutës rregullon emërimin e komisioneve të përhershme, funksionale dhe *ad hoc* dhe në lidhje me këto komisione thekson si në vijim: “[...] në asnjë mënyrë nuk rregullojnë procedurën kushtetuese të miratimit të ligjeve në këto komisione. Kështu procedura e shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve në trupat e Kuvendit është çështje ligjore dhe rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit”. Në këtë kontekst, të njëjtit i referohen rastit të Gjykatës KO115/13, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 dhjetorit 2013, ku në paragrafët 37, 46 dhe 47, theksohet si në vijim:

*“37. Neni 113.5 i Kushtetutës lejon Gjykatën Kushtetuese të vendosë vetëm për kushtetutshmërinë e “...çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi ...”. Ai nuk e autorizon Gjykatën që të vendosë nëse aktet ose vendimet e tjera të brendshme të Kuvendit janë në pajtim me Kushtetutën.*

*[...]*

*46. “Vendimi” i Kryesisë së Kuvendit, dallon nga një vendim i Kuvendit për të cilin kërkohet shumica e votave të deputeteve që janë të pranishëm dhe që votojnë.*

*47. Në mënyrë që një akt i Kuvendit të bëhet vendim, duhet të kalojë në procesin e votimit në Kuvend siç parashihet me nenin 65.1 të Kushtetutës.”*

102. Grupi parlamentar i LVV-së gjithashtu thekson se: “Shqyrtimi dhe votimi i Projektligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë plotësisht në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, përcaktimeve të qarta të Rregullores për funksionet e komisioneve, rolin e tyre në shqyrtimin e projektligjeve dhe të raporteve me amendamente, afatet brenda të cilave veprojnë, si dhe efektet e mosveprimit brenda afateve të përcaktuara qoftë me Rregullore, qoftë me vendim të seancës mbi shkurtimin e atyre afateve”.

103. Për më tepër, grupi parlamentar i LVV-së sqaron procedurën e miratimit të projektligjeve kur kjo bëhet në kuadër të nenit 123 (Shmangia nga afatet procedural) të Rregullores së Kuvendit, me ç'rast, thekson si vijim: *“Mbështetur në Rregulloren e Punës së Kuvendit, shqyrtimi i projektligjit nëpër komisione të përhershme parashihet brenda afateve të përcaktuara. Funkzioni i komisioneve të Kuvendit është për ta ndihmuar Kuvendin. Shqyrtimi ose jo i një projektligji nëpër komisionet e përhershme nuk paraqet kusht për renditjen ose jo, për shqyrtimin ose jo në seancë plenare. Mosshqyrtimi i projektligjit nga ndonjëri apo secili komision i përhershëm brenda afatit të përcaktuar nuk mund ta bllokojë dhe nuk e bllokoi shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit në seancë plenare.”*
104. Po ashtu, grupi parlamentar i LVV-së në lidhje me pretendimin se projektligji nuk është shqyrtuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve si komision i përhershëm i Kuvendit, përsërit argumentet se sipas praktikës së Kuvendit i njëjti ka shkuar për shqyrtim në këtë Komision në afat të përcaktuar në Vendimin përkatës për shmangie të Rregullores, dhe nëse pas këtij afati, nuk janë përgatitur rekomandimet e komisionit, projektligji vijon për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.
105. Në fund, grupi parlamentar i LVV-së thekson se: *“Supozimi se një projektligj duhet domosdoshmërisht të shqyrtohet nga secili komision i përhershëm pa një afat të përcaktuar, do ta pamundësonte funksionin kryesor të Kuvendit siç është ai për miratimin e ligjeve dhe as nuk është kërkesë kushtetuese një gjë e tillë”.*
- (ii) Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për nenin 9 të Ligjit të kontestuar*
106. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e parimit të sigurisë juridike përmes detyrimit për kriterin e përshtatshmërisë, grupi parlamentar i LVV-së, konsideron se ky pretendim është i pabazuar. Të njëjtit theksojnë në këtë kontekst se: *“[...] parimi i sigurisë juridike nuk ka karakter absolut dhe, në veçanti, duhet të balancohet me interesin e përgjithshëm publik: “... parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.”*
107. Grupi parlamentar i LVV-së thekson se: *“Sado që sipas vlerësimit të Komisionit të Venecias, parashikueshmëria është e domosdoshme në legjislacionin penal dhe ka relativisht më pak peshë në fushën administrative siç është rasti me Ligjin e Kontestuar, nuk ka dyshim që parashikueshmëria edhe në rastin konkret është përmbushur”. Ky grup parlamentar po ashtu pretendon se: “[...] interesi i përgjithshëm publik është me rëndësi primare. Kjo për shkak se kriteret e përshtatshmërisë e kanë për qëllim plotësimin e pozitive specifike në sektorin publik me individë të cilët janë të përshtatshëm në kuptim të integritetit në raport me pozitën përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën specifike”. Në këtë drejtim, grupi parlamentar i LVV-së potencon se: “[...] mospërdorimi i kriterëve të përshtatshmërisë mund të shkaktojë rrezik për interesa të rëndësishme shtetërore. Pikërisht në raste të tilla, “qasja parandaluese” është vlerësuar nga Komisioni i Venecias si e domosdoshme për interesin shtetëror dhe publik”.*
108. Ndërsa, sa i përket pretendimit për mos rregullimin e kriterit të përshtatshmërisë përmes Ligjit të kontestuar por me akt nënligjor, grupi parlamentar i LVV-së i referohet praktikës së shteteve tjera, gjegjësisht SHBA-ve, që në këtë rast ka përcaktuar kriterin



e përshtatshmërisë me akt nënligjor, konkretisht me Kodin e Rregulloreve Federale, seksioni 731.202 (b) (Criteria for making suitability determinations, specific factors [Kriteret për përcaktimet e përshtatshmërisë, faktorët specifik]). Për më tepër, të njëjtit theksojnë se kriteret e përshtatshmërisë të parashikuara me këtë akt nënligjor përcaktohen ekskluzivisht vetëm me aktin nënligjor, dhe nuk përmenden paraprakisht askund në ligjin që shërben si bazë për nxjerrjen e këtij akti.

*(iii) Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për nenin 12 të Ligjit të kontestuar*

109. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që neni 12 i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me parimin e ndarjes së pushteteve, të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës, grupi parlamentar i LVV-së thekson se parashtruesi: “[...] nuk ofron asnjë argument se pse ky nen është në kundërshtim me nenin 4 të Kushtetutës” dhe se gjithashtu shton se: “Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ngritja e pretendimit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konstatuar shkelje të neneve kushtetuese”.
110. Në këtë kontekst, grupi parlamentar i LVV-së thekson se: “[...] kapitulli II i Ligjit të Kontestuar përcakton se si dhe nga kush bëhet administrimi i zyrtarëve publikë, ndërsa neni 12 i tij përcakton Qeverinë si organin kryesor për miratimin dhe koordinimin e politikave të përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarit publik. Ky përcaktim në asnjë moment nuk cenon nenin 4 të Kushtetutës - sepse nuk duhet të lexohet i ndarë nga nenet e tjera të Ligjit të Kontestuar [...]”. Po ashtu, grupi parlamentar i LVV-së në këtë drejtim citon nenet e Ligjit të kontestuar që përmbajnë autorizimet specifike për institucionet e pavarura kushtetuese, të cilat kanë prerogativën e nxjerrjes së akteve të veçanta që burojnë nga ky ligj.

*(iv) Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për nenin 46 të Ligjit të kontestuar*

111. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës se neni 46 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së dhe dispozitat e Kushtetutës, grupi parlamentar i LVV-së i konsideron qartazi të pabazuara për shkak se Gjykata bazuar në juridiksionin e saj kushtetues nuk kryen kontrollin kushtetues të ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare, dhe as këto të fundit nuk janë objekt kontrolli i kushtetutshmërisë.
112. Në cilësinë e palës kundërshtare dhe në respekt të Gjykatës, grupi parlamentar i LVV-së argumenton para Gjykatës se Ligji i kontestuar është në përputhje me nenin 120 të MSA-së, për arsye se: “[...] marrëdhënia e punës, përfshirë edhe rekrutimin, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese ashtu siç përcaktohet në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Kontestuar”. Ndër të tjera, grupi parlamentar i LVV-së thekson se neni i lartcekur i MSA-së kërkon që: “[...] bashkëpunimi do të përqendrohet ndër të tjera në zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, gjë që garantohet përmes Ligjit të Kontestuar, i cili i mundëson çdo të punësuar të avancojë në pozitë përmes konkurseve të hapura dhe publike”.
113. Në këtë drejtim, grupi parlamentar i LVV-së thekson se: “[...] kërkesa e MSA-së që Republika e Kosovës të sigurojë zhvillimin e karrierës nuk nënkupton që karriera taksativisht mund të zhvillohet vetëm përmes një sistemi”. Të njëjtit në këtë kuptim, pretendojnë se zhvillimi i karrierës arrihet me cilindo sistem të aplikueshëm aktualisht nga shtetet e Bashkimit Evropian, të cilat mund të përmbledhen në sistem të pozitës, sistem të karrierës dhe sisteme duale.

114. Grupi parlamentar i LVV-së po ashtu pohon se parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur pretendimet e tyre lidhur me shkeljen e parimeve të SIGMA-s dhe praktikave më të mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, për shkak se mungon referenca e saktë në këto parime, dhe thekson se: “[...] për dijeni të Gjykatës Kushtetuese se parimet lidhur me fushën e administratës publike të këtij instituti profesional që bashkëpunon me BE-në janë në zhvillim e ndryshim dhe aktualisht janë publikuar “Draft revised Principles of Public Administration, 16 January 2023”, për të cilat Republika e Kosovës Qeveria është ftuar për të ofruar komente”.
115. Në këtë kontekst, të njëjtit shtojnë se edhe: “[...] rregullimi i fushëveprimit të nëpunësve civilë të institucioneve të shteteve anëtare nuk ka rregullim homogjen”, të cilën sipas tyre, e vërteton edhe Opinioni Ligjor i Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për Projektligjin për Zyrtarët Publikë, me nr. ref. 608-2624-2-2022, i 18 nëntorit 2022.
116. Grupi parlamentar i LVV-së në fund thekson se në frymë të transparencës, hartuesi i Ligjit të kontestuar është konsultuar me palët e interesit dhe se ka adresuar një numër të madh të komenteve, posaçërisht ato të SIGMA-s. Lidhur me këto komente, të njëjtit theksojnë se: “Nga përfaqësisht nëntëdhjetë e tre (93) komente të SIGMA-s nuk janë pranuar dhe adresuar më pak se katërmëdhjetë (14) komente, pra më pak se 15% të tyre”.
- (v) Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për nenin 99 të Ligjit të kontestuar
117. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se paragrafi 2 i nenit 99 të Ligjit të kontestuar bie në kundërshtim me nenet 7, 22, 46 dhe 49 të Kushtetutës, grupi parlamentar i LVV-së thekson se vlerat e mbrojtura nga këto dispozita kushtetuese “[...] jo që nuk preken në asnjë rast e në asnjë rrethanë me ligjin e kontestuar, por lartësohen e çmohen”.
118. Përkitazi me pretendimin për largim kolektiv të 1600 (një mijë e gjashtëqind) nëpunësve civil, grupi parlamentar i LVV-së, thekson si në vijim: “[...] të gjithë personat që mbajnë pozitën e nivelit të ultë dhe të mesëm drejtues nuk do të humbin punën e për më tepër, nuk do t’iu ndërpritet marrëdhënia e punës pa afat të caktuar, sipas aktit të emërimit. Pra, të gjithë këta persona sipas nenit 99, paragrafit 4 do të mbesin pjese e shërbimit civil, subjekt i rregullave të parapara me këtë ligj. Shpallja e këtyre pozitave është reflektim i qëllimit të ligjvënësit që pozitën e ulëta dhe të mesme drejtuese të jenë pozita me afat të caktuar kohor, jo si kufizim sa si zgjerim i mundësive.” Për më tepër, të njëjtit pretendojnë se shpallja e këtyre konkurseve nuk prek marrëdhënien e punës së zyrtarëve aktual publikë që buron nga statusi i të qenit nëpunës civil, andaj, kësaj, nuk duhet barazuar pozita aktuale me statusin e shërbyesit civil sepse ligjet e shërbimit civil nuk rregullojnë pozitën por marrëdhënien e punës së nëpunësit civil.
119. Në këtë drejtim, grupi parlamentar i LVV-së argumenton si në vijim: “Përderisa statusi i përhershëm i nëpunësit civil, pra marrëdhënia e punës, nuk cenohet, vet koncepti i pozitës në shërbimin civil nuk ka asnjë elemente të të drejtave të fituara. Pozitat në shërbimin civil varen nga evoluimi dhe ndryshimet e vazhdueshme të zhvillimit të institucioneve ato nuk janë statike dhe si të tilla bartja e tyre nuk mund të krijojë asnjë pritshmëri jashtë asaj të rregulluar me ligj për bartësit.”
120. Grupi parlamentar i LVV-së po ashtu pohon se: “E drejta e fituar në formën që pretendojnë parashtruesit nuk ndërlihet me nenin 49 të Kushtetutës”, e cili garanton të drejtën e punës. Të njëjtit gjithashtu theksojnë se: “[...] nuk përfshihet as në

*Kushtetutë, as në Konventat ndërkombëtare dhe as në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, privilegjin për të mbajtur përgjithmonë një pozitë të caktuar drejtuese”.*

121. Në këtë kontekst, grupi parlamentar i LVV-së potencon se: *“Marrëdhënia e punës siç përcaktohet në secilin aktemërim buron nga statusi i të qenit nëpunës civil dhe jo me pozitën përkatëse në administratën publike”* dhe se e njëjta nuk mund të konsiderohet e drejtë e fituar. Për këtë, thirret në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (respektivisht, rastet e GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës* dhe *X kundër Gjermanisë*, raste të cituara më lart) si dhe atë të Gjykatës (shih rastin e Gjykatës KI189/19, rast i cituar më lart), duke theksuar që kjo jurisprudencë nuk: *“[...] afirmon të “drejtën e fituar” për të garantuar përfitimin e benefiteve nga puna që kryhet në të ardhmen”*. Respektivisht, grupi parlamentar i LVV-së konsideron se: *“[...] pritshmëritë legjitime trajtohen në rastet e posedimit, pasuritë dhe pronës ekzistuese. Në asnjë rast nuk ndërlihet pozita në shërbimin civil me posedimin dhe pasurinë ekzistuese”*.
122. Gjithashtu, grupi parlamentar i LVV-së potencon se Ligji i kontestuar reflekton interesin e përgjithshëm publik që sipas tyre konsiston por nuk kufizohet në krijimin e një administrate efikase, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe mbi bazën e meritokracisë për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve si e mirë e përbashkët e të gjithë shoqërisë, si dhe mundëson përfshirjen e grave, komuniteteve jo shumicë dhe personave me aftësi të kufizuara në pozita drejtuese të mesme dhe të ulëta të shërbimit civil.
123. Në fund, grupi parlamentar i LVV-së konkludon se: *“[...] pretendimet e palëve parashtruese janë qartazi të pabazuara dhe së këndejmi nenet e kontestuara nga të njëjtët janë tërësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat ndërkombëtare të përfshira në të dhe që respektohen nga Republika e Kosovës.”*

### **Komentet e dorëzuara nga ZRRE më 19 janar 2023**

124. Më 19 janar 2023, ZRRE dorëzoi në Gjykatë komente për Ligjin e kontestuar, ku fillimisht theksoi se është agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës, e themeluar me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për ZRRE) në përputhje me paragrafin 5 të nenit 119 [Marrëdhëniet Ekonomike] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
125. Në vijim, Gjykata do të përmbledhë komentet e ZRRE-së përkitazi me (i) kundërshtimet për Ligjin e kontestuar; (ii) pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të ZRRE-së sipas legjislacionit ndërkombëtar dhe kërkesave të *Acquis* për sektorin e energjisë; (iii) dispozitat legislative rreth financimit të ZRRE-së – *“të Ardhurat e dedikuara”*; (iv) ligjet e tjera që ndërhyjnë në *“aftësinë”* e ZRRE-së; (v) kërkesat e organizatave ndërkombëtare; dhe (vi) *“aftësinë”* e ZRRE-së për t’iu përgjigjur kërkesave të *Acquis* të energjisë.

#### *(i) Kundërshtimet përkitazi me Ligjin e kontestuar*

126. ZRRE konsideron, se si agjenci e pavarur e themeluar me ligj bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, nuk do të duhet të ishte e përfshirë në përkufizimin e nën-paragrafit 2 të paragrafit 1 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se: *“[...] institucion i administratës shtetërore – nënkupton Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë, Agjencinë Ekzekutive, Agjencinë Rregullatore, përfshirë degët lokale të tyre”*. Në këtë drejtim, ZRRE, thekson se: *“[...] është agjenci e pavarur e themeluar në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe do të duhet të kishte trajtim të veçantë në*

përkufizim si institucion tjetër shtetëror, i cili gëzon pavarësi të plotë funksionale dhe organizative”.

127. Tutje, ZRRE thekson se “[...] neni 5 i ligjit të kontestuar ku trajtohen kategoritë e zyrtarëve publik, stafi i ZRRE me vet faktin e përfshirjes në nën-punës civil, kjo përbën një ndërhyrje në stafin profesional si nëse referohemi në Ligjin e Rregullatorit për Energji nr. 03/L-185 të vitit 2010 në mënyrë decisive në Nenin 7 ishte definuar që: “Asnjë anëtar i Bordit apo punonjës i ZRRE nuk ka status të nëpunësit civil”. Ndërsa mënyra e punësimit në atë kohë është rregulluar sipas Ligjit të Punës, dhe është zbatuar edhe me kontrata afatgjata për personelin e ZRRE.”
128. ZRRE kundërshton edhe paragrafin 14 të nenit 39 të Ligjit të kontestuar, i cili definon që “Qeveria me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për procedurat e rekrutimit dhe vlerësimin e kandidatëve sipas këtij neni”, për shkak se e njëjta konsideron se: “[...] duhet të lejohet pavarësi e plotë edhe në rastin e ZRRE, duke marr parasysh obligimet kushtetuese dhe legjisacionin përkatës, që procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit të rregullohen me atë të veçantë nga ZRRE si institucion i pavarur”.
129. Po ashtu, ZRRE konsideron se neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk duhet të vlejë në rastin e ZRRE-së me arsyetimin se “[...] pozitat përkatëse në rregullator janë pozita specifike (expert kyç) dhe janë të rregulluara me afat të pacaktuar sipas Ligjit të Punës në fuqi, dhe ndërhyrja e tillë do të ishte në kundërshtim të plotë edhe me normat juridike dhe të drejtat e fituara përmes një ligji i cili ka qenë në fuqi në momentin e zgjedhjes. Po ashtu edhe Nenin 47 të Ligjit të kontestuar në rastin e ZRRE nuk do të duhej të aplikohet par. 12, por të rregullohet sipas par. 13 ku ZRRE me akt të veçantë të miratuar të rregulloj edhe emërimin në pozitat e larta drejtuese”.
130. Sa i përket nenit 99 të Ligjit të kontestuar, ZRRE konsideron se: “[...] kjo dispozitë cenon rënd të drejtat e të punësuarve, pasi që të njëjtët veç i kanë fituar të drejtat me kontrata të pacaktuara afatgjate sipas Ligjit të Punës, dhe përmes kësaj dispozite, shkelen të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të drejtat e fituar përmes një ligji që ka qenë në fuqi në kohën e punësimit, nuk mund të merret përmes një ligji të më vonshëm, pasi që cenon rënd të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me normat ndërkombëtare”. Të njëjtit theksojnë se kjo dispozitë nuk mund të aplikohet: “[...] assesi në institucionet e pavarura dhe ato të themeluara me ligj siç është ZRRE, pasi që cenon pavarësinë funksionale dhe organizative të ZRRE-së, të garantuar me Kushtetutë dhe të përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin për Energji [...]”.

(ii) Përkritazi me pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të ZRRE-së sipas legjisacionit ndërkombëtar dhe kërkesave të Acquis për energjinë

131. ZRRE, ndër të tjera, pretendon se: “Në Ligjin për Zyrtaret Publik në mënyrë të dyshimtë i revokohet statusi i pavarur i ZRRE-së, duke lënë hapësirë për keqinterpretime që kanë tendenca për klasifikimin e ZRRE si “agjenci rregullatore”, duke injoruar kështu kategorinë kushtetuese të agjencisë së pavarur të themeluar me Ligj.”, dhe se sipas Ligjit të kontestuar, “[...] ZRRE klasifikohet si organizatë administrative, që nuk është në përputhje me natyrën e funksionit të saj statutor sipas ligjit vendor dhe të Komisionit Evropian”, respektivisht paragrafin 4 të nenit 35 të [Direktivës 2009/72/EC](#) së 13 korrikut 2009 për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe paragrafin 4 të nenit 39 të [Direktivës 2009/73/EC](#) së 13 korrikut 2009 për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyral.

132. Më tutje, ZRRE thekson se: *“Të gjitha ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për rregullatorin e energjisë, në vitin 2004 (Nr.2004/9), 2010 (Nr. 03/L-185) dhe 2016 (Nr. 05/L-084) e të cilat rregullonin fushëveprimin e ZRRE-së kanë paraparë pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të Rregullatorit përmes legjislacionit primar”, si dhe në përputhje me kërkesat e Acquis, në veçanti Direktivën e Tregut të Brendshëm.*
133. Si përfundim, ZRRE konkludon se ligjet e Kosovës të sektorit të energjisë dhe Direktivat e Bashkimit Evropian, kërkojnë që Kosova të ruajë pavarësinë financiare dhe operative të ZRRE-së.

*(iii) Përkitazi me dispozitat legislative rreth financimit të ZRRE-së – “të Ardhurat e dedikuara”*

134. ZRRE pretendon se si agjenci e pavarur, në kuptim të Kushtetutës, ka të drejtë të fitojë *“të ardhura të dedikuara”* nga një burim i specifikuar, përkufizim ky që rrjedh nga paragrafi 1 i nenit 1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, i cili përcakton ato si në vijim: *“[...] paratë publike që rrjedhin nga një burim i caktuar i të ardhurave dhe që me ligj ose Rregullore të UNMIK-ut kërkohet që të alokohen për një organizatë të caktuar buxhetore dhe/ose për një qëllim të caktuar; megjithatë “të ardhurat e jashtëzakonshme” nuk konsiderohen si të ardhura të dedikuara”.*
135. ZRRE konsideron se: *“Dispozitat e mësipërme ligjore provojnë përtej çdo dyshimi se ZRRE, e vetme, e ka autoritetin dhe të drejtën të zhvillojë buxhetin e saj vetjak, duke e përdorur këtë parashikim të shpenzimeve të kërkuara për të përcaktuar taksa ujetore që duhet të paguhen nga kompanitë e licencuara [...]”, pasi që: “[...] Qëllimi i ligjit këtu është që ZRRE të jetë e çliruar nga kufizimet në paga të cilat aplikohen për sektorin publik, i cili punon për Qeverinë dhe, duke vepruar kështu, që ta lejojë atë të rekrutojë dhe mbajë staf të kualifikuar”.*

*(iv) Përkitazi me ligjet e tjera që ndërhyjnë në aftësinë e ZRRE-së*

136. ZRRE pretendon se: (i) Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (në tekstin e mëtejshëm: LOFASHAP); (ii) Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Paga), të cilët e kualifikojnë pozitën në ZRRE konform organizimit të paraparë në kuadër të organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura; si dhe (iii) Ligji i kontestuar, i cili e kualifikon stafin e ZRRE-së si zyrtar publik, gjegjësisht nëpunës civil; nuk marrin në konsideratë rëndësinë dhe peshën që duhet ta ketë ZRRE e që sipas direktivave të Bashkimit Evropian kërkohet trajtim i veçantë për rregullatorët e energjisë, andaj, sipas saj, cenonë aftësinë e ZRRE-së për të implementuar detyrat e kërkuara me ligjet e aplikueshme të sektorit të energjisë.

*(v) Përkitazi me kërkesat e organizatave ndërkombëtare*

137. Sa i përket kërkesave të organizatave ndërkombëtare për autoritetet rregullatore të energjisë, ZRRE citon Direktivën (EU 2019/944) e Parlamentit Evropian për Organizim të Tregut të Brendshëm, e cila kërkon që shtetet anëtare të sigurohen që autoriteti rregullator të jetë edhe i pavarur, dhe të ketë *“[...] burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për kryerjen e detyrimeve të tij”.* Në këtë kontekst, ZRRE thekson se: *“Sekretariati i Komunitetit të Energjisë duke filluar nga viti 2014, ka vlerësuar (pa)pajtueshmërinë e Kosovës me këtë aspekt [...]”* dhe se në mënyrë që kjo të realizohet duhet që *“[...]pagat e anëtarëve të stafit duhet të jenë të pajtueshme me nivelet e pagave të industrisë së rregulluar, me qëllim që të shmanget “rrjedhja e*

*trurit” drejt industrisë dhe t’i mundësojnë ZRRE-së që të tërheqë dhe të mbajë burime njerëzore të kualifikuara dhe të mjaftueshme për të zbatuar përgjegjësinë e saj”.*

138. Për më tepër, ZRRE përmend edhe të gjeturat e raporteve të progresit për Kosovën, të publikuara nga Drejtorati i Komisionit Evropian për Zgjerimin të viteve 2014, 2015, 2016, 2018, 2019, 2020, ku në vazhdimësi theksohet domosdoshmëria për pavarësinë financiare të ZRRE-së.
139. ZRRE thekson po ashtu pikën 2.2. të Udhëzimit mbi Pavarësinë e Autoriteteve Rregullatore Nacionale, ku Sekretariati i Komunitetit të Energjisë përcakton *“Duhet të jetë e drejta e bordit për të vendosur lirshëm për punësimin dhe shkarkimin e stafit, numrin e stafit të nevojshëm për kryerjen e detyrave rregullatore”* si dhe që *“Pagat e stafit të Autoriteteve Rregullatore duhet të jenë konkurruese me atë të industrisë së rregulluar”* dhe që të njëjtat Bordi duhet t’i vendosë lirshëm.
140. ZRRE në fund citon edhe Raportin e OECD/SIGMA, të publikuar në vitin 2021 për konkurrencën në Evropën jug-lindore, ku theksohet se: *“ZRRE është duke bërë çdo gjë brenda aftësive të tyre për të rekrutuar dhe mbajtur stafin e kualifikuar, andaj çfarëdo reduktim më tutje i pagave do ta zhvesh atë nga stafi i kualifikuar”.*

*(vi) Përkitazi me aftësinë e ZRRE-së për t’iu përgjigjur kërkesave të Acquis të energjisë*

141. Pasi që ZRRE në këtë pjesë të komenteve të saj përmend komunikimin me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, me seli në Vjenë të Austrisë, respektivisht reflekton letrën e këtij Sekretariati drejtuar ZRRE-së më 22 dhjetor 2022, si dhe me Bordin Rregullativ i Komunitetit të Energjisë, me seli në Shkup të Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht letrën e këtij bordi drejtuar ZRRE-së më 21 dhjetor 2022, të cilat letra i ka dorëzuar në Gjykatë së bashku me komente, andaj, në vijim Gjykata do t’i referohet përmbajtjes së të njëjtave.
142. Në letrën e 22 dhjetorit 2022, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë thekson, ndër të tjera, se është njoftuar për iniciativat e reja ligjore në fushën e zyrtarëve publikë dhe pagave në sektorin publik, dhe se sipas tyre: *“Ndryshimet e propozuara do të sjellin një qasje uniforme për përcaktimin e shpërblimit bazuar në parimin e aplikimit të koeficientëve të veçantë për një pagë bazë. Koeficientët e lartpërmendur do të përcaktoheshin me Ligjin për Buxhetin Vjetor, i cili nga ana e tij hartohet dhe propozohet nga Qeveria në baza vjetore. Llogaritjet tona identifikojnë se zbatimi i tij do të rezultonte në uljen e pagave individuale të stafit të ZRRE-së mesatarisht nga 40% deri në 65% në varësi të pozitës”.*
143. Tutje, në po të njëjtën letër, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, pohon se: *“[...] ndryshimet e propozuara në legjislacion kanë potencialin për të minojnë aftësinë operacionale të ZRRE-së dhe aftësinë e saj për të mbështetur staf profesional, i cili është kyç për të kryer detyrat e saj”.*
144. Në këtë kontekst, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kërkon që: *“[...] ndryshimet e propozuara në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë t’i përshtaten konsideratave që duhet t’i kushtohen pavarësisë financiare të ZRRE-së në asnjë mënyrë që kompensimi i Bordit dhe personelit të saj të mos ndikohet në mënyrë të padrejtë. Kjo mund të arrihet ose duke: a) duke diferencuar qartë se pagat e anëtareve të Bordit të ZRRE-se dhe personelit janë përcaktuar në përputhje me dispozitat efektive të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ose b) përjashtimin e drejtpërdrejtë të ZRRE-së nga ndryshimet e propozuara legjislative”.*

145. Në anën tjetër, në letrën e Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, sërisht përmendet ulja e pagave të punonjësve të ZRRE-së nga 40% në 65%, si dhe përkrahjen e kërkesat e legjislativitetit të BE-së dhe ato që derivojnë nga Ligji për ZRRE sa i përket pavarësisë operacionale dhe financiare të ZRRE-së. Të njëjtit, në këtë letër, nënvizojnë “[...] nevojën për t’u përmbajtur nga ndikimi negativ në kapacitetet institucionale të ZRRE-së, gjegjësisht, niveleve të shpërblimit të Bordit dhe personelit pasi përndryshe do të rrezikohet pavarësia në vendimmarrje si dhe aftësia [e ZRRE-së] për të mbajtur personel të kualifikuar”.

**Opinion i ligjor i Zyrës së BE-së në Kosovë për Projektligjin për Zyrtarët Publikë, i 14 dhjetorit 2022, i dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës në rastin KO216/22**

146. Në vijim, Gjykata do të reflektojë të gjeturat e Mekanizmit të Shqyrtimit Legjislativ në kuadër të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Zyra e BE-së në Kosovë) për Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Përderisa të gjeturat përkatëse i referohen një numri më të madh të dispozitave të Ligjit të kontestuar, në vijim do të përmbledhen vetëm komentet përkatëse lidhur me dispozitat e kontestuara të tij nga ana e parashtruesve të kërkesës. Zyra e BE-së në opinionin e saj theksoi se i njëjti u bazua në kontributet e Departamentit të Komisionit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim (në tekstin e mëtejme: DG NEAR), Zyrës së BE-së, Përfaqësuesit Special të BE-së, SIGMA-s dhe ekspertëve të tjerë të financuar nga BE-ja). Po ashtu, ndër të tjera, e njëjta theksoi se: *“Projektligji është ende problematik nga pikëpamja e sigurimit të një shërbimi civil të bazuar në merita, i cili është i aftë të tërheq profesionistët e talentuar dhe të ruaj personelin e kualifikuar. Projektligji shton diskrecion të tepruar në rekrutimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë, duke e bërë shërbimin civil të cenueshëm ndaj politizimit dhe korrupsionit”.*
147. Përkitazi me nenin 46 të Ligjit të kontestuar, Zyra e BE-së në Kosovë, ndër të tjera, nënvizoi se: *“Asnjë administratë nuk i jep fund punësimit të një drejtuesi të njësisë me performancë të mirë vetëm sepse duhet që një mundësi t’i ofrohet kandidatëve të tjerë, potencialisht më të mirë. Prezantimi i mandateve nuk do të adresojë asnjë nga problemet kyçe me të cilat përballet administrata e Kosovës, ndërsa do të krijojë jo-stabilitet dhe pasiguri. Kjo e kufizon atraktivitetin e pozitive drejtuese në shërbimin civil për kandidatët e jashtëm. Pjesëmarrja në procedura të shumta rekrutimi do të përbëjë gjithashtu një barrë shtesë për drejtuesit. Emërimet e ushtruesve të detyrave do të bëhen normë pasi që rekrutimi mund të shpallet vetëm kur të jetë hapur një pozitë e lirë. Ne japim rekomandim të fuqishëm kundër nisjes së një eksperimenti të tillë nga Kosova”.*
148. Në lidhje me nenin 99 të Ligjit të kontestuar, i cili parasheh nisjen e procedurave të rekrutimit për të gjithë drejtuesit e mesëm dhe të ulët në shërbimin civil pas një viti nga hyrja në fuqi e ligjit, Zyra e BE-së në Kosovë, ndër të tjera, theksoi se: *“Hedhja e dyshimeve për kompetencat e të gjithë drejtuesve aktualë dhe detyrimi i tyre për t’iu nënshtruar një procedure të re të rekrutimit, dërgon një sinjal të dëmshëm tek të gjithë nëpunësit civil. Ky hap i pajustificuar do të krijojë kaos në administratë, për më tepër kjo gjendje e fluksit do të zgjatet, pasi që nuk është e mundur që të organizohen qindra rekrutime gjatë një periudhe prej disa ditësh apo javësh (janë mbi dy mijë pozita që i përkasin kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në Kosovë). Gjithashtu mbetet edhe pyetja, nëse të gjithë lirohen brenda një viti, kush do të merr pjesë në komisionet e pranimit nëse pikërisht shumica e drejtuesve marrin pjesë në këto konkurse? Përfundimisht, ky precedent lehtë mund të hapë rrugën për lirime identike të zyrtarëve nga postet drejtuese kur çfarëdo qeveri e ardhshme të marrë pushtetin”.* Po ashtu, e njëjta rekomandoi që të mos vazhdojë me këtë iniciativë në radhë të parë për shkak të rreziqeve të larta në sigurimin e qëndrueshmërisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike.

149. Lidhur me nenin 98 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton periudhën prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve kur do të vendoset një procedurë e veçantë për rekrutimin, vlerësimin dhe emërimin e kandidatëve, përmes një akti nënligjor, të miratuar nga Qeveria, Zyra e BE-së në Kosovë vlerësoi se: *“Ka një rrezik tepër të madh që gjatë gjithë kësaj periudhe të mos ketë kontroll mbi zbatimin e tyre me standarde të bazuara në meritë dhe konkurrencë që është e vështirë të garantohet, nuk ka siguri të cilësisë së proceseve të rekrutimit dhe rrjedhimisht ka një rrezik të lartë të politizimit”*.
150. Në fund, Zyra e BE-së në Kosovë, ndër të tjera, rekomandoi se: *“Zgjidhja e vetme e pranueshme do të ishte shtyrja e hyrjes në fuqi të neneve përkatëse të LZP-së për një kohë të kufizuar të nevojshme për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe teknike për konkurset e centralizuara (në praktikë shumë më të shkurtra se 18 muaj) dhe përdorimi, deri atëherë, i dispozitave të LZP-së që është aktualisht në fuqi”*.

### **Mendimi Ligjor i SIGMA-s për Projektligjin për Zyrat Publikë, i gushtit të vitit 2022, i dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës KO216/22**

151. Në vijim, Gjykata do të reflektojë të gjeturat e SIGMA-s për Projektligjin për Zyrat Publikë. Përderisa të gjeturat përkatëse i referohen një numri më të madh të dispozitave të Ligjit të kontestuar, në vijim do të përmbliidhen vetëm komentet përkatëse lidhur me dispozitat e kontestuara të tij nga ana e parashtruesve të kërkesës.
152. Fillimisht, përkritazi me parimin e ndarjes së pushteteve, SIGMA në mendimin e saj u shpreh se Projektligji për Zyrat Publikë në njëzet e dy raste ka përcaktuar se organi kompetent i institucionit të pavarur është i autorizuar të miratojë akt të veçantë për rregullimin e mëtejme të çështjeve në vend të Qeverisë, edhe pse, sipas tyre, disa pyetje mbeten gjatë zbatimit të nenit 19 të këtij projektligji përkritazi e fushëveprimin e Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejme: SIMBNJ). Po ashtu, në kontekst të pavarësisë së institucioneve të pavarura, SIGMA thekson si në vijim: *“[...] definicioni i institucionit të pavarur kushtetues (do të thotë institucioni i përcaktuar në mënyrë specifike në kapitujt IV, V, VII, VIII dhe XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës) i dhënë në nenin 4.1.4 mbetet i paqartë, pasi mund të përfshijë ose vetëm institucionet e renditura me emër në këta kapituj të Kushtetutës (pra: Kuvendi, Presidenti, institucionet e sistemit të drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka e Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media, (“si institucionet e përcaktuara në mënyrë specifike”) apo edhe të gjitha agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi sipas nenit 142 të Kushtetutës. Për këtë arsye dhe për të shmangur keqinterpretimet, lista nominative e institucioneve në LZP do të ishte më e përshtatshme këtu”*.
153. SIGMA po ashtu në lidhje me fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, specifikisht për pesë institucionet të cilat mund të qeverisen nga një ligj i veçantë, thekson se:
- “4. [...] fushëveprimi i ligjeve të veçanta që mund të zbatohen për nëpunësit civilë me status të veçantë, duket mjaft i gjerë dhe megjithëse atë duhet të jenë në përputhje me "parimet e përcaktuara në këtë ligj", në praktikë pothuajse të gjithë "elementet e marrëdhënies së punës" mund të rregullohen ndryshe: kushte të veçanta ose shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga atë të parashikuara me këtë ligj; rregulla të veçanta për zhvillimin e karrierës, sipas sistemit të notimit; nevojat për zhvillim profesional dhe trajnim; transferimi dhe sistematizimi i punonjësve madje edhe disiplina. (Neni 6.2)*
- 5. Ajo që është më e paqarta, dhe mund të jetë për shkak të një gabimi në përkthim, është dispozita e nenit 3.1., e cila thotë e LZP nuk zbatohet për zyrtarët e zgjedhur (kuptueshme), anëtarët e qeverisë dhe zëvendësit e tyre (e kuptueshme), funksionare të*



*emëruar nga Kuvendi ose Presidenti, Qeveria, personalitetet apo anëtarëve, organeve kolegjiale drejtuese të institucioneve dhe agjencive të pavarura (e kuptueshme) por edhe - neni 3.1.4 - funksionarë publikë me status të veçantë, sipas paragrafit 4 te nenit 5 te ketë Ligj. Siç tregohet në pikën 3 më sipër, sipas projektit të LZP-së kjo kategori përfshin punonjës të shumë institucioneve, duke përfshirë tre ministri. Nëse LZP nuk zbatohet në përgjithësi për ta (neni 3.1.4) pse do të quheshin nëpunës civilë me status te veçantë?”*

154. Lidhur me kërkesën e “përshtatshmërisë” si kërkesë për pozita specifike në shërbimin civil, SIGMA theksoi se kërkesa e tillë ligjore është “e paqartë”.
155. Tutje, SIGMA në mendimin e saj lidhur me kalimin nga sistemi i karrierës në sistem të pozitës, konsideroi se: *“Futja e mandatit në të gjitha pozitat drejtuese dhe organizimi i konkurseve të hapura për kandidatë nga jashtë shërbimit civil - do ta bëjë sistemin më afër "bazuar në pozita" sesa "bazuar në karrierë". SIGMA ka qenë në favor të hapjes së sistemit, duke pasur parasysh madhësinë e administratës publike të Kosovës, megjithatë, ka rekomanduar rishqyrtimin e gjithëpërfshirës së hapjes së pozitive (a duhet të jenë të gjitha njëloj të hapura për kandidatet e jashtëm ?); duke i dhënë përparësi kandidatëve të brendshëm (me transferime dhe promovim horizontal ndaj kandidatëve të jashtëm [...]). SIGMA po ashtu theksoi vullnetin e Qeverisë që të përmirësojë performancën e nëpunësve civilë përmes kësaj reforme, mirëpo sipas të tyre, perspektiva katërvjeçare në një pozitë nuk siguron performancë më të mirë, sidomos në mandatin e dytë, kur i njëjti nuk mund të zgjatet dhe se në vend të performancës më të mirë, ministrat do të marrin pushtet. Për më tepër, SIGMA e vlerëson këtë kompetencë për të vendosur, si “[...] deri diku në mënyrë arbitrare, për jetën profesionale të nëpunësit civil”.*
156. Për më tepër, SIGMA përkritazi me nenet 46, 67 dhe 99 të Ligjit të kontestuar, të cilat në versionin e Projektligjit për Zyrtarët Publikë ishin numëruar si nenet 46, 66 dhe 98, nënvizoi se: *“Edhe nëse qëllimi i hartuesve ishte të lehtësonin promovimin dhe të siguronin që kandidatëve më të mirë t'u jepej një shans për të luajtur një rol në administratë, rezultati mund jetë i përkohshëm dhe të sjellë efekte të këqija. Në fakt, futja e listës së pritjes/ lista tepricë - neni 66, mund të bëhet - me apo pa dashje - një mënyrë për t'i refuzuar/duke i hequr qafe nëpunësit civilë me përvojë. Ka shumë mënyra për t'u vendosur ne listën e pritjes (te mos fitosh konkursin e organizuar për pozitën e dikujt- neni 98.6, përfundimi i mandatit ne pozitën drejtuese - neni 46.4, neni 49.7, por edhe 66.1 dhe 98.6) por nuk ka mekanizma qe lejojnë institucionin përgjegjës për "sistematizimin" e nëpunësve civilë për ta zbatuar atë ne mënyrë efektive. Dhe pas nëntë muajsh (e paqarte nëse paguhesh apo jo, pasi kjo do te rregullohet nga Qeveria me akt nënligjor, ata lirohen nga shërbimi civil. Ka shumë të ngjarë që numri i nëpunësve drejtues të mirë dhe me përvojë (të cilët thjesht nuk përzgjidhen në një konkurs) do të vendoset në listën e pritjes, veçanërisht pas valës se parë të konkurseve për nivelin e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese (të organizuara një vit pas hyrjes në fuqi të LZP). Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij mekanizmi - si në aspektin e burimeve të vlefshme që duhet të përdoren në mënyrë adekuate brenda administratës ashtu edhe në aspektin e pasojave të mos emërimit brenda nëntë muajve (lirimi) është me rëndësi të madhe që në ligj të vendoset llogaridhënie e qartë për listën e pritjes dhe mekanizma efektive për emërimin e këtyre nëpunësve civilë. Institucioni përgjegjës (MPB?) duhet të ketë kompetencë që të ndalojë çdo procedurë rekrutimi dhe të caktojë drejtpërdrejt një person nga lista e pritjes edhe pa pëlqimin e institucionit ku është hapur konkursi.”*
157. SIGMA sa i përket reformës në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, respektivisht, mandat katërvjeçar, ka mbajtur qëndrim kundër. Lidhur me këtë, SIGMA specifikoi se: *“Mandatet në detyrë*

për nëpunësit civilë në pozita drejtuese nuk janë të zakonshme në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe në mënyrë artikulare atë nuk shihen në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues.” Për këtë reformë, SIGMA, ndër të tjera, u shpreh se: “Futja e tranzicionit dhe konkurrencës së hapur për administratën në ndërtim (me sundim të kufizuar të ligjit, mekanizma të kufizuar llogaridhënieje dhe përvojë të kufizuar në sigurimin e integritetit dhe menaxhimin e konfliktit të interesit mund të çojë lehtësisht në politizimin e administratës publike deri në nivelin e udhëheqësve të njësisve. Për më tepër, administrata bëhet me e ndjeshme ndaj kapjes së shtetit nga interesat e veta, sepse grupe të ndryshme do të tundohen të vendosin njerëzit e tyre brenda sistemit. Sistemi i bazuar në karriere, kur arritja e pozitave vendimmarrëse kërkon më shumë kohe, zakonisht është me pak e prirur ndaj këtij rreziku. Së fundi, me futjen e tranzicionit, ka më pak gjasa që shërbimi civil të funksionojë me autonomi dhe paanësi pasi pranimi i urdhrave të paligjshëm nxitet (veçanërisht nëse një politikan drejtohet nga interesa partiake në vend të sundimit të ligjit)..”. Po ashtu SIGMA, lidhur me këtë nen, konsideroi se dispozita është e paqartë duke theksuar se: “[...] kush do t’i bëjë të gjitha këto emërimet për nëpunësit civilë? Njësia përgjegjëse (MPB) apo titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm? Është e paqartë dhe mund të çojë në mosmarrëveshje kompetencash.”

158. Në lidhje me dispozitat kalimtare të Projektligjit për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 99 të Ligjit të kontestuar, SIGMA konsideroi se lirimi i pozitave drejtuese të nivelit të mesëm dhe të ulët pas një viti të hyrjes në fuqi të ligjit në mënyrë që të organizohen konkurset për plotësimin e pozitave në fjalë: “[...] përfshin një vit pasigurie për të gjithë nëpunësit civilë në postet drejtuese, është dëshmi e mosbesimit ndaj konkurseve të mëparshme (nevoja për t’u rikonfirmuar), do të krijojë ngarkesë masive për institucionet përgjegjëse për konkurset e reja (më shumë që do të organizohen në të njëjtën kohë. Neni 98.5 parashikon një rregullim interesant të zvogëlimit gradual të kompensimit për ata drejtues aktualë që nuk do të emërohen në një procedurë të re dhe të zhvendosen në një kategori profesionale. Këtë ka tri komente: duhet jetë e qartë nëse drejtuesi duhet të marrë pjesë në konkursin e ri apo të përfitojë nga kjo skemë; a nuk duhet të ketë një prag mbi të cilin personi duhet të performojë në një konkurs (nëse njëri merr 70% të pikëve duhet të kompensohet ose jo?) dhe se fundi, nëse diferenca llogaritet ndërmjet pagave bazë apo pagës bazë në pozitë drejtuese dhe paga e plotë në kategorinë profesionale.[...]”
159. SIGMA gjithashtu në mendimin e saj gjithashtu përmend se 43 (dyzet e tri) çështje Qeveria duhet t’i rregullojë me akte nënligjore, si dhe 22 (njëzet e dy) çështje me akt nënligjor të veçantë, të miratuar nga institucionet kushtetuese. Sipas SIGMA-s, fakti që ligji hyn në fuqi dhe nuk pret së paku 6 (gjashtë) muaj që t’i jep mundësinë Qeverisë dhe institucioneve të pavarura të përgatisin aktet nënligjore, në mënyrë që kur ligji të hyjë të fuqi të mund të zbatohet menjëherë, “nuk paraqet praktikë të mirë legjislative”. Të njëjtë e cilëson edhe praktikën e zbatimit të akteve nënligjore të ligjit paraprak me kusht që të mos jenë në kundërshtim me ligjin e ri (Ligjin e kontestuar) për shkak se nuk është e qartë se cilat dispozita ligjore do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore të reja.

### **Përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias**

160. Siç është reflektuar në procedurën para Gjykatës, përkatësisht në paragrafët 19 dhe 20 të saj, kjo e fundit i’u ishte drejtuar me disa pyetje specifike Forumit të Komisionit të Venecias. Gjykata pranoi gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) përgjigje, përmbajtja, përkatësisht përmbledhja e të cilave do të pasqyrohet në vijim.
- (i) Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Lihtejshtajnit

161. Gjykata Kushtetuese e Lihtejshtajnit në përgjigjen e saj, ndër të tjera, theksoi se kuadri i tyre ligjor për shërbimin civil parashikon kriterin e “*përshtatshmërisë*” për të gjitha pozitat, respektivisht citoi dispozitën specifike në Ligjin e tyre për Marrëdhëniet e Punësimit të Nëpunësve Civil, i cili thotë se: “*Kushtet e punësimit janë: përshtatshmëria profesionale dhe personale*”. E njëjta njoftoi Gjykatën se përderisa përshtatshmëria profesionale mund të barazohet kryesisht me arsimimin dhe përvojën, përshtatshmëria personale lejon diskrecionin nga ana e punëdhënësit, dhe se nuk ka asnjë përkufizim të mëtejshëm të “*përshtatshmërisë*” në ligj. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Lihtejshtajnit informoi Gjykatën se marrëdhënia e punës zakonisht krijohet për një periudhë të pacaktuar dhe se nga ky parim përjashtohen praktikantët, si dhe punësimet e bazuara në projekte. E njëjta theksoi se është vetëm një pozitë për të cilin ligji parashikon mandatat me periudhë fikse, me të drejtë rizgjedhje dhe ai është Shefi i Njësisë së Mbrojtjes së të Dhënave. Nëse i njëjti nuk rizgjidhet, humbet pozitën në shërbimin civil. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandatat të pacaktuar shndërrohen në mandatat të caktuara, përgjigja e Gjykatës Kushtetuese të Lihtejshtajnit është negative.

(ii) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjë Hercegovinës*

162. Gjykata Kushtetuese e Bosnjë Hercegovinës në përgjigjen e saj theksoi se Ligji i tyre për Shërbimin Civil përcakton kërkesat specifike akademike dhe profesionale për pozitën që do të plotësohet dhe kërkesat e përgjithshme për emërimin si nëpunës civil (shtetësia, mosha, diploma universitare etj.). Sipas të njëjtës, nuk ka asnjë kriter tjetër, si “*përshtatshmëria*”. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë Hercegovinës njoftoi Gjykatën se sipas ligjit të tyre për shërbimin civil, nëpunësit civilë menaxherialë (*Rukovodeći državni službenici*) ndahen në: 1) Drejtor i Lartë Ekzekutiv (*Sekretar*) dhe Drejtor i Lartë Ekzekutiv me detyrë të veçantë (*Sekretar sa posebnim zadatkom*), dhe 2) Ndihmës Ministër, Ndihmës Drejtor dhe Kryeinspektor, pozita këto që kanë “*mandat të përhershëm*”, përveç pozitës së “*menaxherit të lartë ekzekutiv me detyrë të veçantë*”, që emërohet nga institucioni për një periudhë kohore të caktuar, e cila nuk duhet të kalojë pesë (5) vjet dhe se kohëzgjatja maksimale e një emërimi në të njëjtën pozitë është dhjetë (10) vjet. Përndryshe, nëpunësi civil ka të drejtë në mandatat të përhershëm deri në plotësimin e kushteve për pension, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

(iii) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut*

163. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut në përgjigjen e saj theksoi se Ligji i tyre për Zyrtarët Administrativ përcakton kushtet për punësim në shërbimin civil, megjithatë nuk kërkohet një kërkesë e tillë si “*përshtatshmëria*”. Ligji në fjalë përcakton kushtet e përgjithshme për punësim siç janë: (i) shtetësia maqedone; (ii) përdorimi aktiv i gjuhës maqedone; (iii) mosha madhore; (iv) gjendja e mirë e përgjithshme shëndetësore; dhe (v) të mos kenë ndalesë për të ushtruar profesion, biznes apo detyrë me vendim gjyqësor në fuqi, si dhe kushtet e veçanta për pozitën përkatëse të punës siç janë: (i) kualifikimet profesionale; (ii) përvoja e punës, (iii) kompetencat e përgjithshme të përcaktuara në Kornizën e kompetencave të përgjithshme; dhe (iv) kompetencat e veçanta. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut njoftoi Gjykatën se nëpunësit civilë janë të punësuar me mandatat të përhershëm, pra për një periudhë të pacaktuar, me përjashtim të “*zyrtarëve të kabinetit*”, të cilët kryejnë disa detyra të veçanta në kabinetin e Presidentit të Republikës, në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Qeverisë dhe në kabinetet e ministrave. Sipas ligjit të tyre, zyrtarët e kabinetit janë të punësuar në këto pozita për kohëzgjatjen e mandatit të zyrtarit në kabinetin e të cilit janë të angazhuar, megjithatë, pas përfundimit të mandatit ata nuk e humbasin punën, por caktohen në një pozitë që korrespondon me pozitën që kanë pasur më parë ose mund të kthehen në institucionin nga kanë ardhur.

164. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut theksoi se pavarësisht që ky shtet gjendet në reforma të vazhdueshme, deri më tani asnjë nga masat e reformës nuk ka prekur të drejtat dhe detyrat e punonjësve aktualë në shërbimin civil, pasi të drejtat dhe detyrat e tyre që rrjedhin nga puna janë konsideruar si *“të drejta të fituara”*. Në disa raste kur ky parim nuk është respektuar, Gjykata Kushtetuese në fjalë ka ndërhyrë duke shfuqizuar dispozitat e ligjeve pasi që asnjë tranzicion nuk duhet të rrezikojë sigurinë juridike dhe të drejtat dhe interesat e fituara tashmë me të cilat ato lidhen. Shembull i tillë i praktikës gjyqësore të saj është Vendimi U. nr. 74/2014 i 29 qershorit 2016, përmes të cilit e Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut shfuqizoi disa dispozita të Ligjit për Zyrarët Administrativë që parashikonin detyrimin që zyrtarët administrativë tashmë të punësuar të sigurojnë dëshmi për njohjen e gjuhëve të huaja dhe njohuritë kompjuterike, dhe se në rast të dështimit, ligji parashikonte që ata të caktoheshin në një pozitë më të ulët ose t’u ulej paga. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut në këtë rast vuri në dukje se: *“[...] dispozita e kontestuar krijon një situatë ligjore të humbjes së mundshme të së drejtës së fituar nga punësimi (pozita e fituar e punës, titulli dhe paga), gjë që vë në pikëpyetje ushtrimin e pritjeve legjitime të zyrtarëve administrativë tashmë të punësuar që ata kishin në kohën kur kanë qenë të punësuar me terma dhe kushte të tjera, para miratimit të Ligjit për zyrtarët administrativë”*. Po ashtu, në të njëjtin vendim kjo Gjykatë konstatoi shkelje të parimit të ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit përkatës, duke u shprehur se: *“Me efekt prapaveprues të ligjit, zyrtarët administrativë të punësuar, pavarësisht nga titujt e tyre të fituar më parë dhe ekspertiza në punën e tyre profesionale, të realizuara gjatë viteve të punës në institucione, vendosen në një situatë paqartësie për gëzimin e mëtejshëm të të drejtave të tyre të punës, të fituara në mënyrë të ligjshme, për shkak të përfshirjes së tyre në regjimin e ligjit të ri që parashikon kushte të reja të veçanta, të cilat nuk ekzistojnë në legjislacionin e mëparshëm. Efekti i pafavorshëm i vlefshmërisë prapavepruese të Ligjit shihet në mundësinë e humbjes së të drejtave tashmë të fituara nga puna, si pasojë e mosplotësimit të kërkesave specifike të ligjit të ri. Kështu, kushtet e reja të veçanta që ligji parashikon si kushte të veçanta për punësim në shërbimin civil, në kuptim të legjislacionit të rregulluar, bëhen kushte për mbajtjen e pozitës së fituar, titullit dhe pagës, gjë që kërcënon sigurinë juridike dhe pritjet legjitime të punonjësve për sa i përket të drejtave të tyre të fituara”*. Një qëndrim të ngjashëm ka mbajtur edhe në rastet kur vendoset një regjim i ri për llogaritjen e pagave në sektorin publik. Këtu zbatohet rregulli që me mënyrën e re të përcaktimit dhe përlllogaritjes së pagave nuk duhet të cenohen të drejtat e tashmë të punësuarve për uljen e pagave, pra regjimi i ri ligjor mund të zbatohet vetëm pro të ardhmes për punonjësit e rinj. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut në përgjigjen e saj gjithashtu njoftoi Gjykatën se megjithëse parimi i mbrojtjes së pritjeve legjitime dhe të drejtave të fituara nuk përmenden shprehimisht në Kushtetutën e tyre, mirëpo në jurisprudencën e tyre të njëjtat interpretohen si elemente të parimit të sundimit të ligjit, që është vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(iv) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë*

165. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë në përgjigjen e saj theksoi se Ligji i tyre për Shërbimin Civil nuk parashikon asnjë kriter përzgjedhjeje të ngjashëm me kriterin e *“përshtatshmërisë”*, ndërsa Ligji për Shërbimin Civil të Ushtarëve Profesionistë si dhe Ligji për Shërbimin Civil të Policëve, Anëtarëve të Shërbimit Informativ Sllovak, pjesëtarëve të Shërbimit të Burgjeve dhe Oficerëve të Policisë Hekurudhore kërkojnë që kandidatët për shërbimin civil të jenë të *“besueshëm”*, i cili kriter është përkufizuar në mënyrë të detajuar në të dyja ligjet. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë njoftoi Gjykatën se nëpunësit civilë janë kryesisht punonjës të përhershëm, dhe se kontratat

me afat të caktuar përdoren për nëpunësit civilë në poste drejtuese dhe këshilluese ose për zëvendësimin e nëpunësve civilë që mungojnë përkohësisht.

166. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitave me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë theksoi se para vitit 2001, statusi i nëpunësve publikë rregullohej me Kodin e punës ngjashëm me statusin e nëpunësve privatë, ndërsa, prej vitit 2001, Ligji për Shërbimin Civil ndryshoi statusin e nëpunësve publikë, të cilët (me disa përjashtime), u bënë nëpunës civilë ose me kontrata afatgjata ose në periudhë trajnimi në varësi të numrit të viteve që kishin shërbyer si nëpunës publik. Të dy grupet e nëpunësve civilë të sapo vendosur duhet të kalonin provimin e kualifikimit të shërbimit civil për t'u bërë nëpunës të përhershëm. Dështimi për të kaluar atë provim në një afat të caktuar kohor do të rezultonte në përfundimin e kontratave të punës së tyre në shërbimin civil. Dispozitat e ligjit në fjalë në lidhje me detyrimin e lartpërmendur për të dhënë provimin e kualifikimit të shërbimit civil u kundërshtuan para Gjykatës Kushtetuese në vitin 2003 nga Prokurori i Përgjithshëm i atëhershëm, i cili argumentoi ndër të tjera se legjislacioni i kundërshtuar binte ndesh me të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin. Në këtë rast, Gjykata vendosi se qasja në disa profesione mund t'i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara me ligj, andaj lejoi detyrimin e kundërshtuar. Po ashtu, kjo gjykatë theksoi se deputetët gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi kur rregullonin qasjen në poste publike, dhe se shërbimi civil ishte krijuar për të zbatuar politikën publike, kështu që qasja në shërbimin civil ishte i rregulluar në përputhje me interesin e shtetit për një administratë publike efektive. Rrjedhimisht, dispozitat statutores në fjalë përkitazi me provimin e kualifikimit ishin në përputhje me Kushtetutën.

(v) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë*

167. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë në përgjigjen e saj theksoi se Ligji i tyre për Shërbimin Civil lidhur me plotësimin e pozitave specifike në administratën publike, nuk parasheh kritere të tilla si “*përshatshmëria*” dhe/ose “*kritere specifike shtesë*”, përveç kualifikimeve të nevojshme si arsimit dhe përvoja e punës. Ndër kërkesat për emërimin si nëpunës civil është që një person duhet të plotësojë edhe kërkesat minimale të kualifikimeve arsimore dhe gradës ose përvojës profesionale, si dhe kërkesat specifike të përcaktuara në rregulloret për pozita. Parimisht, në këtë ligj është përcaktuar se hyrja në shërbimin civil në administratën përkatëse duhet të paraprihet nga një proces përzgjedhjeje konkurruese. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë njoftoi Gjykatën se legjislacioni në Bullgari përcakton sistemin e shërbimit civil të karrierës. Parimi është se marrëdhënia e shërbimit civil është për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitave me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë është negative.

(vi) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë*

168. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë në përgjigjen e saj fillimisht sqaroi se në Kroaci ekzistojnë katër kategori pozitash në organet e administratës shtetërore: (i) funksionarët shtetërorë; (ii) nëpunësit civilë; (iii) personat e tjerë të emëruar për një afat të caktuar me vendim të ministrit; dhe (iv) punonjësit e qeverisë. Më pas, e njëjta theksoi se kuadri ligjor kroat në fushën e administratës shtetërore, respektivisht, Akti për Sistemin e Administratës Shtetërore, Akti i Nëpunësve Civil dhe Dekreti për Klasifikimin e Posteve në Shërbimin Civil për shërbimin civil nuk parashikon kritere të tilla si “*përshatshmëria*” dhe/ose “*kritere specifike shtesë*”, përveç kualifikimeve të nevojshme si arsimit dhe përvoja e punës. Megjithatë, ligjet e veçanta mund të përcaktojnë kritere të tjera shtesë, të cilat përcaktohen nga natyra e punëve, si leja e

drejtimit të kategorisë B për inspektorët shtetërorë drejtues dhe njohja e gjuhëve të huaja për vendet e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane.

169. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë njoftoi Gjykatën se niveli i mesëm dhe i ulët drejtues i nëpunësve civilë kanë pasur gjithmonë një afat të përhershëm të punësimit në Kroaci, pra nuk ka pasur transformim të afatit të punësimit të përhershëm në një të caktuar. Përfundimisht nga kjo bëjnë, personat që kryejnë detyra të përkohshme që nuk kanë karakter afatgjatë ose zëvendësojnë një nëpunës civil që mungon për një periudhë të gjatë kohore. Po ashtu, avancimi në shërbimin civil arrihet me ngritjen në detyrë të nëpunësit civil në një post më të lartë brenda së njëjtës kategori ose me transferim në një post të kategorisë më të lartë, ndërsa marrëdhënia në shërbim civil pushon me fuqinë e ligjit kur performanca dhe efikasiteti i nëpunësit civil vlerësohet në nivelin si "*e pakënaqshme*", e cila matet çdo vit nga titullari i organit ose personi tjetër zyrtar i autorizuar. E njëjta gjithashtu sqaron se pozitat në kategorinë e nivelit të lartë drejtues të nëpunësve si: pozitat e drejtorit dhe kryeinspektorit që drejton organizatën administrative në kuadër të ministrisë së sekretarit të përgjithshëm të ministrisë dhe organizatës administrative shtetërore, zëvendëssekretari shtetëror i zyrës qendrore shtetërore, zëvendës kryeinspektori i shtetit, zëvendësdrejtori i përgjithshëm i organizatës administrative shtetërore, drejtori i zyrës së Qeverisë, drejtuesit e Zyrës së Zëvendëskryeministrit, drejtorët e zyrave, agjencive, drejtorive etj., shërbimet profesionale të themeluara nga Qeveria me dekret, emërohen dhe shkarkohen nga Qeveria me propozim të titullarit të organit, në bazë të njoftimit publik për rekrutim, për një periudhë katërvjeçare.

(vii) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë*

170. Gjykata Kushtetuese e Austrisë në përgjigjen e saj specifikoi se Akti Federal Austriak për Shërbimin Civil parasheh që një kërkesë e përgjithshme për të gjitha pozitat në shërbimin civil është përshtatshmëria personale dhe profesionale për të kryer funksionin që do të plotësohet. Kjo kërkesë nënkupton edhe njohjen e mirë të gjermanishtes ndërsa kuptimi i saktë i "*përshtatshmërisë profesionale*" ende nuk është specifikuar në legjislacion. Tutje, e njëjta theksoi se që nga ndryshimi i Ligjit për Shërbimin Civil në vitin 1994, zyrtarët publikë të nivelit të mesëm dhe të lartë kanë një mandat të caktuar prej pesë (5) vjetësh, pas së cilës, nëse nuk rizgjedhen, marrin pozitën e tyre të mëparshëm në shërbimin civil, me kusht që se ata kanë pasur tashmë një punësim të përhershëm në shërbimin civil para se të merrnin funksionin me afat të caktuar; përndryshe do të humbin punësimin në shërbimin civil. Deri në atë reformë, e gjithë administrata shtetërore bazohej në sistemin e karrierës. Tranzicioni u bë në atë formë që zyrtarët publikë, të cilët në atë kohë kishin tashmë një pozitë të mesme ose të lartë drejtuese, ishin të lirë të zgjidhnin sistemin e ri me mandat të caktuar (që parashihnte paga tërheqëse) ose të qëndronin në sistemin e karrierës. Pra, sistemi i vjetër i karrierës nuk u zëvendësua menjëherë me sistemin e ri, por u hoq gradualisht.

(viii) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Suedisë*

171. Gjykata Supreme e Suedisë në përgjigjen e saj specifikoi se punësimi në sferën publike rregullohet me Aktin Suedez për Punësimin Publik, i cili përcakton se kur punësohet në sferën publike, vetëm arsye objektive do të merren parasysh, të tilla si meritat e shërbimit dhe kompetenca. Kompetenca do të jetë konsiderohet si primare, përveç nëse ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Për më tepër, kjo gjykatë theksoi se nuk ka kritere specifike të "*përshtatshmërisë*" të përcaktuara në ligjin e lartpërmendur. Megjithatë, nëse një kandidat është i përshtatshëm për një punësim ose jo, në disa raste mund të jetë një element në vlerësimin nëse personi është kompetent për rolin. Tutje, e njëjta njoftoi Gjykatën se niveli i mesëm dhe i ulët drejtues i zyrtarëve publikë në Suedi, në përgjithësi, kanë mandat të përhershëm, pra nuk janë të punësuar me afat të caktuar

ose të zgjedhur politikisht. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Supreme e Suedisë është negative.

(ix) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Kirgizisë*

172. Gjykata Kushtetuese e Kirgizisë në përgjigjen e saj dërgoi tekstin e nenit të Ligjit për Shërbimin Civil në nivel shtetëror dhe komunal në lidhje me kriteret për punësim të nëpunësve civilë. Këto kriteret përcaktojnë: (i) shtetësinë e Kirgizisë; (ii) moshën 21 vjeç për shërbimin shtetëror dhe 18 vjeç për shërbimin komunal; (iii) respektimin e kërkesave të kualifikimit të përcaktuara për këtë pozitë nga legjislacioni dhe organi përkatës rekrutues, të cilat kanë të bëjnë me (a) kohëzgjatjen e shërbimit dhe përvojën e punës në specializim dhe aftësi profesionale; (b) nivelin dhe profilin e arsimit varësisht nga kategoria dhe grupi i pozitave administrative; (iv) njohja e gjuhës zyrtare në masën e nevojshme për të performuar. Po ashtu në këtë ligj ekzistojnë ndalesat që punonjësi nuk mund të punësohet nëse: (i) me vendim gjykate është shpallur si i paafte ose që me vendim gjykate i ndalohej të kryejë veprimtari si punonjës ose të mbajë pozita të caktuara në shërbimin civil shtetëror dhe në shërbimin komunal; apo (ii) të ketë precedentë penalë që nuk është shuar sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Ligji në fjalë nuk përcakton kriteret të “përshtatshmërisë”.

(x) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke*

173. Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke në përgjigjen e saj sqaroi se legjislacioni për shërbimin civil, më konkretisht, kërkesat për punësim në shërbimin civil, nuk përdorin termin “përshtatshmëri” në raport me kandidatin. Megjithatë, e njëjta theksoi se një koncept i ngjashëm mund të gjendet ndoshta në një kërkesë të përgjithshme ligjore për një kandidat që “të respektojë parimet demokratike dhe të kryejë shërbimin siç duhet”. Kjo kërkesë e veçantë është, sipas formulimit të Ligjit për Shërbimin Civil, “*parakushti kryesor për emërimin në shërbim*”. Tutje, e njëjta njoftoi Gjykatën se në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil, shërbimi civil ofrohet me afat të pacaktuar (të përhershëm) ose me afat të caktuar; si rregull, nëpunësit civilë janë në shërbim për një kohë të pacaktuar. Megjithatë, personi i cili ende nuk e ka kaluar provimin e shërbimit civil rekrutohet gjithmonë për një emërim me afat të caktuar. Një person mund të rekrutohet gjithashtu me një afat të caktuar kur është e nevojshme të zëvendësohet një anëtar i stafit që mungon përkohësisht. Rastet e tjera në të cilat, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të shërbimit, një person mund të rekrutohet me kontratë me afat të caktuar do të përcaktohen nga Qeveria me rregullore. Ndërsa, sa i përket shndërrimit të mandatit të pacaktuar në mandat të caktuar, e njëjta konstaton se ligji në fjalë parasheh vetëm situatën anasjelltas. Prandaj, nëse një shërbim ekzistues është për një periudhë të pacaktuar, kohëzgjatja e shërbimit nuk mund të ndryshohet në një periudhë të caktuar.
174. Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke po ashtu njofton Gjykatën se në një nga aktgjykimet e saj, shqyrtoi ndër të tjera kushtetutshmërinë e kriterit për punësim në shërbim civil që ka të bëjë me “*pritshmëritë për respektimin e parimeve demokratike dhe të kryejë shërbimin siç duhet*”. Në këtë rast, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e përgjithshme që një kandidat “të pritë të respektojë parimet demokratike të rendit kushtetues të Republikës Çeke” nuk binte ndesh me parimet themelore të shtetit të së drejtës, siç mund të interpretohej në një mënyrë konform kushtetuese. Gjykata hodhi poshtë argumentin se “*pritja e respektimit të parimeve demokratike*” ishte e paqartë dhe e bazuar thjesht në “*supozim subjektiv, jopërfundimtar dhe të pakufizuar*”. Gjykata vendosi se çdo vendim për të rekrutuar kandidatin në shërbimin civil duhet të arsyetohet siç duhet dhe t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Nëse autoriteti administrativ arrin në përfundimin se një kandidat i caktuar nuk mund të “*pritë të respektojë parimet demokratike të rendit kushtetues të Republikës Çeke dhe të kryejë*

*shërbimin siç duhet*", ai duhet të provojë këtë fakt dhe të arsyetojë siç duhet përfundimet e tij.

(xi) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë*

175. Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë në përgjigjen e saj sqaroi se Ligji Themeltar përcakton se çdo gjerman duhet jetë i barabartë që të kualifikohet për çdo detyrë publike sipas *"aftësive, kualifikimeve dhe arritjeve profesionale"*, dhe se në Gjermani kategoritë e personave që punojnë në këtë sektor ndahen në: (i) nëpunësit civilë dhe (ii) punonjësit publikë. E njëjta theksoi se sa i përket kritereve të pranimit në shërbim civil, ligjvënësi, qoftë në nivelin e federatës apo të shteteve federale, ka liri të gjerë në përcaktimin e kritereve të aftësisë për një pozitë të caktuar dhe në përcaktimin e detyrave zyrtare duke iu referuar të cilave duhet të vlerësohet aftësia e kandidatëve për shërbimin publik. Ky diskrecion është i kufizuar në masën që zbatohen normat e tjera kushtetuese, veçanërisht të drejtat themelore. Megjithatë, disa kritere minimale për arsimin dhe trajnimin janë të përcaktuara me ligj. Tutje, Gjykata Federale e Gjermanisë theksoi e shërbimi publik gjerman përbëhet nga një sistem karriere (nëpunës civilë) dhe një sistem i pozitës (punonjës publikë). Përderisa të parët rekrutohen kryesisht me mandat të pacaktuar dhe statusi i tyre i punësimit përcaktohet me statut ose akt ligjor, të dytët nga ana tjetër, rekrutohen për një funksion të caktuar dhe fusha e punësimit të tyre është përcaktuar në kontratën specifike të punës, e cila rregullohet nga parimet e së drejtës private, si dhe janë përgjithësisht të kufizuara në një periudhë të caktuar kohore. Dallimi në mes të këtyre dy kategorive nuk varet nga niveli i pozitës se a është menaxheriale apo jo, por më shumë nga ajo se a ushtron autoritet shtetëror në baza të rregullta, e që kjo duhet t'i besohet nëpunësve, të cilët qëndrojnë në një marrëdhënie të veçantë shërbimi dhe besnikërie të përcaktuar nga e drejta publike. Po ashtu, parimi i punësimit gjatë gjithë jetës i nënshtrohet disa përjashtimeve të kufizuara. Pozita të caktuara si të emëruarit politikë ose zyrtarët e zgjedhur komunalë njihen tradicionalisht si përjashtime nga parimi i punësimit të përjetshëm dhe përjashtohen nga mbrojtja e ofruar nga Ligji Themeltar. Për shembull, në një rast që përfshin emërimin e një nëpunësi civil me status të punësimit të përjetshëm në një pozitë si kancelar universiteti, e cila konsiderohej pozitë e përkohshme e shërbimit civil sipas ligjit të zakonshëm të shërbimit publik në shtetin federal të Brandenburgut, Gjykata Kushtetuese Federale konstatoi se e drejta për punësim të përjetshëm nuk mund të revokohej, pasi pozita e kancelarit nuk përfshihej në asnjë nga dy llojet e përjashtimeve nga punësimi i përjetshëm. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Kushtetuese Federale ka vendosur gjithashtu se ligjet e shtetit federal që imponojnë pozicione të detyrueshme me kohë të pjesshme për nëpunësit civilë kundër vullnetit të tyre, gjithashtu, në parim, shkel parimet tradicionale të alimentacionit. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitën me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë është negative, megjithatë, e njëjta theksoi se pasur shumë ndryshime ligjore sidomos në nivel të shteteve federative, të cilat kanë miratuar ligjet e tyre për shërbim civil. Një ndryshim i rëndësishëm ka qenë rritja e moshës së pensionit nga 65 në 67 për shumicën e pozitave në shërbimin civil të karrierës. Rritja e moshës u fut në një sistem të shkallëzuar, i tillë që mosha e vjetër e pensionit zbatohet për të lindurit para 1 janarit 1947, ndërsa mosha e daljes në pension u rrit gradualisht nga 65 në 67 në varësi të moshës për ata që kanë lindur pas 1 janarit 1947.

(xii) *Kontributi i dorëzuar nga Këshilli Shtetëror i Holandës*

176. Këshilli Shtetëror i Holandës në përgjigjen e tij theksoi se në Holandë, kualifikime shtesë si përshtatshmëria zbatohen vetëm për disa pozita specifike, për shembull në ushtri. Kriteret e përshtatshmërisë nuk përmenden në ligjin që është miratuar nga vetë parlamenti, por përmendet në dekretet ministrore bazuar në ligje dhe përcaktohet më



tej nga rregullore më të ulëta, për shembull nga komandantët nga njësitë ushtarake. Për pozitat "normale" të zyrës brenda shërbimit civil nuk ka kualifikime të tilla shitesë si "përshtatshmëria". I njëjti po ashtu njoftoi Gjykatën se në Holandë shërbimi civil është i bazuar në sistemin e pozitave. Pozitat e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues mund të jenë të përhershme apo me afat të caktuar, në varësi të pozitës. Për disa projekte afatshkurtra, për shembull, pozitat mund të jenë me afat të caktuar. Gjithashtu shumica e pozitave fillojnë me mandat të caktuar dhe kur plotësohen me sukses pas një viti apo më shumë bëhen pozita të përhershme. Mirëpo, pozitat me afat të caktuar nuk mbarojnë për shkak të mos rizgjedhjes së nëpunësit civil. Nëpunësit civilë në Holandë nuk zgjidhen. Të njëjtit emërohen në pozitat më të larta ndërsa punësohen në pozitat e tjera. Në Holandë, prej disa vitesh, nëpunësit publikë kanë një kontratë pune normale, ashtu si në punët në sektorin privat. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Këshillit Shtetëror të Holandës është negative.

(xiii) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë*

177. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë në përgjigjen e saj theksoi se në Slloveni punësimi i nëpunësve publikë rregullohet përmes Aktit për nëpunësit publikë, dhe se kriteret e punësimit në shërbimin civil varen nga kërkesat për kryerjen e punës që janë të përcaktuara në marrëveshje kolektive ose aktet e përgjithshme të punëdhënësit. Në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës Sllovene, duhet të garantohet një procedurë për zgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm për një pozitë në administratën publike, ku kualifikimet profesionale të kandidatëve merren parasysh si kriter përshtatshmërie, e cila mundëson kryerjen efikase dhe të suksesshme të punës. Ndërsa, ligji i lartcekur përcakton se bordi përzgjedhës që drejton procedurën e përzgjedhjes përcakton se cilët nga kandidatët i plotësojnë kushtet për pozitën dhe cilët nga kandidatët janë të përshtatshëm për pozitën në funksion të kualifikimeve të tyre profesionale. Tutje, e njëjta sqaron në detaje procedurën e rekrutimit të nëpunësve civil ku specifikon se kandidati i përzgjedhur më pas emërohet në gradën e shërbimit civil dhe nënshkruan një kontratë pune për afat të pacaktuar. Punësimi me afat të caktuar kufizohet në situatat e parashikuara nga ligji (zëvendësimi i një nëpunësi civil që mungon përkohësisht, projekte me afat etj.). Periudha e provës përdoret rregullisht në praktikë, e që nënkupton se zyrtarët duhet t'i nënshtrohen provimit brenda një viti pas emërimit të tyre dhe shkarkohen nëse dështojnë në atë provim. Po ashtu, për pozitat e larta drejtuese (sekretarë të përgjithshëm dhe drejtorë të përgjithshëm në ministri, drejtues agjencish), ekzistojnë rregulla të veçanta për rekrutimin në këto pozita dhe përfundimin e tyre. Nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese mund të shkarkohen brenda një viti pas emërimit të tyre ose pas betimit të një ministri/kryeministri të ri, sipas gjykimit të ministrit/kryeministrit. Megjithatë, ata kanë të drejtë të mbajnë statusin e tyre të nëpunësit civil dhe të transferohen në një pozitë tjetër të rangut të lartë (edhe pse jo domosdoshmërisht menaxherial). Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Kushtetuese së Sllovenisë është negative. Megjithatë, e njëjta përmend disa raste nga jurisprudenca e saj që ka vendosur lidhur me të drejtat e nëpunësve civilë si në vijim.
178. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë njoftoi Gjykatën se në një nga rastet e saj vendosi që ligjvënësi nuk e përkeqësoi pozitën juridike të parashtruesit, i cili ishte mjek, ku u hoq detyrimi për të mbajtur kujdestari nga mosha 50 deri 55 vjeç, sepse kjo bazohej në interes të përgjithshëm mbizotërues. Po ashtu, nga praktika gjyqësore e saj rrjedhë se e njëjta mund të shqyrtojë përcaktimin, p.sh., të kushteve arsimore për kryerjen e një pune ose profesioni të caktuar edhe nga këndvështrimi i konsistencës me parimin e besimit në ligj, të përcaktuar në Kushtetutën sllovene, e cila i referohet ndryshimit të pozitës juridike të individëve. Në përputhje me parimin e përmendur, e njëjta gjeti se

shteti nuk duhet të përkeqësojë pozitën e një individi pa arsye të bazuar në një interes publik mbizotërues dhe se gjatë ndryshimit të rregullativës ligjore të kushteve të punësimit, nëse një gjë e tillë ndërhyr në marrëdhëniet juridike ekzistuese, personave të prekur duhet t'u garantohet kohë e mjaftueshme për t'u përshtatur me rregulloren e re (periudha kalimtare). Në këtë kontekst, në një nga vendimet e saj gjeti se afati kohor katërvjeçar për inspektorët për të përmbushur kërkesat e reja të paraqitura në Ligjin për Administratën Tatimore ishte dukshëm shumë i shkurtër për plotësimin e kushteve të reja, si dhe në një vendim tjetër vendosi po ashtu se afati kalimtar prej dy vitesh ishte i pamjaftueshëm për plotësimin e kushteve të kërkuara të përcaktuara në Ligjin për Zhvillimin e Turizmit, i cili përcaktonte se personat e prekur duhet të fitojnë brenda afatit të caktuar arsimin e lartë të sapo kërkuar, njohuritë e dy gjuhëve të huaja në nivelin e njohurive të shkollës së mesme, si dhe, në disa raste, tre vjet përvojë pune. Pra, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë përmes këtyre vendimeve përcaktoi standardin se kur ligjvënësi ndryshon kushtet për kryerjen e veprimtarive edhe për personat që tashmë kryejnë veprimtari të tilla në momentin e ndryshimit të një rregullimi ligjor, ligjvënësi duhet të marrë parasysh parimin e besimit në ligj, i cili është një nga parimet e një shteti të qeverisur nga parimit i sundimi i ligjit, i përcaktuar në Kushtetutë, dhe se duhet të sigurojë një regjim kalimtar që i përshtatet këtij parimi.

*(xiv) Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Kushtetuese e Lituaniës*

179. Gjykata Kushtetuese e Lituaniës në përgjigjen e saj sqaroi se sipas Ligjit për Shërbimin Civil, kërkohet që personi që kërkon të bëhet nëpunës civil të plotësojë kriteret e veçanta, sipas pozitës/vendit vakant që kërkon të zërë dhe se këto kriteret nuk janë të përcaktuara në vetë ligjin, po mund të detajohen në aktin nënligjor ose në përshtatimin e veçantë të punës për pozitën. Po ashtu, e njëjta specifikon se ligji në fjalë kërkon që gjatë konkursit, kontrollohet “*përshtatshmëria*” e një personi për postin e nëpunësit civil të karrierës, ku “*vlerësohet kompetenca dhe aftësia e tij për të kryer funksionet e treguara në përshtatimin e punës*”. Në kuadrin ligjor lituanëz, termi “*përshtatshmëri*” i referohet kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësohen për të zënë pozitën në shërbimin civil. Gjykata Kushtetuese e Lituaniës në një nga vendimet e saj zhvilloi edhe kërkesat kushtetuese për nëpunësit e shtetit, ku përcaktohen kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, ku të parat duhet të vendosen me ligj, ndërsa për të dytat (kërkesat e veçanta) nuk ka asnjë kusht që të vendosen me ligj, pasi mund të ndryshojnë sipas llojit të shërbimit civil. Tutje, e njëjta theksoi se sistemi ligjor lituanëz dallon dy lloje të nëpunësve civilë: nëpunës civil të karrierës, i cili, kur pranohet, zë pozitën e tij/saj përgjithmonë, dhe nëpunës civil me besim politik (personal), i cili qëndron në pozitën e tij/saj deri sa personi që e ka zgjedhur qëndron në pozitë. Pozitat e nëpunësit civil të besimit politik nuk mund të shndërrohen në pozita të karrierës, pra me mandat të pacaktuar sepse do të ishin në kundërshtim me parimet e pranimit në shërbim civil të karrierës.
180. Sa i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitat me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Kushtetuese së Lituaniës është negative por e njëjta sqaroi në përgjigjen e saj se në rast të një reforme të tillë “*do të respektonin parimin e pritjeve legjitime të nëpunësve aktual civil të karrierës*”. Sipas së njëjtës, nëpunësit shtetërorë (dhe punonjësit e tjerë) kanë të drejtë të presin në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e fituara sipas akteve ligjore të vlefshme do të ruhen për periudhën e përcaktuar kohore dhe do të zbatohen në realitet; rregullimi ligjor mund të ndryshohet vetëm duke ndjekur procedurën e vendosur paraprakisht dhe duke mos shkelur parimet dhe normat e Kushtetutës, është e nevojshme, ndër të tjera, të ndiqet parimi *lex retro non agit* dhe nuk lejohet mohimi i interesave legjitime dhe pritjeve legjitime të personit nga ndryshimet e rregullativës ligjore. Për sa i përket hyrjes në fuqi të rregullores së re, doktrina e formuluar në rastet e të drejtës tatimore mund të jetë e dobishme si në vijim: “*nëse ndryshimet në ligj*

vendosin detyra ose kufizime të caktuara në lidhje me personat (ose ndryshojnë statusin e personit), duhet t'i kushtohet vëmendje kërkesës kushtetuese për të parashikuar një *vacatio legis* të duhur, d.m.th. duhet lënë kohë e mjaftueshme para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (fillimi i aplikimit të tyre), në mënyrë që personat e interesuar të mund të përgatiten siç duhet për ato". Gjykata Kushtetuese e Lituaniës po ashtu i dërgoi Gjykatës dy vendimet e saj sa i përket reformës së pagave të nëpunësve shtetëror.

(xiv) Kontributi i dorëzuar nga Tribunali Kushtetues i Polonisë

181. Tribunali Kushtetues i Polonisë në përgjigjen e tij sqaroi se Ligji për Shërbimin Civil kërkon që personat e punësuar të kenë “një reputacion të patëmetë”. Në dispozitat ligjore nuk ka një përkufizim të këtij nocioni por në literature vërehet se “një person gëzon një reputacion të patëmetë kur – në jetën e tij/saj profesionale dhe private – personi respekton parimet morale dhe etike si dhe respekton mirësjelljen e përbashkët, të miratuar nga shoqëria”. Po ashtu, në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta, supozohet se “një reputacion i patëmetë” përfshin: “tërësinë e cilësive, ngjarjeve dhe rrethanave individuale që përbëjnë reputacionin e një personi në të cilin publiku ka besim, me kusht që, në lidhje me atë reputacion, ajo që gjithashtu ka rëndësi janë faktet dhe ngjarjet jashtë sferës së jetës profesionale, të cilat do të minonin vlerësimin pozitiv të sjelljes në dritën e normave morale dhe etike, duke e konsideruar sjelljen si të dënueshme për opinionin publik, si cenim të dinjitetit të pozitës edhe nëse jo gjithmonë rezulton me përgjegjësi disiplinore”. Tutje, e njëjta theksoi se marrëdhënia e punës e nëpunësit civil fillon në bazë të një marrëveshje pune për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar. Në rastin e personave që për herë të parë marrin përsipër punë në shërbimin civil, lidhet një kontratë pune për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore. Një kontratë me afat të pacaktuar ndër të tjera është e mundur pas vlerësimit pozitiv të punës. Ligji në fjalë parashikon gjithashtu një grup të veçantë punonjësish – zyrtarë që punësohen si rezultat i procedurës së veçantë të emërimit. Karakteristikat e atij grupi përfshijnë, nga njëra anë, sigurinë më të madhe të punësimit (mundësitë e kufizuara të ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga punëdhënësi), dhe – nga ana tjetër – kufizimet e vendosura në forma të ndryshme aktivitësh: ndalimi i përfshirjes në politikë së palëve, ose ndalimi i ndërmarrjes së formave të tjera të veprimtarisë ekonomike pa pëlqimin paraprak të drejtuesit të një institucioni publik përkatës). Po ashtu, personat që mbajnë poste më të larta në shërbimin civil punësohen në bazë të një procedure përkatëse emërimi dhe mund të tërhiqen në çdo kohë nga një autoritet që i ka emëruar.
182. Tribunali Kushtetues i Polonisë njoftoi Gjykatën se në një nga vendimet e saj vendosi për pajtueshmërinë me Kushtetutën të një prej dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, i cili transformoi marrëdhënien e punës së personave të punësuar në bazë të procedurës së emërimit në marrëdhënie pune me kontratë pune, që mundësonte procedura më të lehta për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Për këtë, Tribunali u shpreh se kërkesa për mbrojtjen e të drejtave të fituara, si rrjedhojë nga parimi i besimit të qytetarëve në shtetin dhe ligjet e tij nuk ka karakter absolut dhe nuk është e barabartë me paprekshmërinë e ato të drejta. Zyrtarët shtetërorë mund të mos presin që parimet që rregullojnë lidhjen dhe përfundimin e një marrëdhënie pune do të mbeten të pandryshuara, pavarësisht ndryshimit të kushteve sociale. Sipas mendimit të Tribunalit, zvogëlimi i sigurisë së punësimit nuk u shkaktoi personave në fjalë ndonjë efekt juridik që ata nuk mund t'i kishin parashikuar më parë. Për më tepër, zbatueshmëria e dispozitës u shty në kohë prej 4,5 periudhash, gjë që zbuti pasojat e mundshme. Po ashtu, Tribunali Kushtetues i Polonisë përmend edhe një nga rastet e tjera të tij, të cilin e referoi Avokati i Popullit polak. Rasti kishte të bënte me pozitat më të larta në shërbimin civil, përmes disa ndryshimeve ligjore u bë një ndryshim në modelin e punësimit për këta punonjës, pra u bë një zhvendosje nga sistemi i rekrutimit

në sistemin e emërimeve. Në rastin e personave që në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit mbanin poste më të larta në shërbimin civil, marrëdhëniet e tyre të punës u ndërpreu pas kalimit të 30 ditëve, nëse para skadimit të këtij afati nuk iu kanë ofruar kushte të reja pune dhe/ose pagesa për periudhën pasuese të punësimit ose nëse nuk kishin pranuar kushtet e reja të punës dhe/ose pagën. Në rast të skadimit të marrëdhënieve të punës, personat e përmendur kishin të drejtën e pagesës së largimit të parashikuar për situatën kur marrëdhëniet e punës ndërpriteshin për shkak të mbylljes së institucionit. Pasi që Avokati i Popullit e tërhoqi kërkesën e tij, atëherë Tribunali e ndërpreu procedurën dhe nuk vendosi përkitazi me rastin.

(xv) *Kontributi i dorëzuar nga Gjykata Supreme e Meksikës*

183. Gjykata Supreme e Meksikës në përgjigjen e saj fillimisht sqaroi se sipas Ligjit Federal të Nëpunësve Publikë, ekzistojnë dy lloje të nëpunësve publikë: ata që mbajnë një pozitë të besuar dhe nëpunës publikë të rangut të lartë. Në këtë kontekst, nëpunës publikë që mbajnë një pozitë të besuar janë ata që janë pjesë e stafit të Presidentit, emërimi i të cilëve kërkon miratimin e shprehur të Presidentit, si dhe punonjës të tjerë të Degës së Ekzekutivit, si dhe të cilët kryejnë funksione menaxheriale si inspektimi, mbikëqyrja, auditimi, administrimi i fondeve ose letrave me vlerë. Të njëjtit ndahen në nëpunës të karrierës dhe nëpunës me mandat të caktuar. Ndërsa, nëpunës publikë të rangut të lartë janë ata që nuk hyjnë në kategorinë e parë dhe kanë mandat të përhershëm. Tutje, ligji në fjalë përcakton kriteret specifike që kanë të bëjnë me caktimin ose emërimin e punonjësve në shërbim të shtetit, duke përfshirë faktorë të tillë si njohuritë dhe aftësitë. Kriteri i “*aftësisë*” është i përcaktuar në ligj si “*tërësia e aftësive fizike dhe mendore, iniciativës, zellshmërisë dhe efikasitetit për të kryer një aktivitet të caktuar*”.
184. Gjykata Supreme e Meksikës njofton Gjykatën se kuadri ligjor në Meksikë nuk përcakton se mandati i nëpunësve publikë i nënshtrohet një afati të caktuar pas së cilit, nëse nuk riemërohen, humbasin statusin e tyre si nëpunës publik. Përkundrazi, i njëjti përcakton se nëpunësit publikë kanë të drejtën e qëndrueshmërisë dhe përhershshmërisë në shërbim, me kusht që të jenë nëpunës publikë brenda sistemit të karrierës, ose të jenë të pazhvendosur në pozitën e tyre nëse janë punonjës të gradës së lartë. Po ashtu, sipas një Aktvendimi të Gjykatës Supreme të Meksikës, nëpunësit publikë të emëruar nuk kanë të drejtën e qëndrueshmërisë dhe përhershshmërisë në shërbim dhe nuk janë të palëvizshëm; përkundrazi, ata mund të emërohen dhe shkarkohen lirisht. Sa a i përket pyetjes së Gjykatës se a ka pasur një reformë në administratën publike ku pozitën me mandat të pacaktuar shndërrohen në mandat të caktuar, përgjigja e Gjykatës Supreme të Meksikës është negative, por thekson se sistemi meksikan në shërbimin civil është hibrid dhe se me miratimin e Ligjit të Shërbimit të Karrierës Profesionale, dispozitat e tij kalimtare përcaktonin se çdo nëpunës publik që mbante një pozitë të besuar do të ruante vendin e tij të punës, por do të klasifikohet si nëpunës publikë i emëruar derisa t'i nënshtrohet vlerësimeve të nevojshme. Për më tepër, ky ligj përcaktoi se asnjë nëpunësi publik me pozitë të besuar nuk mund t'i njëhej pozita si nëpunës publik i karrierës deri në dy vite pas zbatimit të ligjit.

## **Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 3 [Barazia para Ligjit]**

*“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*

[...]"

#### **Neni 4** **[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]**

*"1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*

*2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*

*3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*

*4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*

*5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*

[...]"

#### **Neni 7** **[Vlerat]**

*"1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*

[...]"

#### **Neni 16** **[Epërsia e Kushtetutës]**

*"1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.*

*2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.*

*3. Republika e Kosovës respekton te drejtën ndërkombëtare,*

*4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës."*

#### **Neni 19** **[Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]**

[...]"

*2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."*

#### **Neni 22** **[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

*"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

*(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*

*(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*

[...]"

**Neni 24**  
**[Barazia para Ligjit]**

- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

**Neni 32**  
**[E Drejta për Mjete Juridike]**

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

**Neni 46**  
**[Mbrojtja e Pronës]**

- “1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”

**Neni 49**  
**[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]**

- “1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”

**Neni 53**  
**[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]**

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

**Neni 55**  
**[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

*“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

*2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.  
[...]*”

### **Neni 63**

#### **[Parimet e Përgjithshme]**

*“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”*

### **Neni 65**

#### **[Kompetencat e Kuvendit]**

*“Kuvendi i Republikës së Kosovës:*

*[...]*

*(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*

*[...]*”

### **Neni 74**

#### **[Ushtrimi i Funksionit]**

*“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”*

### **Neni 76**

#### **[Rregullorja e Punës]**

*“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”*

### **Neni 77**

#### **[Komisionet]**

*“1. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.*

*2. Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.*

*3. Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.*

*4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit.”*

### **Neni 78**

#### **[Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve]**

*“1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara*

për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.

2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.

3. Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, Komisioni mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit.

4. Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësiive të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime individuale.

5. Një çështje mund t'i referohet komisionit për mendim këshillimor nga Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grupi të përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit.”

#### **Neni 79** **[Nisma Legjislative]**

“Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”

#### **Neni 101** **[Shërbimi Civil]**

“1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.”

#### **Neni 142** **[Agjencitë e Pavarura]**

“1. Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.

2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.

3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.”

### **LIGJI Nr. 06/L -048 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

#### **Neni 4** **(Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës)**

1. Këshilli është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.



2. Këshilli për punën e tij i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku njëherë në vit, dhe sa herë që i kërkohet nga Kuvendi.

## **Neni 6 (Funksionet e Këshillit)**

*“1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:*

*1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;*

*1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;*

*1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.”*

## **Neni 7 (Kompetencat e Këshillit)**

*1. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli ka të drejtë të:*

*1.1. vizitojë çdo institucion që ka të punësuar nëpunës civil;*

*1.2. ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;*

*1.3. intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;*

*1.4. kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;*

*1.5. organizon seanca profesionale, dhe*

*1.6. nxjerr vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime.*

*2. Këshilli paraprakisht e njofton zyrtarin kryesor administrativ të organit përkatës të punësimit, për çfarëdo vizite apo kërkesë për informata lidhur me zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.*

## **Neni 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues)**

*“1. Këshilli mbikëqyrë të gjitha procedurat e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues.*

*2. Institucioni i administratës publike që fillon procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i obliguar që brenda pesë (5) ditësh nga momenti i publikimit të shpalljes së konkursit, të njoftojë me shkrim Këshillin.*

*[...]”*

## **Neni 20 (Monitorimi i institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil)**

*1. Këshilli, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka të drejtë që për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil.*

2. *Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlihen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.*
3. *Anëtari i Këshillit është i obliguar që të paraqet raportin me të gjetura dhe rekomandime në mbledhjen e Këshillit dhe të jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli.*
4. *Këshilli, pas shqyrtimit të raportit nxjerr vendim, të cilin së bashku me raportin ia dërgon institucionit përkatës.*
5. *Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.*

## **Neni 25**

### **Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike**

- “1. Këshilli bashkëpunon me institucionet e administratës publike për të kryer funksionet e tij në përputhje me këtë ligj.*
- 2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin.*
- 3. Në rastet kur organi i punësimit apo personi përgjegjës nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjell Kryeministrit ose eprorit të drejtpërdrejtë të personit përgjegjës.”*

## **Neni 28**

### **(Raporti vjetor i Këshillit)**

1. *Këshilli i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës për vitin paraprak, më së largu deri me 31 mars të vitit vijues.*
2. *Një kopje të raportit vjetor, Këshilli ia përcjell edhe Kryeministrit.*
3. *Kuvendi i Kosovës shqyrton raportin vjetor të Këshillit në seancë plenare. Nëse Kuvendi e vlerëson të nevojshme, mund të ftojë Kryetarin e Këshillit për raportim në seancë plenare.*
4. *Raporti vjetor i Këshillit, pas miratimit nga Kuvendi botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.*
5. *Raporti vjetor përfshin të dhënat për kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, dhe rekomandimet për institucionet e administratës publike.*
6. *Institucionet e administratës publike janë të obliguara që të zbatojnë rekomandimet e Këshillit të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.*

## **RREGULLORJA E KUVENDIT, e miratuar më 28 korrik 2022**

### **KREU VIII**

#### **KOMISIONET E KUVENDIT**

### **Neni 41**

#### **Komisioni përgjegjës-raportues**

- “1. Kryetari i Kuvendit, sipas fushëveprimit, cakton njërin nga komisionet, si komision përgjegjës, për të raportuar për projektligjin dhe për dokumentet e tjera të parashtruara në Kuvend.*
- 2. Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton projektligjin ose mocionin e dërguar, harton dhe rekomandon amendamente si dhe konstaton amendamentet që bien ndesh me njëri-tjetrin.*
- 3. Në Kuvend, për projektligjin, raporton vetëm Komisioni përgjegjës-raportues.*

4. Raporti përmban propozimet e Komisionit përgjegjës-raportues, arsyet dhe opinionet e kundërta, si dhe komentet e komisioneve të tjera, për të cilat Kuvendi vendos në seancë plenare.
5. Kryetari apo raportuesi i Komisionit përgjegjës-raportues, paraqet në Kuvend raportin për shqyrtimin e projektligjit dhe vlerësimin e komisionit.”

#### **Neni 42**

#### **Komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale**

- “1. Kuvendi formon komisione të përhershme dhe komisione funksionale.
2. Kuvendi, miraton formimin e komisioneve, si në paragrafin 1 të këtij neni, dhe ua përcakton fushëveprimin e tyre.
3. Komisionet e përhershme janë komisionet që mbulojnë fushat përkatëse si: buxhet dhe financa, legjislacion, integrim evropian dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
4. Komisioni i përhershëm i shqyrton të gjitha projektligjet dhe aktet e tjera, nga fushëveprimi i tij, e që parashtrihen në Kuvend dhe ngarkohet me vendim të Kuvendit.
5. Komisioni funksional i shqyrton projektligjet dhe aktet e tjera vetëm nga fushëveprimi i tij.”

### **KREU XI**

#### **FAZAT E SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJIT**

#### **Neni 76**

#### **Shqyrtimi i projektligjit në komisione**

- “1. Pas miratimit në shqyrtim të parë, projektligji shqyrtohet nga komisioni përgjegjës-raportues.
2. Në rastin kur projektligji rregullon çështje nga fushëveprimi i dy (2) komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin prej tyre, si komision përgjegjës-raportues.
3. Amendament në projektligj mund të propozojë deputeti, komisioni parlamentar dhe Qeveria. Amendamentet i adresohen Komisionit përgjegjës-raportues, nëpërmjet Zyrës për propozime dhe parashtrësia brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita miratimit në parim.
4. Propozimi për amendamentin duhet të përmbajë: referimin ndaj dispozitës së projektligjit, formulimin e saktë të amendamentit dhe arsyetimin e amendamentit të propozuar.
5. Amendamenti i propozuar, i dërgohet Zyrës për propozime dhe parashtrësia.
6. Në rast se amendamenti nuk i përmbushë kushtet sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, Zyra për propozime dhe parashtrësia ia kthen propozuesit amendamentin, për plotësimet e nevojshme.
7. Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton projektligjin nen për nen dhe amendamentet e propozuara. Raporti me rekomandime u dërgohet komisioneve të përhershme.
8. Komisioni i përhershëm, shqyrton projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni përgjegjës-raportues, si dhe amendamentet e propozuara nga të autorizuarit sipas paragrafit 3 të këtij neni. Komisioni i përhershëm, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e marrjes së raportit, duhet të paraqesë raportin për projektligjin dhe për amendamentet e Komisionit përgjegjës-raportues, pas këtij afati raporti i Komisionit përgjegjës-raportues procedohet për miratim në seancë plenare.
9. Komisioni përgjegjës-raportues, pasi e përfundon shqyrtimin, i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime. Në raport përfshihen edhe mendimi i komisioneve të përhershme, si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputeti, nga

komisioni dhe nga Qeveria. Në raport shënohet edhe mendimi i anëtarëve që janë shprehur kundër.”

## **Neni 78** **Shqyrtimi i dytë i projektligjit**

“1. Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të komisionit përgjegjës-raportues. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit, sipas radhës e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesi i grupit parlamentar, përfaqësuesi i Qeverisë, propozuesi i amendamenteve dhe deputeti.

2. Gjatë shqyrtimit të dytë në seancë plenare nuk mund të propozohen amendamente të reja, me përjashtim të rastit kur paraqitet nevoja për të evituar kolizionin e dispozitave të projektligjit. Me propozim të kryetarit të Komisionit përgjegjës-raportues, Kuvendi vendos për ndërprerjen e shqyrtimit të amendamenteve dhe e bart çështjen për shqyrtim vetëm në Komisionin përgjegjës-raportues, i cili e paraqet raportin plotësues gjatë zhvillimit të seancës apo për seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i dytë i projektligjit vazhdon me shqyrtimin dhe me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni përgjegjës-raportues dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e tjera nga Qeveria dhe nga deputetët. Para votimit të amendamentit mund të zhvillohet debat.

4. Radhitja e amendamenteve, të pasqyruara në tabelën krahasuese me dy kolona (teksti i projektligjit dhe i amendamenteve), për shqyrtim dhe për votim në seancë plenare bëhet sipas nenit 73 të kësaj rregulloreje.

5. Pas votimit të amendamenteve, votohet teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara.

6. Me kërkesë të Komisionit përgjegjës-raportues votimi i projektligjit me amendamentet e miratuara mund të shtyhet në seancën e radhës.

7. Teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara përgatitet nga njësia përkatëse organizative e Administratës së Kuvendit dhe i dërgohet Komisionit përgjegjës-raportues. Njësia gjatë përgatitjes së tekstit të projektligjit me amendamentet e miratuara kufizohet vetëm në eliminimin eventuale të mospërputhjeve terminologjike dhe ligjore në tekst ose të kolizioneve ndërmjet normave të projektligjit dhe normave të tjera të sistemit ligjor.

8. Komisioni përgjegjës-raportues, gjatë shqyrtimit të projektligjit me amendamentet e miratuara, nuk e shqyrton përmbajtjen e miratuar të projektligjit, por kufizohet vetëm sipas paragrafit 7 të këtij neni.

9. Komisioni përgjegjës-raportues tekstin e projektligjit, sipas paragrafit 8 të këtij neni, e procedon për miratim në Kuvend brenda pesë (5) ditë pune, nga dita e vendosjes sipas paragrafit 6 të këtij neni.

10. Në seancën e parë plenare pas dorëzimit të projektligjit me amendamentet eventuale, të propozuara në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, procedohet me votimin përfundimtar të projektligjit.”

## **Neni 85** **Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve**

“1. Shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë të përshpejtuar, nuk mund të bëhet më herët se 48 orë nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë nuk mund të bëhet më herët se 72 orë nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të gjendjes së jashtëzakonshme ose shpalljes së gjendjes emergjente.

2. Me kërkesë të Qeverisë ose të 1/4 të numrit të përgjithshëm të deputetëve, Kuvendi shqyrton me procedurë të përshpejtuar projektligjet që ndërliken me:

- 2.1. Sigurinë kombëtare;
- 2.2. Shëndetin publik; dhe
- 2.3. Çështje buxhetore dhe financiare.

3. Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni i adresohet Kryetarit të Kuvendit, i cili e thërret seancën plenare.”

### **Neni 86**

#### **Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit**

“1. Kuvendi, me kërkesë të Qeverisë ose 1/4 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, mund të shqyrtojë projektligjin me procedurë urgjente, i cili ndërlidhet me marrjen e masave për gjendjen e jashtëzakonshme, sipas nenit 131 të Kushtetutës apo për gjendjen emergjente.

2. Shqyrtimi i projektligjit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i veçantë dhe shqyrtohet vetëm nga Komisioni funksional, me përjashtim të rastit kur kërkohet sipas nenit 78, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë urgjente bëhet brenda 48 orëve nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë bëhet brenda 72 orëve nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe.”

### **KREU XX**

#### **TRANSPARENCA E KUVENDIT**

### **Neni 123**

#### **Shmangia nga afatet procedurale**

“1. Me propozim të së paku gjashtë (6) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores.

2. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”

#### **Vlerësimi i Pranueshmërisë së Kërkesave**

185. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

186. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

187. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

188. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës duhet të (i) parashtrohet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit; (ii) që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, për përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) kërkesa duhet të parashtrohet brenda një afatit prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.

189. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë, përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesa KI216/22 është parashtruar nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë, ndërsa kërkesa KI220/22 është parashtruar nga 10 (dhjetë) deputetë, andaj kërkesat e parashtruesve përmbushin kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.
190. Gjykata, gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesave kontestojnë Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të miratuar në Kuvend. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se të dy kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë më 30 dhjetor 2022, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 22 dhjetor 2022, që nënkupton se kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenin 113 të Kushtetutës.
191. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenin 113 të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë aktit të kontestuar para Gjykatës, si për nga përmbajtja, ashtu dhe për nga procedura e ndjekur, pasi në rastin konkret, parashtruesit e kërkesave, që të gjithë janë deputetë të legjislaturës së VIII të Kuvendit, andaj të njëjtit konsiderohen palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi.
192. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42  
(Saktësimi i kërkesës)

*“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

193. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72  
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

*[...]*

*(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, , ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:*

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendi i Republikës së Kosovës;*

(b) *dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*

(c) *paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.*

(2) *Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”*

194. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesat e tyre përkatëse; (ii) specifikuan Ligjin e kontestuar të Kuvendit të 22 dhjetorit 2022; (iii) iu referuan neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) dorëzuan prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre.
195. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave përkatëse, Gjykata i deklaroi kërkesat e parashtruesve të kërkesave të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e tyre.

### **Meritat**

196. Gjykata rikujton se çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së (i) procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar; dhe (ii) dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, përkatësisht neneve: 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare).
197. Më saktësisht, objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, sipas kërkesës së parashtruesve të kërkesës, është (i) nëse procedura e ndjekur për miratimin e tij është në përputhje me nenet 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës; si dhe (ii) nëse nenet e 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit të kontestuar janë në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
198. Gjykata rikujton se (i) sa i përket procedurës së ndjekur të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretendojnë se i njëjti nuk i ka përmbushur kërkesat e shqyrtimit parlamentar në komisionet e përhershme parlamentare të Kuvendit sepse është miratuar pa u shqyrtuar fare në Komisionin e Përhershëm për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si dhe ekzistojnë mospërputhje në dokumentacionin zyrtar të seancës plenare për shqyrtimin e këtij ligji; ndërsa (ii) sa i përket përmbajtjes së Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera dhe sipas shtjellimit në pjesën që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, pretendojnë se nenet 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit të kontestuar janë kundërkushtetuese, ndër të tjera, për arsytet në vijim: (a) *“përshtatshmëria”* si kriter shtesë për punësim, i përcaktuar në nenin 9 të Ligjit të kontestuar, bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, të garantuar me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, si dhe ky kriter do të duhej të ishte specifik, i përcaktuar me ligj dhe jo me akt nënligjor të Qeverisë; (b) neni 12 i Ligjit të kontestuar, i cili parasheh se Qeveria miraton dhe

koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre, e që lejon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Qeverisë në punësimet në Kuvend, në gjyqësor dhe institucionet e tjera të pavarura, bie në kundërshtim me nenin 4 [Ndarja e pushteteve] të Kushtetutës; (c) neni 46 i Ligjit të kontestuar që përcakton mandatin katërvjeçar për nëpunësit civilë të nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët, bie ndesh me, mes tjerash, parimin e sundimit të ligjit të garantuar me nenin 7 të Kushtetutës, hierakinë e normave bazuar në nenin 16 dhe 19 të Kushtetutës dhe në këtë kontekst nenin 120 të MSA, si marrëveshje e ratifikuar në Kuvend, si dhe bie ndesh me Parimet e Administratës Publike të OECD/SIGMA-s; dhe (d) neni 99 i Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se për të gjitha pozitat e nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët brenda 1 (një) viti do të shpallet procedura e rekrutimit, bie në kundërshtim me parimin e “*të drejtës së fituar*” dhe cenon “*prirjet legjitime*” të nëpunësve civilë në fjalë, të cilët kanë nënshkruar akt emërimi me afat të pacaktuar, dhe rrjedhimisht, mes tjerash, prek të drejtën e tyre në pronë, dhe të drejtën e tyre në punë, të garantuara me nenin 46, respektivisht nenin 49 të Kushtetutës. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, (i) në parim, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit dhe plotësohen më tej sipas pretendimeve të ZRRE-së, në parim, në kontekst të nenit 142 të Kushtetutës, ndërsa (ii) kundërshtohen nga Kryeministri dhe grupi parlamentar i LVV-së.

199. Gjykata (i) e ka kufizuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar në fushëveprimin e dispozitave të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës dhe atyre të ndërlidhura me to; dhe (ii) përgjatë këtij vlerësimi, ndër të tjera, ka shtjelluar dhe aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata, me theks në Aktgjykimin në rastin KO203/19, përkitazi me vlerësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejme: Ligji në fuqi për Zyrtarët Publikë), praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJENDJ), Opinionet dhe Raportet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe kontributin e gjykatave kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve përkatës anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe parimet themelore të OECD/SIGMA për administratën publike.
200. Në vijim, Gjykata fillimisht do të shqyrtojë në merita (i) procedurën e ndjekur për miratimin e ligjit të kontestuar, e më pas do të vazhdojë me shqyrtimin (ii) e përmbajtjes së tij për aq sa është kontestuar nga parashtruesit e kërkesës.

## **I. SA I PËRKET PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR MIRATIMIN E LIGJIT TË KONTESTUAR**

201. Gjykata rikujton se sa i përket procedurës së ndjekur, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se:
- (i) Ligji i kontestuar në pikëpamje procedurale nuk i ka përmbushur kërkesat e shqyrtimit parlamentar në komisionet e përhershme parlamentare të Kuvendit sepse duke u trajtuar në procedurë të përsheptuar – shmangie nga afatet procedurale, është miratuar pa u shqyrtuar fare në Komisionin e Përhershëm për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në kundërshtim me nenet 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 76 (Shqyrtimi i projektligjeve në Komisione) të Rregullores së Kuvendit; si dhe
- (ii) Ekzistojnë dy raporte me tekste/përmbajtje të ndryshme të amendamenteve (amandamenti 10) në dokumentacionin zyrtar të seancës plenare të Kuvendit lidhur me votimin e Ligjit të kontestuar, të cilat janë paraqitur nga Komisioni



funksional dhe mbajnë datë të ndryshme, njëri raport datën 20 dhjetor 2022, ndërsa tjetri datën 21 dhjetor 2022.

202. Gjykata thekson se ajo vetëm mund të analizojë procedurën për miratimin e Ligjit të kontestuar mbi bazën e dispozitave dhe parimeve relevante kushtetuese dhe se mbi bazën e këtij parimi, në vijim do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me pretendimin për shkelje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës.

**(i) Lidhur me pretendimin për shkelje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës**

203. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesave se Ligji i kontestuar nuk është shqyrtuar nga dy komisionet e përhershme parlamentare, respektivisht Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës, Gjykata vë në pah dispozitat kushtetuese të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur, respektivisht, (i) nenin 76 të Kushtetutës, që përcakton se: *“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”*; dhe (ii) nenin 77 të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“1. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc [...] 4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit”,* si dhe (iii) nenin 78 të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit [...] 2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.”*
204. Megjithatë, dhe përtej dispozitave të kontestuara në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht vë në pah faktin që ushtrimi i pushtetit legjislativ është funksioni më thelbësor i Kuvendit të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar në nenet 4 [Forma e qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Këtë funksion i njëjti, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, e ushtron sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 79 [Nisma Legjislative] dhe neni 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, ndërsa deputetët ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, siç është saktësuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës. Për më tepër, Kushtetuta u përcakton rol të veçantë Komisioneve të Kuvendit, me theks, në procesin e ligjbërjes. Më saktësisht dhe në këtë kontekst, e njëjta në nenin 77 [Komisionet] të saj, përcakton kategoritë e komisioneve, duke i klasifikuar në të përhershme, funksionale dhe *ad hoc*, duke vënë theks në rëndësinë e përbërjes së tyre, përfshirë rolin e komuniteteve joshumicë dhe duke deleguar rolin dhe procedurat përkatëse në nivel të Rregullores së Kuvendit. Rol të veçantë, Kushtetuta i përcakton Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në nenin 78 të tij, duke përcaktuar, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, edhe mundësinë që: (i) me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, që çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve; dhe (ii) kohën në dispozicion prej dy javësh që Komisioni të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar nëse zgjedh.
205. Për më tepër, dhe përtej dispozitave kushtetuese të lartcekura, Kushtetuta në nenin 76 [Rregullorja e Punës] të saj, gjithashtu përcakton që Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me 2/3 dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të tij, dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit. Në këtë kontekst,

- Rregullorja e Kuvendit përcakton: (i) Komisionet e Kuvendit në kreun VIII; (ii) Procedurën Ligjvënëse në kreun X; dhe (iii) Fazat e Shqyrtimit të Projektligjit në kreun XI.
206. Kjo Rregullore e punës, e miratuar nga vet deputetët e Kuvendit, në nenet 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit), përcakton “*procedurën e përshpejtuar*” dhe “*procedurën urgjente*” për shqyrtim të projektligjit, respektivisht. Vënia në lëvizje të këtyre dy procedurave është e kushtëzuar në një kërkesë të Qeverisë ose 1/4 (një të katërtës) të të gjithë deputetëve, përkatësisht 30 (tridhjetë) sosh, dhe është e kushtëzuar në rastin e parë, përkatësisht në “*procedurën e përshpejtuar*” në çështje që ndërlidhen me: (i) sigurinë kombëtare; (ii) shëndetin publik; dhe (iii) çështje buxhetore e financiare, ndërsa në rastin, përkatësisht në “*procedurën urgjente*” në shqyrtimin e projektligjeve që ndërlidhen me marrjen e masave për gjendjen e jashtëzakonshme sipas nenit 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] të Kushtetutës. Edhe në këto dy rrethana, shqyrtimi i parë i projektligjit, nuk mund të bëhet më herët se 48 (dyzet e tetë) orë nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë nuk mund të bëhet më herët se 72 (shtatëdhjetë) orë nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të gjendjes së jashtëzakonshme ose shpalljes së gjendjes emergjente apo rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe vetëm në rast të “*procedurës urgjente*” që ndërlidhet me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.
207. Në anën tjetër, e njëjta Rregullore në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedural) të saj, përcakton që me propozim të së paku 6 (gjashtë) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores atëherë kur një vendimmarrje e tillë nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është kjo procedura përmes të cilës është miratuar Ligji i kontestuar.
208. Më saktësisht, Gjykata rikujton që (i) Qeveria kishte miratuar projektligjin e kontestuar më 23 nëntor 2022; (ii) i njëjti iu ishte shpërndarë deputetëve të Kuvendit të nesërmen më 24 nëntor 2022; (iii) Kuvendi kishte miratuar Ligjin e kontestuar në lexim të parë më 9 dhjetor 2022; (iv) para procedurës së leximit të dytë, përkatësisht më 15 dhjetor 2022, Kuvendi, bazuar në nenin 123 të Rregullores së punës, kishte vendosur të shmangej nga afatet procedurale të Rregullores së punës; (v) raporti i Komisionit funksional, përshirë 17 (shtatëmbëdhjetë) amendamentet e propozuara, iu ishte shpërndarë të gjithë deputetëve të Kuvendit më 21 dhjetor 2022, ndërsa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim kishte dhënë opinionin e tij më 22 dhjetor 2022, në orën 9:00; ndërsa (vi) po të njëjtën ditë, në orën 10:00, është mbajtur seanca plenare e Kuvendit, në të cilën ishte miratuar Ligji i kontestuar në procedurën e leximit të dytë.
209. Gjykata vëren që për shmangien nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, është i nevojshëm propozimi i vetëm 6 (gjashtë) deputetëve të Kuvendit dhe vota e 2/3 (dy të tretave) të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që bazuar në nenin 76 të Kushtetutës, Rregullorja e punës së Kuvendit duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa sipas të njëjtës Rregullore, shmangia nga çdo afat procedural i saj, i është mundësuar vetëm shumicës prej 2/3 (dy të tretave) të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për më tepër, Gjykata vë në pah faktin që vet deputetët e Kuvendit, përmes miratimit të Rregullores, kanë përcaktuar afate procedurale në kontekst të procesit të ligjvënës në Kuvend edhe në kontekst të rrethanave që ndërlidhen me sigurinë kombëtare apo/edhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Ligji i kontestuar, që ndërlidhet me një reformë të thellë në tërë administratën shtetërore, është nxjerrë në shmangie të të gjitha afateve procedurale në Kuvend. Për

më tepër, Ligji i kontestuar, siç është sqaruar tashmë, gjithashtu ishte miratuar pa opinionin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

210. Gjykata rikujton faktin që bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 4, 63 dhe 65 të saj, ligjbërja është një ndër funksionet më thelbësore të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ndër funksionet më esenciale të përfaqësuesve të popullit, përkatësisht deputetëve të Kuvendit. Neni 123 i Rregullores së Kuvendit, përmes të cilës vet Kuvendi ka përcaktuar që mund të shmangë të gjitha afatet procedurale të punës, nuk mund të cenojnë ushtrimin e funksionit primarë të Kuvendit të Republikës, sepse edhe sipas Rregullores së Kuvendit që e kanë miratuar vet përfaqësuesit e popullit, procedura e miratimit të ligjeve lidhur edhe me projektligjet që ndërlidhen me sigurinë kombëtare dhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme i nënshtrohet afateve procedurale.
211. Thënë këtë, para Gjykatës nuk është kontestuar Rregullorja e punës së Kuvendit, përkatësisht neni 123 i saj dhe as Vendimi [Nr. 08-V-449] i 15 dhjetorit 2022, përmes të cilit Kuvendi ka votuar për shmangien nga afatet procedurale të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendin përkitazi me Ligjin e kontestuar, por procedura e miratimit të Ligjit të kontestuar në kontekst të neneve 76, 77 dhe 78 të Kushtetutës. I pari, përkatësisht neni 76 [Rregullorja e Punës] i Kushtetutës, përcakton që Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit. I dyti, përkatësisht, neni 77 [Komisionet] i Kushtetutës, siç është sqaruar më lart, përcakton kategoritë e komisioneve në Kuvend, parimet e përbërjes së tyre dhe saktëson që pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Ndërsa, i treti, përkatësisht neni 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] i Kushtetutës, siç është sqaruar më lart, përcakton rolin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe, ndër të tjera, faktin që (i) me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve; dhe (ii) Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda 2 (dy) javësh.
212. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, (i) përmes Vendimit [Nr. 08-V-449] të 15 dhjetorit 2022, Kuvendi bazuar në nenin 123 të Rregullores së tij kishte shmangur afatet procedurale për shqyrtim të Ligjit të kontestuar por u kishte dhënë mundësinë e shqyrtimit komisioneve përkatëse, gjegjësisht Komisionit funksional dhe Komisioneve të përhershme; (ii) bazuar në shkresat e lëndës, përpos Komisionit për Buxhet, Financa dhe Transfere, Komisioni përkatës funksional dhe komisionet e tjera të përhershme kishin paraqitur raportet e tyre me rekomandime në pajtim me afatet procedurale të përcaktuara në Vendimin e lartcekur të Kuvendit; ndërsa (iii) Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim kishte paraqitur rekomandimet e tij para seancës për shqyrtimin e Ligjit të kontestuar dhe për më tepër parashtuesit e kërkesës nuk kishin paraqitur dëshmi apo argument se lidhur me Ligjin e kontestuar, kishte kërkesë specifike nga njëri nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit që Ligji i kontestuar të shqyrtohet nga ky Komision në harmoni me procedurat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenin 78 të Kushtetutës, përkatësisht afatit dy (2) javor.
213. Në rrethana të tilla, dhe marrë parasysh përmbajtjen e neneve të kontestuara të Kushtetutës, përfshirë edhe argumentet e parashtuara nga parashtuesit e kërkesës, përkitazi me procedurën e ndjekur në Kuvend lidhur me miratimin e Ligjit të kontestuar, Gjykata duhet të konstatojë që procedura përkitazi me nxjerrjen e Ligjit të kontestuar, nuk është argumentuar të jetë në kundërshtim nenet e lartcekura, përkatësisht nenet 76, 77 dhe 78 të Kushtetutës. Gjykata, në kontekst të pretendimeve dhe rrethanave përkatëse të rastit, rikujton se edhe Aktvendimet për Papranueshmëri

në rastet e saj [KO118/16](#), parashtrues *Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën dhe [KO120/16](#), parashtrues *Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, ndër të tjera, i kishte cilësuar si të pabazuara në baza kushtetuese pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të dispozitave procedurale të nenit 78 të Kushtetutës, gjegjësisht mos shqyrtimit të Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën nga ana e Komisionit të përhershëm për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (shih rastet e Gjykatës, KO118/16, rast i cituar më lart, paragrafët 62-65 dhe KO120/16, rast i cituar më lart, paragrafët 89-91).

214. Thënë këtë, Gjykata sërish vë theks në faktin që ushtrimi i pushtetit legjislativ, funksioni parësor i të cilit është procesi ligjvënës, nuk mund të reduktohet vazhdimisht në përcaktimet e nenit 123 të Rregullores së Kuvendit përmes të cilit 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë mund të vendosin të anashkalojnë të gjitha afatet procedurale të së njëjtës Rregullore, duke përfshirë shqyrtimin e projektligjeve, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret dhe që përcaktojnë parimet thelbësore të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës e që nuk ndërliken as me ato rrethana në të cilat vet Kuvendi, përmes Rregullores së tij, përjashtimisht ka përcaktuar “*procedurë të përshtypshme*” apo/dhe “*procedurë urgjente*” të ligjvënës në raste kur projektligjet përkatëse ndërliken ekskluzivisht me çështje të sigurisë kombëtare, shëndetit publik apo gjendjes së jashtëzakonshme. Gjykata në këtë kontekst rikujton nenin 74 të Kushtetutës, sipas të cilit, deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

***(ii) Lidhur me pretendimin për mospërputhje në dokumentacionin zyrtar përkitazi me ligjin e kontestuar, të prezantuar në seancën plenare të Kuvendit***

215. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ekzistojnë dy raporte me tekste/përmbajtje të ndryshme të amendamenteve (amandamenti 10) në dokumentacionin zyrtar të seancës plenare të Kuvendit lidhur me votimin e Ligjit të kontestuar, të cilat janë paraqitur nga Komisioni funksional dhe mbajnë data të ndryshme, njëri raport datën 20 dhjetor 2022, ndërsa tjetri datën 21 dhjetor 2022. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës, shprehen si në vijim: “*Kemi të bëjmë me vënie në lajthitje të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me vërtetësinë e amendamenteve dhe procedurën e ndjekur në lidhje me to. Këto amendamente janë votuar në seance plenare dhe janë bërë pjesë e ligjit*”.
216. Gjykata vë në pah se parashtruesit e kërkesës vetëm pohojnë se ekzistojnë mospërputhje në dokumentacionin zyrtar përkitazi me amendamentet e propozuara në ligjin e kontestuar, mirëpo, nuk kanë specifikuar dispozitat kushtetuese të cilat pretendojnë se janë shkelur dhe as nuk ofrojnë ndonjë arsyetim përkatës lidhur me shkeljen e tyre.
217. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nën-paragrafët 2 dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 42 të Ligjit, palët kanë detyrim që të qartësojnë: (i) dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; si dhe (ii) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti. Në këtë drejtim, dhe lidhur me këtë pretendim Gjykata përsërit se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar por nuk kanë saktësuar dispozitat e Kushtetutës që janë shkelur. Prandaj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për mospërputhje në dokumentacionin zyrtar përkitazi me amendamentet e

propozuara në Ligjin e kontestuar, nuk mund t'i nënshtrohen vlerësimit meritore të Gjykatës.

(iii) *Përfundim lidhur me procedurën e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar*

218. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata konkludon se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar nuk është argumentuar të jetë në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës, ndër të tjera, për shkak se: (i) Kuvendi bazuar në nenin 123 të Rregullores së Kuvendit, kishte votuar për shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara në Kushtetutë, për më tepër që, (ii) parashtruesit e kërkesës nuk kanë argumentuar që bazuar në nenin 78 të Kushtetutës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, kishte kërkuar kohën prej 2 (dy) javësh dhe të cilën ia mundëson specifikisht Kushtetuta, për të bërë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar, por i njëjti kishte dorëzuar mendimin përkatës para mbajtjes së seancës plenare kur Ligji i kontestuar ishte shqyrtuar në lexim të dytë.

## II. SA I PËRKET PËRMBAJTJES SË LIGJIT TË KONTESTUAR

219. Gjykata fillimisht rikujton se 21 (njëzet e një) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes dy (2) kërkesave të ndara, bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar, për të cilat nene pretendojnë se nuk janë në përputhshmëri me nenet: 3 [Barazia para Ligjit] 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.
220. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nenet 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit të kontestuar janë kundërkushtetuese, ndër të tjera, për arsytet në vijim:
- (i) *“përshtatshmëria”* si kriter shtesë për punësim, i përcaktuar në nenin 9 të Ligjit të kontestuar, bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, të garantuara me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës;
  - (ii) neni 12 i Ligjit të kontestuar, i cili parasheh se Qeveria miraton dhe koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre, mundëson ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Qeverisë në punësimet në Kuvend, në Sistemin Gjyqësor dhe institucionet e tjera të pavarura, andaj bie në kundërshtim me nenin 4 [Ndarja e Pushteteve] të Kushtetutës;
  - (iii) neni 46 i Ligjit të kontestuar që përcakton mandatin katërvjeçar, me mundësi vazhdimi, për nëpunësit civil të nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët, për dallim nga Ligji aktual për Zyrtarët Publikë i cili parasheh mandat të pacaktuar, bie ndesh, mes tjerash, me parimin e sundimit të ligjit të garantuar me nenin 7 të Kushtetutës, hierarkinë e akteve juridike sipas nenit 16 dhe 19 të Kushtetutës, pasi i njëjti është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së dhe Parimet e Administratës Publike të SIGMA-s; dhe

- (iv) neni 99 i Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se për të gjitha pozitat e nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët brenda 1 (një) viti do të shpallet procedura e rekrutimit, bie në kundërshtim me “*të drejtat e fituara*” dhe cenon “*prirjet legjitime*” të nëpunësve civilë në fjalë, të cilët kanë nënshkruar akt emërimi me afat të pacaktuar, dhe rrjedhimisht, mes tjerash, prek të drejtën e tyre në pronë, dhe të drejtën e tyre në punë, të garantuara me nenin 46, respektivisht nenin 49 të Kushtetutës.
221. Këto pretendime, në esencë dhe sipas sqarimeve të dhëna në pjesën që ndërlidhet me pretendimet dhe përgjigjet e palëve të interesuara para Gjykatës, në parim, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit, ndërsa kundër-argumentohen nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe grupi parlamentar i LVV-së.
222. Gjykata rikujton se kërkesat në fjalë janë parashtruar bazuar në juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, e cila dispozitë autorizon Gjykatën që përveç procedurës së ndjekur për miratimin e ligjeve, të kontrollojë edhe kushtetutshmërinë e përmbajtjes së tij.
223. Andaj, Gjykata do të kufizohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së Ligjit të kontestuar në fushëveprimin e dispozitave të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës, respektivisht të neneve 9, 12, 46 dhe 99 por duke marrë parasysh që e njëjta bazuar në juridiksionin e kontrollit preventiv të ligjeve, të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, do të vlerësojë dispozitat e tjera të Ligjit të kontestuar të ndërlidhura me dispozitat e tij.
224. Me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata lidhur me secilin nen të kontestuar, fillimisht do të paraqesë: (a) pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve; (b) parimet e përgjithshme të vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe/ose GJEDNJ-së; dhe më pas, Gjykata do të vazhdojë me: (c) aplikimin e atyre parimeve në nenet e kontestuara të Ligjit të kontestuar. Gjatë vlerësimit, Gjykata po ashtu, për aq sa është relevante, do të merr parasysh edhe (d) parimet e Komisionit të Venecias dhe ato të OECD/SIGMA-s për administratën publike, për aq sa janë relevante; si dhe (e) përgjigjet e Forumit të Komisionit të Venecias lidhur me çështjet kontestuese të Ligjit të kontestuar.

**A. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar me nenet 7 dhe 101 të Kushtetutës, përkatësisht lidhur me kriterin e “përshtatshmërisë” për emërim në pozita specifike të zyrtares/it publik**

*(a) Pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve*

225. Gjykata vëren se përkitazi me kriterin e “përshtatshmërisë” për emërim në pozita specifike të zyrtares/it publik, të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretendojnë se: “Përdorimi i termit “përshtatshmëria” si kriter shtesë për punësim shkon kundër parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, elemente këto të sundimit të ligjit sipas Listës së Kontrollit për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias”, i cili parim gjen zbatim sipas nenit 7 të Kushtetutës. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se kjo dispozitë “hapë rrugën për abuzim dhe arbitraritet” gjatë procedurave të rekrutimit sepse “[...] do të jetë mjet në duart e komisioneve të pranimit që të vendosin pro ose kundër një kandidati dhe jo në respektim të parimit të meritës”. Për më tepër, të njëjtit pretendojnë se ky kriter do të duhej të përcaktohej me ligj dhe jo me një akt nënligjor të

Qeverisë, dhe se kjo bie në kundërshtim edhe me paragrafin 1 të nenit 101 [Shërbimi civil] të Kushtetutës, për shkak se, sipas tyre, “[...] shërbimi civil përbën mekanizëm profesional, neutral ndaj politikës, civil dhe meritore, i përhershëm”. Këto pretendime në thelb i mbështet edhe Avokati i Popullit i cili konsideron se Ligji i kontestuar nuk ka përcaktuar se cilat pozita konsiderohen pozita specifike, për të cilat duhet të kërkohet përshtatshmëria dhe kriteret specifike shtesë, andaj, sipas tij: “[...] norma ashtu siç është e përcaktuar në nenin 9, paragrafi 2, është e paqartë dhe mund të prodhojë pasiguri juridike [...] e bën të pamundur edhe parashikimin e normës, elemente këto të sundimit të ligjit”. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe të gjeturat e Mendimit Ligjor të SIGMA-s përkitazi me Projektligjin për Zyrtarët Publikë e të dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, dhe sipas të cilit, dispozita që përcakton kriterin e “përshtatshmërisë” në Ligjin e kontestuar është “e paqartë”.

226. Në anën tjetër, Kryeministri përmes komenteve të 30 janarit 2023, konsideron se paragrafi 2 i nenit 9 të Ligjit të kontestuar nuk cenon sigurinë juridike sepse ky parim nuk ka karakter absolut dhe në veçanti duhet të balancohet me interesin e përgjithshëm publik, për të cilin thekson se “[...] kriteret e përshtatshmërisë e kanë për qëllim plotësimin e pozitive në sektorin publik me individë të përshtatshëm në kuptim të integritetit në raport me pozitën përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën specifike”. Në këtë kontekst, Kryeministri përmend jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e cila, sipas citimit të komenteve përkatëse, përcakton se: “[...] parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore [...]”. (shih vendimet [nr. 26](#), të datës 02.11.2015; dhe [nr. 37](#), të datës 13.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë). Gjykata po ashtu nënvizon se Kryeministri lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se specifikat e “kriterit të përshtatshmërisë” duhet të parashihen me ligj dhe jo akt nënligjor, i referohet “praktikës e SHBA-ve”, gjegjësisht, Kodit të Rregulloreve Federale, në seksionin 731.202 (b) (*Criteria for making suitability determinations, specific factors* [Kriteret për përcaktimet e përshtatshmërisë, faktorët specifik]), ku, sipas komenteve të dorëzuara, përcaktimi i kriterëve të përshtatshmërisë është bërë përmes aktit nënligjor dhe jo ligjit. Gjykata vëren se, në thelb, të njëjtat argumente si të Kryeministrit, i përsërit edhe grupi parlamentar i LVV-së në komentet e tij të 30 janarit 2023.

(b) Parimet e përgjithshme për parimin e sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike, të vendosura nga Gjykata, GJEDNJ dhe/ose Komisioni i Venecias

227. Lidhur me këto pretendime dhe në raport me parimin e “përcaktueshmërisë me ligj” dhe “parashikueshmërisë” së një norme, Gjykata rithekson parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, praktika e saj gjyqësore dhe Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, sipas së cilave parimi i sigurisë juridike, i cili është i mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit, i garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, dhe në të gjitha nenet e KEDNJ-së, kërkon që të drejtat dhe detyrimet të jenë të “përcaktuara me ligj” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#), nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 109; [Hentrich kundër Francës](#), nr. 1361/88, Aktgjykim i 22 shtatorit 1994, paragrafi 42; dhe [Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; [9405/81](#), Aktgjykim i 8 korrikut 1986, paragrafi 110; dhe, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), parashtruesit: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë, si dhe Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovë, Aktgjykim i 24 marsit 2023 (paragrafi 347). Në këtë kontekst, “përcaktueshmëria me ligj” përveç që kërkon që masa e ndërmarrë duhet të ketë bazë ligjore në legjislacionin shtetëror, kërkon

gjithashtu që dispozitat relevante të ligjit të jenë “të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”. “Parashikueshmëria”, bazuar në parimet e lartcekura, kërkon që ligji të formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre respektivisht (shih, ndër të tjera, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-Ad\(2016\)007](#), Strasburg, 18 mars 2016, paragrafët 58 dhe 59; dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 347).

228. Gjykata gjithashtu vë në pah po ashtu parimin 3 të Parimeve të OECD/SIGMA për Administratën Publike, përkritazi me rekrutimin e nëpunësve publik, të cilat, ndër të tjera, përcaktojnë se rekrutimi i nëpunësve publikë duhet të jetë i bazuar në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij, si dhe kriteret për uljen në detyrë dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës së nëpunësve publikë duhet të jenë të qarta. Në pikën 2 të tyre, këto Parime gjithashtu specifikojnë që: “Aktet ligjore (legjislacioni primar) kanë përcaktuar kriteret e përgjithshme të pranimit për të aplikuar për pozicione të shërbimit publik dhe dispozitat e përgjithshme që sigurojnë cilësinë e rekrutimit. Procedurat e hollësishme, duke përfshirë kërkesat specifike për hyrjen në secilën kategori/klasë, përshkrimet e vendeve të punës, profilet e kompetencës, metodat e përzgjedhjes, sistemet e pikëzimit dhe përbërjen e komisioneve të përzgjedhjes, mbulohen kryesisht nga aktet nënligjore” por, siç u theksua më lart, gjithnjë, duke u bazuar në parimin e “meritës” dhe “trajtimit të barabartë” (shih OECD/SIGMA, [Parimet e Administratës Publike](#), botim i vitit 2017, i përgatitur me ndihmën financiare të BE-së, f. 51)
229. Lidhur me këtë, dhe në kontekst të praktikës së vendeve tjera, Gjykata po ashtu rikujton se nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) shtete anëtare të Forumit të Venecias që janë përgjigjur lidhur me kriterin e “përshtatshmërisë”, 13 (trembëdhjetë) prej tyre në përgjigjet e tyre theksuan se nuk përcaktojnë kriteret të tilla si ai i “përshtatshmërisë” lidhur me nëpunësit publikë në kuptim të kriterit subjektiv apo integritetit (shih, përgjigjet e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë dhe Hercegovinës; Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut; Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, e cila kriterin e “besueshmërisë” e përcakton vetëm për sektorin e ushtrisë, shërbimit informativ dhe policisë; Gjykatën Kushtetuese të Bullgarisë; Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, e cila mund të përcaktojë edhe kriteret specifike në ligje të tjera sektoriale siç është kategoria B e licencës për pozitën e inspektorit; Gjykatës Supreme e Suedisë; Gjykatës Federale të Gjermanisë, Gjykatës Kushtetuese e Republikës Çeke, Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë; Gjykatës Kushtetuese e Kirgizisë; Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë; Këshillit Shtetëror të Holandës, e cila përcakton kriteret të tilla për disa pozita, si për ushtarakët por jo për pozita “të zyrës”; dhe Gjykatës Supreme të Meksikës). Në anën tjetër, 3 (tri) shtete të tjera nënvizuan se përmbajnë kriteret të ngjashme në dispozitat e tyre ligjore, megjithatë secila në bazë të specifikave përkatës, përkatësisht (i) Austria, e cila përcakton, përshtatshmërinë personale, e cila sipas përgjigjes përkatës kupton njohjen e gjuhës gjermane dhe “përshtatshmërinë profesionale”; (ii) Polonia, e cila përcakton, “reputacionin e patëmetë”, por i cili është saktësuar më tej edhe përmes praktikës gjyqësore; dhe (iii) Lihtejshtajni.
230. Thënë këtë dhe duke marrë parasysh se parimet e lartcekura lidhur me “parashikueshmërinë” e ligjit dhe rëndësinë e këtij koncepti për parimin e sigurisë juridike, përfshirë opinionet relevante të Komisionit të Venecias, në parim, “të drejtat dhe detyrimet” duhet të jenë “të përcaktuara me ligj”, dispozitat e të cilit duhet të jenë “të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”, për t’i mundësuar pushtetit ekzekutiv të ushtrojë diskrecion vetëm në fushat ku është deleguar një kompetencë të tillë, e jo thjeshtë sepse ligji është i pasigurt ose i paqartë, por edhe për t’i mundësuar subjekteve juridike që përshtatshmërisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë e përkatëse.



(c) Vlerësimi i Gjykatës

231. Në aplikimin e këtyre parimeve, Gjykata fillimisht i referohet edhe një herë nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton që:

*“1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:*

- 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;*
- 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;*
- 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;*
- 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;*
- 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;*
- 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.*
- 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe*
- 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.*

*2. Përshtatimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohet përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.*

*[...]*

*5. Përshtatshmëria dhe/apo kriteret specifike shtesë për emërim në pozitë sipas këtij neni, për të punësuarat/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.*

*6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen nuk janë kriteret të detyrueshme për themelimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it të kabinetit.”*

232. Gjykata vëren, që ky nen, ndër të tjera, në paragrafin e tij të parë përcakton parimet e përgjithshme, që një kandidat duhet të plotësojë për t’u pranuar si zyrtar publik. I njëjti, përtej kriterëve objektive, siç janë shtetësia, zotësia e veprimit, njohja e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës dhe mungesa e dënimit për vepra të caktuara penale dhe masave të rënda disiplinore, përcakton edhe kriteret më të përgjithshme, përfshirë “aftësinë për të kryer detyrën përkatëse” dhe “të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës”. “Aftësia për të kryer detyrën përkatëse” është kriter i cili vlerësohet nga autoritetet publike në procedurat e rekrutimit, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin e kontestuar dhe procedurave përkatëse të rekrutimit të institucioneve shtetërore të përcaktuara me akte të veçanta. Në anën tjetër, në paragrafin 2 të tij, neni 9 i Ligjit të kontestuar përcakton edhe kriterin shtesë të “përshtatshmërisë”, duke saktësuar që i njëjti mund të kërkohet për “pozita specifike”. Saktësimi i “pozitave specifike” apo edhe kriteret për përcaktimin e tyre si dhe përkufizimi i kriterit të “përshtatshmërisë” nuk është bërë përmes Ligjit të kontestuar. Një çështje e tillë, sipas të njëjtit, është deleguar në nivel të aktit nënligjor dhe i cili në (i) rastin e Qeverisë, miratohet me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, ndërsa në (ii) rastin e institucioneve të pavarura kushtetuese, përcaktohet me akt të veçantë të miratuar nga të njëjtat. Gjykata gjithashtu vëren që i njëjti nen, në paragrafin 6 të tij, përjashton aplikimin e këtyre kriterëve për themelimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it të kabinetit, duke u lënë diskrecion të plotë funksionarëve publikë në përzgjedhjen e anëtarëve të kabineteve përkatëse edhe përtej kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 9 të Ligjit të kontestuar.

233. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah që ligjvënësi në paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar ka përcaktuar, si kriter për një person që duhet të plotësojë në procedurën e rekrutimit për t'u pranuar si zyrtar publik edhe kriterin *“e përshtatshmërisë dhe/apo kritere specifike shitesë për emërim në pozitë”*, i cili kriter është lënë të përcaktohet me akt nënligjor. Megjithatë, Gjykata thekson që përderisa *“kriteret specifike shitesë”* mund të nënkuptojnë kritere objektive, përfshirë kualifikimet e nevojshme që duhet të ndërliohen me pozitën e punës e që janë saktësuar në pikën 1.7 të paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, ky i fundit, në paragrafin 2 të nenit 9 të tij, përmban kriterin e *“përshtatshmërisë”* si kriter subjektiv dhe lidhur me të cilin nuk përcakton (i) asnjë përkufizim; dhe për më tepër (ii) referon në *“pozita specifike”* dhe të cilat nuk janë të përcaktuara në këtë Ligj dhe përcaktimi i të cilave, bazuar në përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 9, nuk është deleguar as në saktësimin përmes aktit nënligjor, duke u mundësuar autoriteteve publike diskrecion të plotë në këtë kontekst.
234. Gjykata rikujton që bazuar në përgjigjet e shteteve anëtare të Forumit të Venecias, siç u sqarua më lart, kriteri i *“përshtatshmërisë”* nuk parashihet në legjislacionet përkatëse për shërbimin civil, me përjashtime të rralla dhe siç janë sqaruar më lart, si dhe në rast se parashihen kriteret e tilla, të njëjtat, në parim, përkufizohen në legjislacion primar.
235. Për më tepër, bazuar në parimet e lartcekura të OECD/SIGMA-s, Komisionit të Venecias por edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, përkitazi me standardin që *“legjislacioni primar përcakton kriteret e përgjithshme të pranimit për të aplikuar për pozicione të shërbimit publik”* dhe që në këtë rast, dispozitat relevante të ligjit duhet të jenë *“të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”*, Gjykata vlerëson që përmes formulimit të paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, përcaktohet një *“kriter shitesë”* që prek statusin e një kandidati që aplikon për *“pozita specifike”* si zyrtar publik, respektivisht, prek të drejtat dhe detyrimet e të njëjtit, dhe pavarësisht që si i tillë është *“i përcaktuar me ligj”*, në mungesë të përkufizimit të mëtejshëm të kriterit subjektiv të *“përshtatshmërisë”*, rezulton që kriteri i tillë nuk plotëson kushtet që të jetë *“i qartë dhe i parashikueshëm”*, gjë që (i) i lejon pushtetit ekzekutiv dhe institucioneve tjera diskrecion të gjerë dhe të pakufizuar që përmes miratimit të aktit nënligjor të përcaktojë dhe/ose aplikojë kriterin e *“përshtatshmërisë”*, i cili në vetvete është kriter subjektiv dhe nuk ndërliohet me aftësitë profesionale të një kandidati. Tutje, aplikimi i një kriteri të tillë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon gjithashtu në *“qartësinë”* dhe *“paparashikueshmërinë”* nga ana e kandidatëve për t'u punësuar në administratën shtetërore në favor të diskrecionit të plotë të autoritetit publik, duke afektuar gjithashtu edhe të drejtën e ankesës, përkatësisht të drejtën në mjet efektiv juridik lidhur me punësimin në administratën shtetërore mbi bazën e kriterit të *“përshtatshmërisë”*, në kundërshtim me parimet e një administrate shtetërore dhe e cila bazuar në paragrafin 1 të nenit 7 (Parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik) të vetë Ligjit të kontestuar, përcakton se: *“1. Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil dhe zyrtarëve tjerë publik të përcaktuar me këtë nen bazohet në parimin e meritës, mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve”*.
236. Siç është sqaruar më lart, paragrafi 1 i nenit 9 të Ligjit të kontestuar, përcakton saktësisht (i) mundësinë e autoriteteve përkatëse publike që në procedura të rekrutimit të vlerësojnë aftësinë e kandidatit për të kryer detyrën përkatëse siç është saktësuar në pikën 1.4 të tij; dhe (ii) mundësinë e përcaktimit të kriterëve dhe rrjedhimisht vlerësimin lidhur me plotësimin e tyre përkitazi me *“arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës”*, siç është saktësuar në pikën 1.7 të tij. Marrë parasysh këto dy kritere dhe diskrecionin që i mundësojnë secilit autoritet publik përgjatë procedurave të rekrutimit të zyrtarëve publik, përcaktimi i një kriteri shitesë të *“përshtatshmërisë”* vetëm për një kategori të caktuar pozitash/individësh/kandidatësh, në diskrecion të plotë të

institucioneve shtetërore dhe pa një definicion të qartë në nivel ligji, nuk duket të ndjekë një qëllim të qartë legjitim në mbështetje të arritjes së qëllimit për administratë shtetërore të pavarur, paanshme dhe profesionale e të bazuar në merita, përfshirë në fazën e rekrutimit.

237. Kriteri i “përshatshmërisë” si i tillë dhe siç është sqaruar më lart, (i) në njërën anë rrit diskrecionin e plotë vendimmarrës të autoriteteve publike në procedura të rekrutimit përtej kriterëve qartësisht të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar; ndërsa (ii) në anën tjetër, cenon “qartësinë” dhe “parashikueshmërinë” e nevojshme në kontekst të aplikimit/rekrutimit në administratën shtetërore përfshirë efektshmërinë e përdorimit të mjetit juridik. Për pasojë, (i) përtej faktit që në raport me përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, në mungesë të një definicioni në ligj, nuk duket që ndjek një qëllim legjitim, (ii) i njëjti nuk është as proporcional, sepse përmes definimit të një kriteri të tillë të rëndësishëm të tillë përmes akteve nënligjore, mund të cenohen edhe kriteret e përcaktuara saktësisht në nivel ligji, siç është rasti me kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar dhe të cilat mund të anashkalohen mbi bazën e kriterit të “përshatshmërisë”. Një formulim i tillë i një prej neneve thelbësore të Ligjit të kontestuar dhe i cili përcakton kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik, i cili mund t’i akordojë diskrecion të plotë vendimmarrjeje në procedura të rekrutimit autoritetit publik, ndërsa nuk garanton asnjë parashikueshmëri dhe qartësi për individin, përkatësisht kandidatit për zyrtar publik, nuk është “i qartë” e as i “parashikueshëm” dhe rrjedhimisht, cenon parimin e sigurisë juridike i cili është mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit përmes paragrafëve 1 të neneve 3 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht.

## **B. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 12 të Ligjit të kontestuar me nenin 4 të Kushtetutës**

### *(a) Pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve*

238. Gjykata fillimisht vë në pah se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) i Ligjit të kontestuar që përcakton se “*Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës: 1.1.miraton dhe koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre*” është në papajtueshmëri me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e pushteteve] të Kushtetutës sepse, sipas tyre, “[...] lejon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të qeverisë në punësimet në Kuvend, në gjyqësor dhe institucionet e tjera të pavarura, pavarësia e të cilave është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe elaboruar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (GJK), të datës 9 korrik 2020, AGJ: 1582/20, çështja nr. KO203/19, përkatësisht me paragrafët 205, 206, 207 të këtij aktgjykimi.” Ky pretendim mbështetet edhe nga Avokati i Popullit i cili konsideron se i njëjti nuk e përcakton kufizimin e kompetencës së Qeverisë ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese e që rezulton me cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve si dhe cenimin e pavarësisë organizative të këtyre institucioneve. Për më tepër, Avokati i Popullit, konsideron se: “[...] Kuvendi i Republikës së Kosovës në këtë rast ka dështuar ta zbatonte kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në paragrafin 115, si dhe konstatimet e përcaktuara në paragrafët 134 dhe 135 të Aktgjykimit KO 203/19”. Gjithashtu, Gjykata rikujton komentet e ZRRE-së së 19 janarit 2023, që ndërlidhen me këtë pretendim, e cila konsideron se “[...] është agjenci e pavarur e themeluar në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe do të duhet të kishte trajtim të veçantë në përkufizim si institucion tjetër shtetëror, i cili gëzon pavarësi të plotë funksionale dhe organizative”, dhe se stafi i tyre nuk do të duhej përfshihej në nenin 6 të Ligjit të kontestuar sepse Ligji nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë në mënyrë decisive

parasheh se asnjë anëtar i Bordit apo punonjës i ZRRE-së nuk ka status të nëpunësit civil.

239. Në anën tjetër, në lidhje me këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës, Kryeministri në komentet tij, ndër të tjera, ka theksuar se parashtruesit i kërkesës nuk ofrojnë asnjë argument se pse ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën dhe se sipas praktikës së Gjykatës, ngritja e pretendimit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konstatuar shkelje të neneve kushtetuese. Në këtë kontekst, Kryeministri, ndër të tjera, ka theksuar se Ligji i kontestuar nuk cenon nenin 4 të Kushtetutës dhe për të mbështetur këtë pretendim, citon nenet e Ligjit të kontestuar që përmbajnë autorizimet specifike për institucionet e pavarura kushtetuese, të cilat kanë prerogativën e nxjerrjes së akteve të veçanta që burojnë nga ky ligj. Gjykata, rikujton, se në thelb, të njëjtat argumente si të Kryeministrit, i përsërit edhe grupi parlamentar i LVV-së në komentet e tij të 30 janarit 2023.

*(b) Parimet e përgjithshme për parimin e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, të vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës;*

240. Gjykata fillimisht rikujton dispozitat relevante kushtetuese lidhur me parimin e ndarjes së pushteteve, gjegjësisht nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] të Kushtetutës, ndërsa sa i përket pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, Gjykata i referohet dispozitave kushtetuese për institucionet e pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], gjegjësisht në nenet 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.
241. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, së fundmi edhe në Aktgjykimin e saj në rastet KO100/22 dhe KO101/22, më specifikisht ka sqaruar se: “[...] neni 4 i Kushtetutës dhe i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, mes tjerash saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës [...]” (Shih rastet e Gjykatës, [KO100/22](#) dhe [KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 154)
242. Ndërsa, përkitazi me parimet themelore të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe garancitë për institucionet e pavarura kushtetuese, Gjykata që nga themelimi i saj, i ka shtjelluar në aktgjykimet e saj, duke u bazuar, ndër të tjera, edhe në praktikën e mira ndërkombëtare, Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias si dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: GJDBE), për aq sa ka qenë e nevojshme dhe e aplikueshme. Më saktësisht, Gjykata, ka konsoliduar praktikën e saj gjyqësore mbi parimet përkitazi me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, përmes aktgjykimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në (i) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO73/16](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga

Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastin KO73/16); (ii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO171/18](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata e kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastin KO171/18); (iii) Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO203/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastin KO203/19); (iv) Aktgjykimin në rastin [KO219/19](#), me parashtrues *Avokati i Popullit*, në të cilin Gjykata kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastin KO219/19); dhe (v) Aktgjykimin në rastin [KO127/21](#), me parashtrues *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-29 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastin KO127/21) dhe (vi) Aktgjykimin në rastin e Gjykatës [KO100/22 dhe KO101/22](#), me parashtrues të kërkesës *KO100/22, Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; dhe të kërkesës KO101/22, Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, kishte bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi në rastet KO100/22 dhe KO101/22).

243. Nga aktgjykimet e lartcekura rezultojnë se: (i) ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë, mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, është *“ndarja e pushteteve”*; (ii) funksionimi i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës bazohet në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit të balancit në mes tyre; (iii) të tri pushtetet e pavarura të përcaktuara me Kushtetutë, përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve dhe se raporti në mes tyre mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre; (iv) secili nga pushtetet, përfshirë edhe institucionet e pavarura, janë të rregulluara në kapituj të veçantë kushtetues dhe secili prej këtyre kapitujve përcakton parimet e përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pushtet, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre, që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra tjetrën, pa krijuar ndonjë *“ndërhyrje”*, *“varësi”* apo *“vartësi”* kundërkushtetuese në mes tyre, që potencialisht do të mund të ndikonte në pavarësinë e njërit apo tjetrit pushtet; (v) përveç tri pushteteve klasike, vend të veçantë në sistemin e ndarjes së pushteteve ka edhe Gjykata Kushtetuese, si institucion përgjegjës për garantimin përfundimtar të kushtetutshmërisë në nivel vendi, Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e pavarura të referuara në Kapitullin XII të Kushtetutës; dhe në fund, (vi) ndarja e pushteteve si parim themelor i nivelit më të lartë kushtetues, është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë, është i panegociueshëm (shih rastet e Gjykatës, [KO100/22 dhe KO101/22](#), cituar më lart, paragrafi 158).
244. Për më tepër, përveç institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në nenin XII të Kushtetutës, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, gjegjësisht në Aktgjykimin në rastin KO127/21 ku ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e shkarkimit të pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës), ka theksuar se ky është institucion i themeluar me Kushtetutë, e cila në paragrafin 2 të nenit 101 të saj i ka atribuar të njëjtit (i) cilësimin e institucionit *“të pavarur”* në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, *“sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*. Aktgjykimi në rastin KO127/21 nënvizon gjithashtu se qëllimi i

- dispozitës përkatëse kushtetuese reflekton pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës me qëllim të ushtrimit të funksionit të tij për *“sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave që rregullojnë shërbimin civil”* (shih rastin e Gjykatës, KO127/21, cituar më lart, paragrafi 83).
245. Tutje, në Aktgjykimin e saj në rastin KO203/19, Gjykata kishte pasur në shqyrtim Ligjin për Zyrtarët Publikë, ku, ndër të tjera, ishin trajtuar edhe parimet themelore lidhur me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese. Përmes Aktgjykimit në rastin KO203/19, Gjykata, konstatoi se Ligji në fuqi për Zyrtarët Publikë, është në papajtueshmëri, ndër të tjera, me nenin 4 të Kushtetutës për shkak dhe ndër të tjera, sepse në përjashtimet e paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë] të Ligjit të lartcekur, nuk ishin përfshirë nëpunësit civilë të institucioneve të pavarura kushtetuese, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, institucionet e përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] dhe atyre të përcaktuara në Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës. Gjykata, përmes Aktgjykimit të lartcekur, kishte theksuar, ndër të tjera, që të njëjtat, bazuar në garancitë kushtetuese, *“[...] janë të autorizuara që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative”* (Shih rastin e Gjykatës [KO203/19](#), cituar më lart, paragrafi 206).
246. Në këtë aspekt, në Aktgjykimin lartcekur, Gjykata po ashtu vlerësoi se *“[...] Kuvendi, duke autorizuar Qeverinë që përmes Ligjit të kontestuar të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit, duke përfshirë, klasifikimin e pozitave, kritereve për rekrutim dhe çështje të tjera edhe në Institucionet e Pavarura kushtetuese, pa marrë për bazë pavarësinë e tyre - cenon thelbin e pavarësisë së Institucioneve të Pavarura kushtetuese të garantuar me nenin 115 të Kapitullit VIII të Kushtetutës dhe nenet 132, 136, 139, 140, 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës, si autoritete shtetërore publike të ndara nga Legjislativi, Ekzekutivi dhe nga Gjyqësori i rregullt. Andaj, Gjykata konstatoi se shkeljet e lartpërmendura bëjnë që Ligji i kontestuar të mos jetë në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me Gjyqësorin dhe me Institucionet e Pavarura, dhe se ndaj tyre nuk mund të zbatohet përderisa nuk respekton pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative.”* (shih rastin e Gjykatës KO203/19, rast i cituar më lart, paragrafi 208).
247. Në rastin KO203/19, Gjykata gjithashtu kishte përmbledhur parimet kryesore sa i përket statusit të personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese, ashtu siç derivojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, duke theksuar se sipas këtyre parimeve, ndër të tjera, rezulton se:
- a) dispozitat e legjislacionit relevant, duke e përfshirë legjislacionin e shërbimit civil që ishte në fuqi para miratimit të Ligjit që ishte në shqyrtim para Gjykatës në rastin e lartcekur, nuk i referohen në mënyrë specifike personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese si shërbyes civilë, por parashohin që ndaj tyre aplikohet legjislacioni i shërbimit civil (shih rastin e Gjykatës [KO203/19](#), i cituar më lart, paragrafi 150 (a));
  - b) legjislacioni i shërbimit civil, duke përfshirë, aplikohen ndaj personelit të këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese, vetëm për atë që ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre (shih rastin e Gjykatës [KO203/19](#), i cituar më lart, paragrafi 150(b));
  - c) Kushtetuta dhe ligjet e veçanta i autorizojnë dhe obligojnë institucionet e pavarura, që të nxjerrin rregullore, urdhra dhe akte të tjera juridike, për të rregulluar specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre, që

dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet tjera, duke përfshirë, në atë mënyrë që ato të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative, por vetëm për atë sa është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e tyre të paraparë me Kushtetutë dhe ligje të veçanta (shih rastin e Gjykatës [KO203/19](#), i cituar më lart, paragrafi 150 (c)).

d) rregulloret dhe aktet e tjera juridike të institucioneve të pavarura kushtetuese, që rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të tyre që derivojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e veçanta, duhet të respektohen nga të gjitha institucionet, përfshirë ekzekutivin dhe institucionet tjera (shih rastin e Gjykatës KO203/19, i cituar më lart, paragrafi 150 (d)).

248. Andaj, në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse këto parime janë reflektuar në Ligjin e kontestuar.

*(c) Vlerësimi i Gjykatës*

249. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) të Ligjit të kontestuar dhe i cili: (i) në paragrafin e parë përcakton që në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës miraton dhe koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, si dhe mbikëqyr implementimin e tyre dhe miraton aktet nënligjore të autorizuara për zbatim të këtij ligji; (ii) në paragrafin e dytë përcakton që Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjendjen e zyrtarëve/eve publikë deri më 31 mars për çdo vit kalendarik, për vitin paraprak; dhe (iii) në paragrafin e tretë të tij, saktëson që në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës së zyrtarëve/eve publikë, me sindikatat dhe me përfaqësuesit e zyrtarëve/eve publikë, Qeveria e Republikës së Kosovës përfaqësohet nga ministria përgjegjëse për administratë publike së bashku me Ministrinë përgjegjëse për Financa. Kontestuese në këtë dispozitë sipas parashtruesve të kërkesës është kompetenca “mbikëqyrëse” e Qeverisë, përkatësisht kompetenca e kësaj të fundit për të mbikëqyrur implementimin e politikave të përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik dhe të cilat politika sipas këtij neni i miraton dhe koordinon Qeveria. Sipas parashtruesve të kërkesës, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, dhe siç është sqaruar më lart, një kompetencë e tillë mbikëqyrëse cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe për pasojë është në kundërshtim edhe me parimin e ndarjes së pushteteve të përcaktuar në nenin 4 të Kushtetutës.

250. Gjykata fillimisht thekson se kompetenca e Qeverisë për miratimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të politikave të përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtares/it publik, bazuar në nenin 12 të Ligjit të kontestuar, është më tej e saktësuar në nenin 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të tij. Ky i fundit, në paragrafin e parë të tij, përcakton kompetencat e Ministrisë përgjegjëse për administratë publike, duke përfshirë: (i) hartimin, propozimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për zyrtaren/in publik; (ii) mbikëqyrjen e zbatimit e legjislacionit për zyrtarët/et publikë në institucionet e administratës shtetërore; (iii) propozimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave për paga për zyrtarët/et publikë dhe funksionarët publikë; (iv) mbështetjen dhe këshillimin e institucioneve në zbatimin e Ligjit të kontestuar; (v) përgatitjen e deklaratës së përputhshmërisë me Ligjin e kontestuar, për çdo projektakt të propozuar nga institucionet e tjera, që ka të bëjë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik; (vi) organizimin sipas planifikimit të procedurave e pranimit për institucionet e administratës shtetërore në pajtim me këtë ligj; (vii) planifikimin, vendosjen dhe kryerjen e sistemimit e nëpunësve/eve civilë, të cilët/at kanë përfunduar mandatin, në pajtim me këtë ligj; (viii) miratimin dhe monitorimin e zbatimit të programeve të trajnimit për nëpunëset/it civilë; (ix)

kërkimin dhe marrjen nga institucionet e Republikës së Kosovës të çdo informacioni të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës; (x) administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; (xi) hartimin dhe miratimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe manualeve për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtarët/et publik; (xii) hartimin e politikave të angazhimit të praktikantëve në administratën publike; (xiii) hartimin e planit të përgjithshëm të personelit; dhe (xiv) përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore. Ndërsa në paragrafët 3, 4 dhe 5 të tij, ndër të tjera, përcaktohet se: (i) përgjegjësitë për hartimin, propozimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për zyrtaren/in publik, si dhe kërkimin dhe marrjen nga institucionet e Republikës së Kosovës të çdo informacioni të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës, për aq sa kanë të bëjnë me nëpunësen/in në shërbim publik, kryhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për politikën shtetërore për shërbimin përkatës publik; (ii) çdo institucion që merr në punë zyrtarë/e publikë, si dhe çdo funksionarë/e publikë dhe zyrtarë/e publikë, që ka kompetenca menaxheriale vendimmarrëse, ose që ka informacion në këtë fushë, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për administratë publike; si dhe (iii) ministria përgjegjëse për administratë publike është i vetmi institucion i administratës shtetërore që ka kompetencë për të ofruar shpjegime lidhur me përcaktimet e këtij ligji.

251. Në këtë kontekst, Gjykata së pari vë theks në faktin që nuk është kontestuese që bazuar në nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, ndër të tjera, Qeveria (i) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës; dhe (ii) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore. Për më tepër, bazuar në nenin 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës, Kryeministri, ndër të tjera: (i) siguron që të gjitha Ministritë të veprojnë në pajtim me politikën qeveritare; dhe (ii) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë. Thënë këtë, pikërisht në kapitullin VI lidhur me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe saktësisht lidhur me shërbimin civil, është përcaktuar kompetenca e një institucioni të veçantë dhe të pavarur kushtetues, përkatësisht Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës) dhe i cili, bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës është i mveshur me kompetencën e mbikëqyrjes së sigurimit të respektimit e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që në vitin 2010 dhe më pas Ligjin 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për KPMSHCK), në vitin 2018, duke përcaktuar përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të tij, përfshirë funksionet dhe kompetencat përkatëse në mbikëqyrjen e rregullave të aplikueshme për shërbimin civil dhe zbatimin e tyre, lidhur me “[...] të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil”, në mënyrë të pavarur nga Qeveria dhe detyrimin që për punën e tij, nuk i raporton Qeverisë, por Kuvendit të Republikës së Kosovës.
252. Gjykata më tej thekson që kompetenca e mbikëqyrjes së respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil është kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese është tejet e konsoliduar në kontekst të pavarësisë së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe funksioneve të tij, duke përfshirë por mos u kufizuar përmes Aktgjykimeve në rastet e lartcekura të Gjykatës: KO171/18 dhe KO127/21. Kjo kompetencë kushtetuese e Këshillit nuk mund të cenohet nga një institucion tjetër në Republikën e Kosovës, përfshirë Qeverinë, përmes akteve me hierarki më të ulët të normës, përkatësisht ligjeve të miratuara në Kuvend, siç është saktësuar tashmë përmes praktikës gjyqësore të lartcekur të Gjykatës.



253. Gjykata rikujton që bazuar në nenin 101 të Kushtetutës dhe Ligji për KPMSHCK-në, ky i fundit, është i definuar si institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Ky funksion, bazuar në të njëjtin ligj, ushtrohet nga 7 (shtatë) anëtarë që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky Këshill, bazuar në nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, ndër të tjera, është përgjegjës për: (i) mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (ii) shqyrtimin dhe marrjen e vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil; (iii) mbikëqyrjen dhe procedurën e përzgjedhjes dhe vendosjen nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil; dhe (iv) monitorimin e institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Për më tepër, bazuar në nenin 7 (Kompetencat e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, Këshilli, ndër të tjera, ka të drejtë, (i) të vizitojë çdo institucion që ka të punësuar nëpunës civil; (ii) të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (iii) të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit; (iv) të kërkojë dhe marr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij; dhe (v) të nxjerr vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime. Gjithashtu, bazuar në nenin 20 (Monitorimi i institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil) të Ligjit për KPMSHCK, Këshilli, ka kompetencën që me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil. Për më tepër, bazuar në nenin 25 (Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike) dhe nenin 28 (Raporti vjetor i Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, ndër të tjera, është i rregulluar (i) bashkëpunimi me institucionet e administratës publike, duke përfshirë detyrimin që çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin; dhe (ii) raportimin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues, lidhur me kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, dhe rekomandimet për institucionet e administratës publike, Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke ia dorëzuar një kopje edhe Kryeministrit.
254. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata vë theks në faktin që (i) kompetenca e përcaktuar e Qeverisë së Republikës së Kosovës bazuar në nën-paragrafin 1.1 të nenit 12 të Ligjit të kontestuar, lidhur me *“mbikëqyrjen”* dhe *“implementimin”* që ndërlihet me respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, që derivojnë si rezultat i miratimit të politikave përkatëse, është kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës; dhe (ii) kompetenca e përcaktuar e Qeverisë për t’i raportuar Kuvendit të Republikës së Kosovës për *“gjendjen e zyrtarëve/eve publik”* është po ashtu kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në paragrafin 2 të nenit 4 (Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) dhe paragrafit 1 të nenit 28 (Raporti vjetor i Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK.
255. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që kompetencat e përcaktuara të Ministrisë së përgjegjëse për administratën publike, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme bazuar në nenin 13 të Ligjit të kontestuar, janë kompetenca të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të përcaktuar në nenin 101 të Kushtetutës dhe Ligjit për KPMSHCK. Më saktësisht, kompetenca e Ministrisë përgjegjëse për administratën publike lidhur me (i) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për zyrtaren/in publik e përcaktuar në nën-

paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar është kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës sipas paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe nenit 6 (Kompetencat e Këshillit), përfshirë edhe nenin 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues), të Ligjit për KPMSHCK; (ii) kërkimin dhe marrjen e çdo informacioni të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës nga institucionet e Republikës së Kosovës e përcaktuar në nën-paragrafin 1.9 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar është kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës sipas nën-paragrafit 1.4 të paragrafit 1 të nenit 7 (Kompetencat e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK. Për më tepër, detyrimi i bashkëpunimit të të gjitha autoriteteve publike në kontekst të nëpunësve të administratës shtetërore/shërbimit civil, është i përcaktuar në kontekst të Këshillit bazuar në nenin 25 (Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike) të Ligjit për KPMSHCK, ndërsa përmes paragrafit 4 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, ky detyrim është i përcaktuar në raport me Ministrinë përgjegjëse për Administratën Publike. Gjykata gjithashtu vëren, që bazuar në paragrafin 5 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, Ministria përgjegjëse për administratë publike *“[...] është i vetmi institucion i administratës shtetërore që ka kompetencë për të ofruar shpjegime lidhur me përcaktimet e këtij ligji”*. Një kompetencë e tillë ekskluzive e Ministrisë përkatëse gjithashtu bie ndesh me funksionin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës siç është përcaktuar në nenin 7 të Ligjit për KPMSHCK.

256. Bazuar në sqarimet e lartcekura, nuk është kontestuese që Qeveria përmes Ligjit të kontestuar nuk mund të përvetësojë apo/edhe cenojë kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, për të ushtruar funksionin e mbikëqyrjes dhe sigurimit të respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Kompetencat e përcaktuara për Qeverinë, sipas sqarimeve të mësipërme, në disa nga paragrafët e neneve 12 dhe 13 të Ligjit të kontestuar, janë tashmë kompetenca të përcaktuara për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës bazuar në nenin 101 të Kushtetutës dhe Ligjin për KPMSHCK-në.
257. Për më tepër, dhe në kontekstin e lartcekur, Gjykata vë theks të shtuar në paragrafin 2 të nenit 104 të Ligjit të kontestuar, sipas të cilit, me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar *“shfuqizohet dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”*. Kjo dispozitë, mundëson shfuqizimin e kompetencave mbikëqyrëse të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe të cilat përmes neneve 12 dhe 13 të Ligjit të kontestuar, i janë përcaktuar Qeverisë, pavarësisht që në nenin 15 (Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) të Ligjit të kontestuar, referohet kompetenca e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.
258. Andaj, përcaktimi i kompetencave të paralele për Qeverinë dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës përmes dy ligjeve të ndryshme, në anashkalim të kompetencës kushtetuese të Këshillit dhe për më tepër, përcaktimi se çdo dispozitë në kundërshtim me Ligjin e kontestuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij të fundit, jo vetëm që cenon kompetencën e Këshillit të përcaktuar përmes nenit 101 të Kushtetutës, por gjithashtu cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 4 të Kushtetutës por edhe parimin e sigurisë juridike të mishëruar në paragrafët 1 të neneve 3 dhe 4 të Kushtetutës, respektivisht.
259. Për më tepër, përmes nën-paragrafit 1.5 i nenit 13 të Ligjit të kontestuar, përcaktohet kompetenca mbikëqyrëse e Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndaj projektakteve nga institucionet tjera që ka të bëjë me marrëdhënien e punës së zyrtarëve publikë, përmes përcaktimit se e njëjta përgatit deklaratë të përputhshmërisë me këtë ligj lidhur me çdo projektakt të institucioneve tjera. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se një kompetencë e tillë, mbikëqyrëse, e Ministrisë përkatëse bie ndesh me pavarësinë e institucioneve, siç janë Presidenca e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Sistemi i Drejtësisë,

Kuvendi, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, të cilave Kushtetuta, ashtu siç është interpretuar nga Gjykata, mes tjerash në aktgjykimet e rasteve të Gjykatës KO73/16 dhe KO203/19, por siç është përcaktuar edhe në vet paragrafin 3 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar, ua mbron pavarësinë e tyre, veçanërisht në raport me ekzekutivin.

260. Ngjashëm, dhe në ndërlidhje me kompetencën për të marrë informacion të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës, siç u theksua më lart, kjo është kompetencë edhe e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, dhe bazuar edhe në sqarimet e lartcekura, edhe kompetenca për të kërkuar dhe marrë çdo informacion të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës nga institucionet e Republikës së Kosovës e përcaktuar në nën-paragrafin 1.9 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, si dhe siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, e cila është reflektuar tek parimet e përgjithshme, po ashtu nuk është në pajtueshmëri me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, të cekura më lart.
261. Andaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton që formulimi “*si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre*” në nën-paragrafin 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafin 2 të nenit 12, nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Gjykata sqaron se paragrafi 3 i nenit 13 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën si pasojë që i njëjti i referohet nën-paragrafëve 1.1 dhe 1.9, të cilët u deklaruan që nuk janë në përputhje me Kushtetutën.
262. Megjithatë, përtej konstatimeve të lartcekura se dispozitat respektive të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me institucionet e pavarura kushtetuese, përkatësisht Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në kontekst të pretendimit të parashtrueseve të kërkesës që neni 12 i Ligjit të kontestuar gjithashtu cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve në kundërshtim me nenin 4 të Kushtetutës, Gjykata, në vijim do të vlerësojë ndaras, nëse Ligji i kontestuar, cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese.
263. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vëren që bazuar në nenin 1 (Qëllimi) të Ligjit të kontestuar, qëllimi i të njëjtit është rregullimi i marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitive, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.
264. Gjykata gjithashtu vëren që neni 2 (Fusha e zbatimit), neni 3 (Përfashtime nga fusha e zbatimit të ligjit) dhe neni 6 (Nëpunësja/i civil me status të veçantë) të Ligjit të kontestuar, përcaktojnë përjashtimet përkatëse nga fushëveprimi i Ligjit të kontestuar. Përkatësisht, neni 3 i Ligjit të kontestuar përcakton përjashtimin e zbatueshmërisë së tij për: (i) gjyqtaret/ët dhe prokuroret/ët; (ii) personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo organizatës tjetër pasardhëse; (ii) të punësuarat/it në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Njësinë për Inteligjencë Financiare; (iv) drejtorin/in apo anëtarët/ët e organit drejtues kolegjal të agjencive rregullatore; dhe (v) personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo komunës. Më saktësisht, neni 3 i Ligjit të kontestuar, përcakton përjashtimin e zbatueshmërisë së tij, edhe për (i) të zgjedhurat/it; (ii) anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; (iii) të emëruarat/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji; ndërsa në nën-paragrafin 1.3 të paragrafit 1 të tij, saktësohet që Ligji i kontestuar nuk zbatohet për

*“funksionarët/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji”.*

265. Për më tepër dhe përtej përjashtimeve të përcaktuara në nenin 3 të tij, Ligji i kontestuar në nenin 6 të tij, përcakton nëpunësit me *“status të veçantë”* dhe të cilët përfshijnë (i) të punësuarit në shërbimin korrektues dhe sprovues të Kosovës; (ii) anëtarët e shërbimit të jashtëm; (iii) zyrtarët/et e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror; (iv) anëtarët/et e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike; (v) të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Agjencitë e saj; (vi) të punësuarat/it në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e saj, përjashtimisht Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës; (vii) të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe (viii) të punësuarat/it në Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, duke u mundësuar këtyre kategorive që me *“ligj të veçantë”* t'i rregullojnë ndryshe elementet e marrëdhënies së punës, që përfshijnë (i) kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; (ii) të drejta ose detyrime specifike; (iii) rregulla të veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; (iv) trajnime dhe zhvillim profesional; (v) transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; (vi) përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; dhe (vii) disiplinën dhe vlerësimin. Paragrafi 3 i këtij neni, saktëson që në rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesit civilë me status të veçantë dhe të cilët, siç është sqaruar më lart, janë taksativisht të listuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe përjashtojnë institucionet e pavarura kushtetuese, dispozita mbizotëruese janë dispozitat e *“ligjit të veçantë”*.
266. Gjykata më tej vëren që bazuar në nenet 2 dhe 6 të Ligjit të kontestuar, lista e institucioneve shtetërore përkritazi me të cilat është përjashtuar apo kufizuar aplikimi i Ligjit të kontestuar, përfshirë vet Ministrinë e Punëve të Brendshme, në cilësinë e Ministrisë përgjegjëse për administratë publike, nuk reflekton saktësisht qëllimin legjitim të ndjekur në përcaktimin e përjashtimeve apo kufizimeve të tilla. Thënë këtë, Gjykata, duke u bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, fushëveprimin e Ligjit të kontestuar do e analizojë vetëm në kontekst të pavarësisë së institucioneve të pavarura.
267. Gjykata, në këtë kontekst, së pari thekson që nëpunësit e administratës së institucioneve të pavarura kushtetuese janë kategorizuar në kategorinë e nëpunësve të shërbimit civil sipas nën-paragrafit 1.2 të paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të nenit 5 të Ligjit të kontestuar. Përderisa, institucionet e pavarura kushtetuese janë referuar edhe në paragrafin 4 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, të njëjtat nuk janë listuar në listën e specifike të institucioneve të saktësuara në paragrafin 1 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar dhe përkritazi me të cilat, Ligji i kontestuar, përcakton mundësinë e rregullimit të marrëdhënies së punës ndryshe nga dispozitat e Ligjit të kontestuar përmes *“ligjit të veçantë”* dhe i cili bazuar në paragrafin 3 të këtij neni, mbizotëron dispozitat e Ligjit të kontestuar. Megjithatë, duke u referuar në institucionet e pavarura kushtetuese në paragrafin 4 të tij, neni 6 përcakton që nëpunësit përkatës të tyre janë gjithashtu *“nëpunës me status të veçantë”*, rregullimi i të cilëve, bëhet me *“akt të veçantë”*.
268. Në këtë drejtim dhe më tej, Gjykata i referohet nenit 2 të Ligjit të kontestuar dhe i cili e përkufizon fushën e zbatimit të Ligjit të kontestuar. I njëjti, në paragrafin 1 të tij, saktëson që ligji zbatohet për zyrtarin/en publik në institucion publik të Republikës së Kosovës. Në paragrafin 2 të tij, saktëson që marrëdhënia e punës së zyrtarit/es publik mund të rregullohet ndryshe vetëm kur parashihet *“shprehimisht me këtë ligj”*. Ndërsa në paragrafin 3 të tij, përcakton që për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së

Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese, “*ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”. Për më tepër, duke e përfshirë këtë kategori nëpunësish në kategorinë e nëpunësve “*me status të veçantë*” sipas nenit 6 të Ligjit të kontestuar, ky i fundit u mundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që marrëdhënien e punës të rregullojnë përmes ligjeve dhe akteve të veçanta, dhe të cilat sipas paragrafit 3 të nenit të lartcekur, mbizotërojnë dispozitat e ligjit të veçantë. Përderisa, përjashtimet e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit të kontestuar, janë të kufizuara vetëm në rrethanat e përcaktuara me vet nenin e lartcekur, në rastin e institucioneve të pavarura kushtetuese, të njëjtat gjithashtu veprojnë nën mbrojtjen e paragrafit 3 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar lidhur me aplikueshmërinë e tij në kontekst të institucioneve të pavarura kushtetuese, vetëm “*për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuara me Kushtetutë*”.

269. Gjykata gjithashtu vëren që paragrafët 4 dhe 7 të nenit 19 (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore), paragrafi 7 i nenit 37 (Marrëdhënia e punës në shërbimin civil), paragrafi 7 i nenit 38 (Klasifikimi i pozitave në shërbimin civil), paragrafi 15 i nenit 39 (Procedura e pranimit në Shërbimin Civil), paragrafi 7 i nenit 40 (Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale), paragrafi 3 i nenit 41 (Emërimi në pozitë të kategorisë profesionale), paragrafi 7 i nenit 42 (Komisioni i pranimit për kategorinë e specialistes/it), paragrafi 3 i nenit 43 (Emërimi në pozitë të kategorisë së specialistes/it), paragrafi 12 i nenit 44 (Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese), paragrafi 7 i nenit 45 (Komisioni i pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese), paragrafi 13 i nenit 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues), paragrafi 13 i nenit 47 (Pranimi në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese), paragrafi 9 i nenit 48 (Komisioni i pranimit për kategorinë e lartë drejtuese), paragrafi 15 i nenit 49 (Emërimi dhe mandati në pozitën e nivelit të lartë), paragrafi 19 i nenit 52 (Vlerësimi i rezultateve në punë), paragrafi 7 i nenit 53 (Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësen/in e kategorisë së lartë drejtuese), paragrafi 12 i nenit 60 (Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor), paragrafi 8 i nenit 63 (Transferimi i përkohshëm), paragrafi 8 i nenit 65 (Transferimi i përhershëm për interes të institucionit), paragrafi 8 i nenit 66 (Transferimi në rast të shuarjes apo ristrukturimit) dhe paragrafi 4 i nenit 69 (Pezullimi sipas detyrës zyrtare) të Ligjit të kontestuar referojnë në rregullime të veçanta për sistemin e drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese, Presidencën, Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe institucionet e pavarura kushtetuese, respektivisht, duke i'u mundësuar nxjerrjen e akteve të veçanta nga vetë organet kompetente të këtyre institucioneve.
270. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar (i) ka përcaktuar që i njëjti zbatohet për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese, “*për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”; (ii) për nëpunësit me status të veçantë, për aq sa ekzistojnë ligjet e veçanta, të njëjtat mbizotërojnë dispozitat e Ligjit të kontestuar; dhe (iii) që në dispozita të caktuara të tij, dhe ashtu siç është specifikuar më lart, përcakton kompetencën e institucioneve të pavarura që me akte të veçanta të rregullojnë marrëdhënien e punës së nëpunësve të tyre.
271. Thënë këtë, përderisa paragrafi 3 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar përcakton që për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese, “[...] *ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”, zbatimi i këtij parimi në përputhshmëri me garantitë kushtetuese për institucionet e pavarura

kushtetuese, duhet të analizohet edhe në dritën e mekanizmave që ka përcaktuar Ligji i kontestuar në këtë kontekst, me theks në (i) paragrafin 2 të nenit 5; (ii) paragrafin 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 6; dhe nenit 104 të Ligjit të kontestuar.

272. Gjykata vëren që bazuar në paragrafin 2 të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, ndër të tjera, nëpunësit në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, janë të përcaktuara si “*nëpunës të shërbimit civil*”. Në anën tjetër, përmes paragrafit 4 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, të punësuarit në administratën e sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese, janë përcaktuar si “*nëpunës me status të veçantë*” dhe rregullimi të cilëve bëhet me akt të veçantë, përkatësisht ligj të veçantë dhe i cili bazuar në paragrafin 3 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, është mbizotëruese ndaj dispozitave të tij. Për më tepër, bazuar në paragrafin 5 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, të njëjtat institucione, gjithashtu përjashtohen nga detyrimi për të kërkuar nga Ministria përgjegjëse për administratë publike përcaktimin e kategorisë së zyrtares/it publik për atë funksion, pozitë apo emërtesë në bazë të ekuivalencës, me rastin e krijimit të funksioneve dhe pozitave të reja.
273. Në kontekst të observimeve të lartcekura, Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj, në vlerësimin e Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë, përkatësisht Aktgjykimin në rastin e saj KO203/19. Gjykata, në këtë kontekst, rikujton që (i) Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë, e kishte shpallur në nene të caktuara të tij në kundërshtim me Kushtetutën, ndër të tjera, pikërisht sepse i njëjti nëpunësit e administratës së institucioneve të pavarura kushtetuese i kishte përfshirë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar dhe nuk kishte përfshirë, ndër të tjera dhe/ose të paktën, përjashtimin e saktësuar në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili në nenin 1 (Qëllimi dhe fushëveprimi) të tij përcaktonte se “[...] institucionet e administratës qendrore, të cilat rregullohen me akte të posaçme, iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji [Ligjit për Shërbimin Civil], përveç nëse ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme” dhe nenin 3 (Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës) i po këtij ligji përcaktonte se “[...] gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi” (shih Aktgjykimin në rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafët 119-127); (ii) kishte theksuar që Ligji i kontestuar nuk parasheh mundësinë që gjatë zbatimit të tij, të merren në konsideratë ligjet e veçanta të institucioneve të pavarura dhe rregullat e tyre të brendshme për të siguruar pavarësinë e tyre, pasi, ndër të tjera, në nenin 85 të tij shfuqizonte çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë Ligj, duke përfshirë edhe ligjet e veçanta që rregullojnë këto institucione (shih Aktgjykimin në rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafët 128-130); dhe (iii) në fund, ndër të tjera, kishte vënë theks në faktin që në kontekst të institucioneve të pavarura kushtetuese, normat e veçanta, përfshirë ligjet dhe aktet nënligjore, “[...] duhet të respektohen nga të gjitha institucionet përfshirë edhe Qeverinë dhe institucionet që mbikëqyrin zbatimin e këtyre dispozitave” (shih Aktgjykimin në rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafi 160).
274. Gjykata ashtu si edhe në Aktgjykimin paraprak përkitazi me Ligjin për Zyrtarët Publik, vë theks në faktin që institucionet e pavarura, nuk mund të veprojnë në vakum në raport me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës dhe se të njëjtat gjithashtu i nënshtrohen disa kufizimeve dhe kontrollit, duke përfshirë Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, por pavarësia e tyre kushtetuese përfshirë në aspektin e organizimit të brendshëm e garantuar me dispozita kushtetuese dhe siç është sqaruar përgjatë praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës tashmë në këtë kontekst, nuk mund të cenohet përmes dispozitave ligjore (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin në rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafët 151-152). Në këtë kontekst, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar, për dallim nga ai paraprak, u mundëson institucioneve të pavarura

përjashtimin e dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, për aq sa të njëjtat mund të cenojnë pavarësinë e tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe rregullimin e funksionimit të administratës dhe organizimit të tyre të brendshëm përmes ligjeve dhe akteve të veçanta.

275. Thënë këtë, Gjykata, gjithashtu rikujton që përtej institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara me kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] lidhur me Sistemin e Drejtësisë, kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] lidhur me Gjykatën Kushtetuese dhe kapitullin XII [Institucionet e Pavarura] lidhur me Institucionet e Pavarura, Kushtetuta gjithashtu përcakton pavarësinë e Agjencive të Pavarura në nenin 142 të saj. Në kontekst të këtij të fundit, përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata, ndër të tjera, në Aktgjykimin KO203/19, ka mbajtur qëndrim që: “[...] se agjencitë e pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të institucioneve të pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Kjo, pasi themelimi, roli dhe statusi i institucioneve të pavarura kushtetuese është i rregulluar në mënyrë shprehimore me Kapitullin XII të Kushtetutës, ndërsa “Agjencitë e Pavarura” të parapara me nenin 142 të Kushtetutës “janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre”, dhe rrjedhimisht nuk mund të gëzojnë të njëjtin status sikurse institucionet e pavarura të përcaktuara shprehimisht me Kushtetutë (shih, rastin e Gjykatës KO203/19, cituar më lart, paragrafi 209).
276. Gjykata rithekson këtë qëndrim, megjithatë gjithashtu vë theks në faktin që neni 142 i Kushtetutës përcakton që: (i) Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre dhe se agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës; (ii) Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligjin; dhe (iii) secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin. Si të tilla, të njëjtat, nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit të pushtetit ekzekutiv siç përcaktojnë dispozitat e Ligjit të kontestuar.
277. Më saktësisht, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar (i) Agjencitë e Pavarura i përfshinë në definicionin e një “*institucioni tjetër shtetëror*”; ndërsa (ii) ato ekzekutive dhe rregullatore i përfshinë në definicionin e një “*institucioni të administratës shtetërore*”, ndërsa që të dy kategoritë i klasifikon në kategorinë e nëpunësit të shërbimit civil sipas nën-paragrafit 1.2 të paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të nenit 5 të Ligjit të kontestuar. Megjithatë, Ligji i kontestuar, përkundër faktit që Agjencitë e Pavarura në kuptim të nenit 142 të Kushtetutës themelohen nga Kuvendi sipas përcaktimeve të përcaktuara në ligjet përkatëse dhe rrjedhimisht nuk janë pjesë përbërëse e pushtetit ekzekutiv, nuk përcakton asnjë dispozitë që do të përjashtonte dhe/ose kufizonte mbikëqyrjen e Qeverisë në kontekst të Agjencive të themeluara nga Kuvendi. Për më tepër, Gjykata rikujton përjashtimet e saktësuara në paragrafin 1 të nenit 6 të Kushtetutës dhe të cilat, përfshijnë edhe institucione në kuadër të pushtetit ekzekutiv, përfshirë vet Ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe përjashtimi i agjencive të pavarura të përcaktuara përmes nenit 142 të Kushtetutës, nga mundësia që të rregullojë aspekte të caktuara të organizimit të tyre përmes ligjeve të veçanta të miratuara nga Kuvendi bazuar në nenin e lartcekur, nuk rezulton të ketë ndjekur ndonjë qëllim legjitim e proporcional.

278. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton që paragrafi 2 i nenit 104 të Ligjit të kontestuar, me hyrjen në fuqi të tij, përpos shfuqizimit të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 08/L-128 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, shfuqizon edhe çdo “dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”. Gjykata në kontekst të kësaj të fundit, bazuar në parimet që ndërliidhen me sigurinë juridike të mishëruara, ndër të tjera, në nenin 3 dhe 7 të Kushtetutës dhe të sqaruara më lart, përfshirë ato të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, të GJEDNJ-së por edhe parimeve të Komisionit të Venecias, thekson që një dispozitë e tillë e karakterit tejet të përgjithësuar dhe të paqartë, duke përfshirë edhe në kontekst të ligjeve të Kuvendit që janë nxjerrë: (i) lidhur me institucionet e pavarura kushtetuese dhe të cilave vet Ligji i kontestuar u mundëson të veprojnë bazuar në ligje dhe akte të veçanta; dhe (ii) bazuar në nenin 142 të Kushtetutës lidhur me Agjencitë e Pavarura, cenon pavarësinë kushtetuese të të njëjtave, dhe për më tepër, rezulton në “*paparashikueshmëri*” dhe për pasojë, cenim të parimit të sigurisë juridike në kontekst të dispozitave të aplikueshme për nëpunësit përkatës të institucioneve të Republikës së Kosovës. Formulimin e njëjtë në Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 85 të tij, përmes Aktgjykimit në rastin KO203/19, Gjykata gjithashtu e kishte shpallur në kundërshtim me Kushtetutën (shih rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafi 196).
279. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë që paragrafi 2 i nenit 104 të Ligjit të kontestuar, në ndërliidje me nenin 6 të Ligjit të kontestuar, përfshirë faktin që i njëjti ka përjashtuar Agjencitë e Pavarura nga statusi i nëpunësve civilë me status të veçantë, nuk është në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, parimin e sigurisë juridike si dhe të sundimit të ligjit të përcaktuar përmes paragrafit 1 të neneve 3, 4 dhe 7 të Kushtetutës.
280. Ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Aktgjykimi, dhe në mënyrë që të ketë qartësi dhe parashikueshmëri, dhe për pasojë, siguri juridike përkitazi me dispozitat e Ligjit të kontestuar, Kuvendi është i detyruar që të plotësojë dhe ndryshojë nenin 6 të Ligjit të kontestuar në raport me Agjencitë e Pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, duke përfshirë personelin e të njëjtave në kategorinë e nëpunësve me status të veçantë në nenin 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ashtu që të garantohet pavarësia e këtyre agjencive bazuar në nenin 142 të Kushtetutës si dhe ligjeve përkatëse për themelimin e tyre, dhe të cilat mbizotërojnë Ligjin e kontestuar, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit të kontestuar.

### **C. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 46 të Ligjit të kontestuar me nenet 3, 7, 16, 19, 21, 22, 24, 46, 49, 53, 55 dhe 101 të Kushtetutës**

#### *(a) Pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve*

281. Gjykata nënvizon se në lidhje me nenin 46 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton mandatin me kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh me të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë, për pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo dispozitë shkel parimet e sundimit të ligjit të garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës si dhe hierarkinë e normave të përcaktuara në nenet 16 dhe 19 të Kushtetutës, ku përshihet respektimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Kosovës. Kjo pasi sipas tyre neni 46 i Ligjit të kontestuar, që kufizon mandatin për pozita të caktuara në shërbim civil është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së, përmes të cilës Kosova ka marr zotim ndaj Bashkimit Evropian për reformimin e administratës publike në pajtim me parimet e SIGMA-s. Lidhur me këtë, ata theksojnë se pozita të tilla ma mandat të caktuar “[...] nuk gjen zbatim në asnjë vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe bie ndesh me Parimet e Administratës Publike të SIGMA-së që zbatohen për vendet candidate dhe



potencialisht kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian siç është edhe Kosova”. Gjithashtu të njëjtit konsiderojnë se përmes kësaj dispozite ligjore në kundërshtim me nenin 101 të Kushtetutës “[...]shkatërrohet sistemi i karrierës në shërbimin civil të Republikës së Kosovë dhe në vend të tij vendoset sistemi i bazuar në pozita të përkohshme me mandat për të gjitha pozitat e nivelit të mesëm dhe të ultë drejtues, duke e goditur kështu në esencë shërbimin civil, si trup profesionale, e paanshme dhe e pavarur nga ndikimi drejtpërdrejtë politik” dhe me këtë “rrezikon të politizohet skajshëm për shkak të mundësive të ndryshmeve me mandat të pozitive kyçe në shërbim”. Po ashtu, të njëjtit përmendin se kjo dispozitë bie në kundërshtim edhe me nenet 21, 22, 24, 46, 49, 53 dhe 55 të Kushtetutës. Gjykata gjithashtu nënvizon komentet e Avokatit të Popullit, i cili konsideron se “kalimi nga sistemi i karrierës në sistem të pozitës për drejtuesit e mesëm dhe të ultë”, jo vetëm që e cenon qëndrueshmërinë e shërbimit civil, por edhe pritshmërinë legjitime, sepse themelimi i marrëdhënies së punës është realizuar nëpërmjet rregullave (legjislacionit) të cilat e kanë garantuar kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës pa afat.

282. Në anën tjetër, Kryeministri në komentet e tij, ndër të tjera, pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 120 të MSA-së, i konsideron qartazi të pabazuara për shkak se në juridiksionin e Gjykatës “[...] nuk është i përfshirë kontrolli kushtetues i ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare”, dhe sipas të njëjtit, as këto të fundit nuk janë objekt kontrolli i kushtetutshmërisë. Për më tepër, Kryeministri theksoi se neni 46 i Ligjit të kontestuar është në pajtim me dispozitën e lartcekur të MSA-së për shkak se ky rregull i mundëson çdo të punësuarit të avancojë në pozitë përmes konkurseve të hapura dhe publike dhe se karriera në shërbim civil taksativisht nuk mund të zhvillohet vetëm përmes një sistemi, por mund të jetë sistem i karrierës, sistem dual apo sistem i pozitës. Gjykata vëren se në thelb të njëjtat argumente si të Kryeministrit, i përsërit edhe grupi parlamentar i LVV-së në komentet e tij të 30 janarit 2023.
283. Gjykata përsërit edhe qëndrimin e SIGMA-s në mendimin e saj ligjor e të dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, ku theksoi se e njëjta është kundër këtij sistemi për shkak se mandatet e caktuara për nëpunësit civilë në pozita drejtuese nuk janë të zakonshme në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe në mënyrë artikulare ato nuk shihen në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, dhe po ashtu konsideron se kjo mund të çojë lehtësisht në politizimin e administratës publike deri në nivelin e udhëheqësve të njëjësive. Edhe pse SIGMA nënvizon se ka qenë në favor të hapjes së sistemit, duke pasur parasysh madhësinë e administratës publike të Kosovës, megjithatë, ka rekomanduar rishqyrtimin e gjithëpërfshirës së hapjes së pozitave, duke i dhënë përparësi kandidatëve të brendshëm, me transferime dhe promovim horizontal ndaj kandidatëve të jashtëm. SIGMA po ashtu theksoi vullnetin e Qeverisë që të përmirësojë performancën e nëpunësve civilë përmes kësaj reforme, mirëpo sipas tyre, perspektiva katërvjeçare në një pozitë nuk siguron performancë më të mirë, sidomos në mandatin e dytë, kur i njëjti nuk mund të zgjatet dhe se në vend të performancës më të mirë, ministrat do të marrin pushtet. Për më tepër, SIGMA e vlerëson këtë kompetencë për të vendosur, si “[...] deri diku në mënyrë arbitrare, për jetën profesionale të nëpunësit civil”.
284. Andaj, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë se kalimi nga pozitat me mandat të pakufizuar të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në pozita me mandat të caktuar është në kundërshtim me nenin 120 të MSA së, si marrëveshje e ratifikuar në Kuvend, andaj, kjo rezulton në shkelje të hierarkisë së normave në kundërshtim me parimit të sundimit të ligjit në kundërshtim me nenet 3, 7, 16, 19, 21, 22, 24, 46, 49, 53, 55 dhe 101 të Kushtetutës.

285. Në kontekst të pretendimeve dhe kundër-argumenteve të lartcekura, Gjykata, fillimisht do të elaborojë parimet e përgjithshme të sundimit të ligjit e parimit të sigurisë juridike dhe hierarkinë e normave dhe më pas do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e dispozitës së kontestuar.

*(b) Parimet e përgjithshme lidhur me sundimin e ligjit, sigurinë juridike dhe hierarkinë e normave*

286. Gjykata fillimisht thekson që Kushtetuta ka përmendur nocionin e sundimit të ligjit në paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], si një nga vlerat ku bazohet rendi kushtetues, ndërsa ndarjen e pushteteve e ka paraparë në nenin 4 të saj.

287. Më specifikisht, neni 3 i Kushtetutës përcakton se: *“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore”;* ndërsa paragrafi 1 i nenit 4, përcakton që *“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”*

288. Për më tepër, paragrafi 1 i nenit 7 të Kushtetutës përcakton se: *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”*

289. Për më shumë, dhe në ndërlidhje me parimin e hierarkisë së akteve, Gjykata thekson se kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutë. Lidhur me këtë Gjykata fillimisht i referohet nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës, përkatësisht paragrafit 1 të saj që përcakton se: *“Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”.*

290. Gjykata po ashtu i referohet nenit 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare] të Kushtetutës që përcakton në paragrafin 1 se: *“Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare.”* Për më tepër, neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] në paragrafin 1 të tij përcakton se: *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.”* Ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.”*

291. Bazuar në dispozitat e lartcekura kushtetuese, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, rezulton se:

- (i) Kushtetuta është akti më i lartë dhe të gjitha ligjet dhe aktet tjera duhet të jenë në pajtueshmëri me të;
- (ii) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik; dhe
- (iii) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi ndaj ligjeve.

292. Lidhur me këtë, Lista Kontrolluese për Sundimin e Ligjit, e miratuar nga Komisioni i Venecias në vitin 2016, zhvillon aspektet e ndryshme të Sundimit të Ligjit, mes tjerash: (a) ligjshmërinë; (b) sigurinë juridike; (c) parandalimin e shpërdorimit të pushtetit; (d) barazinë para ligjit dhe mos-diskriminimin, (e) qasjen në drejtësi; dhe (f) ndalimin e arbitraritetit; dhe (g) mbrojtjen e të drejtave të njeriut (shih Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-AD \(2016\)007-e](#), cituar më lart, paragrafi 18). Tutje, ky dokument po ashtu përcakton elementet e secilës kategori të lartcekur, ku për parimin e legalitetit përcakton se i njëjti përfshinë parimin e supremacisë së ligjit. Sipas këtij parimi, veprimet e shtetit duhet të jenë në pajtim dhe të autorizuara me ligj. Përderisa, sipas Listës Kontrolluese për Sundimin e Ligjit, termi “*ligj*” për këtë qëllim nënkupton jo vetëm Kushtetutën, por edhe të drejtën ndërkombëtare, statutet dhe rregulloret, por në raste të caktuara, mund të përfshijë edhe praktikën gjyqësore (shih Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, cituar më lart, paragrafi 46).
293. Bazuar në parimet e lartcekura, rezulton se parimi i sundimit të ligjit i përfshirë në nenin 3 dhe 7 të Kushtetutës, ndër të tjera, përfshin edhe parimin e supremacisë së ligjit dhe respektimin e hierarkisë së ligjeve e parimin e sigurisë juridike. Bazuar në këto parime dhe ndër të tjera, nëse një akt më i ulët nuk është në pajtueshmëri me një akt më të lartë, cenohet parimi i supremacisë së ligjit dhe hierarkisë së normave si pjesë thelbësore e parimore të sundimit të ligjit.
294. Në lidhje me këtë, Gjykata më tej sqaron se, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, qëndron fakti që sipas Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, kjo e fundit nuk ka juridiksion të vlerësojë kushtetutshmërinë e përmbajtjes së një marrëveshje ndërkombëtare, por vetëm ligjit përmes së cilit është ratifikuar ajo marrëveshje ndërkombëtare (shih, ndër të tjera, konstatimet e Gjykatës në rastin [KO45/18](#), me parashtrues *Glauk Konjufca me 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafët 107-111). Megjithatë, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me vlerësimin nëse një marrëveshje ndërkombëtare është në pajtim me Kushtetutën por nëse një ligj i miratuar nga Kuvendi është në pajtim me Kushtetutën, e ku parimi i supremacisë dhe hierarkisë së normave zë një vend qendror përfshirë siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 16 të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 19 të Kushtetutës. Këto parime kushtetuese, përcaktojnë që një ligj duhet të jetë jo vetëm në harmoni me Kushtetutën por edhe me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare. Më saktësisht, bazuar në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, (i) Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës; (ii) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji; (iii) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës; dhe (iv) ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.
295. Më tej, dhe në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës që rregullon çështjen e shërbimit civil, i cili në paragrafin 1 të tij përcakton se: “1. *Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.*” Ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: “*Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës*”. Megjithatë, Gjykata vëren

se neni 101 i Kushtetutës, përtej kriterit se shërbimi civil (i) do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit; (ii) do të marrë në konsideratë parimin e barazisë gjinore; dhe (iii) përcaktimin se duhet të formohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, që siguron zbatimin e normave të shërbimit civil, nuk përcakton më tej çështjen e mandatit të nëpunësve civilë. Thënë këtë, çështja e mandatit, gjithnjë i nënshtrohet vlerësimit të parimit të sigurisë juridike.

296. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstaton se Kushtetuta nuk përmban ndonjë detyrim në lidhje me përcaktimin për shërbim civil të karrierës, ku të gjitha pozitat e shërbimit civil përveç atyre në nivel drejtues të lartë, kanë afat të pacaktuar siç përcakton ligji aktual në fuqi dhe ai paraprak.
297. Megjithatë, duke pasur parasysh parimet kushtetuese të sundimit të ligjit, supremacisë së ligjit dhe hierarkisë së normave, ashtu siç u sqaruan më lart, si dhe normën e qartë kushtetuese të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 19 të Kushtetutës se marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse përcaktimi përmes Ligjit të kontestuar se pozitat e ulëta dhe të mesme drejtuese përcaktohen me mandat të caktuar është në përputhshmëri me nenin 120 të MSA-së, respektivisht paragrafin 2 të nenit 19 të Kushtetutës.

*c) Vlerësimi i Gjykatës*

298. Gjykata, fillimisht rikujton që neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) i Ligjit të kontestuar, përcakton kalimin nga një sistem i shërbimit publik me mandat të pacaktuar në atë të caktuar me afat katër (4) vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat të dytë për të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues. Ky nen përcakton që çdo nëpunës civil/publik ka të drejtë të aplikojë për këto pozita, përfshirë vet nëpunësin që e ka mbajtur pozitën përgjatë mandatit të parë, nëse mandati i të njëjtit nuk është vazhduar edhe për katër (4) vitet pasuese. Vazhdimi i ushtrimit të detyrës në shërbim publik në pozita drejtuese të nivelit të ulët dhe të mesëm, pas përfundimit të mandatit të parë ose/edhe të dytë, është fillimisht i kushtëzuar nga fakti nëse nëpunësit përkatës kanë qenë pjesë e shërbimit civil para marrjes së pozitës së nivelit të ulët ose të mesëm drejtues. Nëse ky nuk ka qenë rasti, nëpunësi përkatës, pas përfundimit të mandatit, lirohet nga shërbimi civil. Ndërsa, përkitazi me kategorinë që ka qenë pjesë e shërbimit civil para marrjes së mandatit për pozitën e nivelit të ulët ose të mesëm drejtues, sipas nenit 46 të Ligjit të kontestuar, janë të mundshme dy alternativa, përkatësisht ata ose (i) do të sistemohen në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që plotësojnë kushtet për emërim në pozitën përkatëse dhe se refuzimi lidhur me këtë emërim rezulton në ndërprerje të marrëdhënies së punës; ose (ii) do të vendosen në listën e pritjes dhe do të gëzojnë drejtat e përcaktuara sipas nenit 67 të Ligjit të kontestuar. Ky i fundit, ndër të tjera, përcakton që (i) të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve/ve civilë në pritje, duke përfshirë pagat dhe trajnimin e tyre, përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa; dhe (ii) nëse nëpunësja/i civil nuk ricaktohet në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil brenda një periudhe nëntë (9) mujore, dhe/ose refuzon ricaktimin mund të përbëjë shkak për lirim nga shërbimi civil.
299. Për më tepër, bazuar në nenin 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar, më së voni brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, procedura e hapur e rekrutimit do të shpallet për të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues dhe të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji kanë qenë pozita me mandat të pacaktuar. Nëpunësit kanë të drejtën e aplikimit në pozitat që kanë mbajtur në procedurën e hapur të rekrutimit. Nëse nëpunësi/ja përkatës nuk ka fituar pozitën për të cilën ka aplikuar, do të ketë dy alternativa, përkatësisht ose (i) do të sistemohet në një pozitë profesionale

me kusht që plotëson kushtet për emërim në pozitën në fjalë dhe refuzimi përkitazi me të cilën përbën shkak për lirim nga shërbimi civil, dhe për një periudhë 4 (katër) vjeçare i garantohet një pagë tranzitore sipas përcaktimeve të paragrafit 5 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar; ose (ii) do të vendoset në listën e pritjes dhe gëzojë të drejtat sipas nenit 67 të Ligjit të kontestuar, sipas të cilit dhe ndër të tjera, nëse brenda afatit prej nëntë (9) muajsh, nëpunësi përkatës nuk ricaktohet në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil, mund të lirohet nga shërbimi civil.

300. Bazuar në sqarimin e mësipërm, Gjykata sqaron që ajo fillimisht do të vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 46 të Ligjit të kontestuar dhe i cili, sistemin aktual të shërbimit civil përkitazi me pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me mandate me kohë të pacaktuar sipas sistemit të pacaktuar bazuar fillimisht në (i) rregulloret UNMIK-ut, përkatësisht Rregulloren Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil, të ndryshuar dhe plotësuar me rregulloret e UNMIK-ut: Nr. 2006/20 dhe Nr. 2008/12; dhe më pas (ii) ligjet përkitazi me shërbimin civil, përkatësisht Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë, e shndërron në sistem të pozitës, me kohë të caktuar.
301. Sipas këtyre ligjeve të aplikueshme, me përjashtim të pozitave të nivelit të lartë drejtues, të gjitha pozitën në shërbimin civil që nga viti 2000, i janë nënshtuar kontratave dhe mandateve me afat të pacaktuar dhe kushtet për humbjen e pozitës dhe/ose marrëdhënies së punës, janë të pacaktuara saktësisht përmes mekanizmave lidhur me vlerësimin e performancës siç është pacaktuar në nenin 43 dhe/ose procedurat disiplinore siç është pacaktuar në nenet 45-51 të Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë.
302. Për dallim, dhe siç është sqaruar më lart, neni 46 i Ligjit të kontestuar pacakton kalimin në pozitë drejtuese e të nivelit të ulët dhe të mesëm me afat të pacaktuar në atë me afat të caktuar. Për më saktësisht, Gjykata i referohet paragrafëve 1, 6, 7, 10 dhe 11 të nenit 46 (Emërimi dhe mandati në pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) të Ligjit të kontestuar, i cili pacakton si në vijim:

*“1. Kandidatja/i për pozitën e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, e/i vlerësuar nga komisioni i pranimit me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 % të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohet kandidatë/at fitues dhe emërohet në pozitën përkatëse për një mandat me kohëzgjatje prej katër (4) vitesh me të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë.[...] 6. Vazhdimi i mandatit sipas këtij neni bëhet, nëse në fund të mandatit të parë mesatarja e performancës së mandatit të nëpunëses/it civil është vlerësuar së paku me vlerësimin “arrin pritshmëritë”.*

*7. Pas përfundimit të mandatit të dytë, ose në rast të mos vazhdimit të mandatit në pajtim me këtë nen, nëpunësja/i civil ka të drejtë të konkurrojë për të njëjtën pozitë që e ka mbajtur.[...]*

*10. Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, nëpunësja/i civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç pacaktohet në nenin 67 të këtij ligji.*

*11. Refuzimi për t’u emëruar në pozitën e kategorisë profesionale, të caktuar nga njësia përgjegjëse, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil [...].”*

303. Në kontekst të dispozitës së lartcekur, së pari, Gjykata vëren se neni 46 i Ligjit të kontestuar rregullohet në kuadër të nënkapitullit 2 (Emërimi në pozitën e kategorisë drejtuese) të kapitullit II (Pranimi dhe Karriera në Shërbimin Civil) të këtij ligji dhe rrjedhimisht, Gjykata thekson se dispozita e kontestuar në këtë rast i referohet emërimin në pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në shërbimin civil dhe nuk vlen për kategoritë e tjera të zyrtarëve publikë.

304. Së dyti, Gjykata vëren se paragrafët 1 dhe 6 të nenit 46 të Ligjit të kontestuar përcaktojnë se kandidati që është vlerësuar nga komisioni i pranimit me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 % (shtatëdhjetë përqind) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohet konkurrente/at fitues me një mandat të caktuar, gjegjësisht, me kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, dhe se i njëjti ka të drejtë vazhdimi pa konkurrim vetëm edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë me kusht që në fund të mandatit të parë mesatarja e performancës së mandatit të nëpunëses/it civil është vlerësuar së paku me vlerësimin “*arrin pritshmëritë*”. Gjykata thekson se paragrafi 7 i nenit 46 të Ligjit të kontestuar përcakton se pas përfundimit të mandatit të dytë ose në rast të mos vazhdimit të mandatit për shkak të mosarritjes së kushtit të lartcekur, nëpunësja/i civil ka të drejtë të konkurrojë për të njëjtën pozitë që e ka mbajtur.
305. Së treti, Gjykata vë në pah se paragrafët 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar përcaktojnë se nëpunësi civil i kategorisë drejtuese të nivelit të ulët dhe të mesëm, deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të Ligjit të kontestuar, dhe se refuzimi për t’u emëruar në kategorinë profesionale përbën shkak lirim nga shërbimi civil.
306. Rrjedhimisht, Gjykata vëren që sipas nenit 46 të Ligjit të kontestuar, kandidati për emërim në kategorinë e nëpunësit civil të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtuese që fiton pikët më të larta dhe kalon pragun prej 70% (shtatëdhjetë përqind) të pikëve fiton pozitën në fjalë për një mandat me kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, me të drejtë vazhdimi pa konkurrim edhe për një mandat tjetër me kohëzgjatje të njëjtë, me kusht që mesatarja e performancës së tij është vlerësuar në nivelin “*arrin pritshmëritë*”, dhe në rast të mos vazhdimit, apo pas kalimit të mandatit të dytë, i njëjti vendoset në listën e pritjes deri në ricaktimin në një pozitë të lirë të shërbimit civil nga njësia përgjegjëse, dhe eventualisht sipas nenit 67 të Ligjit të kontestuar i cili përcakton çështjet që ndërlidhen me Listën e Pritjes, mund të lirohet nga shërbimi civil, përfshirë në rast të refuzimit të pozitës së kategorisë profesionale.
307. Gjykata fillimisht rikujton faktin që, bazuar në shkresat e dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, rezultoi që Zyra e BE-se në Kosovë dhe Mendimi Ligjor i SIGMA-s, kishin ngritur shqetësime lidhur me kalimin nga mandatet me afat të pacaktuar në afat të caktuar dhe nuk kishin rekomanduar një zgjidhje të tillë. Më saktësisht, Opinioni i SIGMA-s, në këtë kontekst, ndër të tjera, thekson që: (i) mandatet me afat të caktuar nuk janë të zakonshme në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe në mënyrë artikulare ato nuk parashihen në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues; (ii) perspektiva katërvjeçare në një pozitë të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues nuk siguron performancë më të mirë, sidomos në mandatin e dytë, kur ai mandat nuk mund të zgjatet pa shpalljen e konkursit; dhe (iii) kjo reformë mund të çojë lehtësisht në politizimin e administratës publike deri në nivelin e udhëheqësve të njësive (niveli i ulët drejtues).
308. Për më tepër, Gjykata rikujton që bazuar në përgjigjet e pranuar nga Forumi i Komisionit të Venecias, rezultoi që përderisa disa nga sistemet përkatëse të administratave shtetërore kanë të përcaktuara edhe pozita me mandat të caktuar, asnjë nga shtetet që kanë dorëzuar përgjigjet para Gjykatës nuk kanë ndërmarrë një reforme të administratës publike, bazuar në të cilën, kanë shndërruar sistemin e karrierës në sistemin e pozitës, duke përcaktuar ushtrimin e detyrave të caktuara nga ato me afat të pacaktuar në afat të caktuar. Kjo me përjashtim të Austrisë.
309. Më saktësisht, sipas sqarimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese Austriake, rrethanat e reformës së administratës përkatëse përkohë me rrethanat e rastit konkret. Gjykata e lartcekur sqaron që si rezultat i ndryshimit të Ligjit për Shërbimin Civil në vitin 1994, zyrtarët publikë të nivelit të mesëm dhe të lartë kanë një mandat të caktuar prej 5 (pesë)

vjetësh, pas së cilës, nëse nuk rizgjedhen, marrin pozitën e tyre të mëparshme në shërbimin civil, me kusht që se ata kanë pasur tashmë një punësim të përhershëm në shërbimin civil para se të merrnin funksionin me afat të caktuar; përndryshe do të humbnin punësimin në shërbimin civil. Gjykata Austriake për më tepër, sqaron që deri në atë reformë, e gjithë administrata shtetërore bazohej në sistemin e karrierës. Megjithatë, vlen për t'u theksuar që kalimi nga sistemi i karrierës në sistem të pozitës për pozita të mesme dhe të larta menaxheriale, u bë në atë formë që zyrtarët publikë të cilët në atë kohë kishin tashmë një pozitë të mesme ose të lartë drejtuese, ishin të lirë të zgjidhnin sistemin e ri me mandat të caktuar (që parashihte paga tërheqëse) ose të qëndronin në sistemin e karrierës, duke rezultuar kështu në eliminim gradual të sistemit të karrierës për këto pozita dhe pa afektuar të drejtat e nëpunësve përkatës retroaktivisht.

310. Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që sipas përgjigjeve përkatëse të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, performanca në shërbimin civil, në parim, sigurohet përmes vlerësimit të performancës dhe/ose sistemeve disiplinore që mund të rezultojnë edhe në ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin, që disa nga Gjykatat Kushtetuese dhe ekuivalentët e tyre, theksuan, përfshirë përmes praktikës së tyre gjyqësore, rëndësinë e të drejtave të fituara dhe pritjeve legjitimeve dhe cenimit të mundshëm të këtyre të drejtave si rezultat i aplikimit retroaktiv të ligjit.
311. Thënë këtë, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 46 të Ligjit të kontestuar, Gjykata duhet të fokusohet në vlerësimin e dispozitave kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu potencon ingjencën kryesore kushtetuese të Kuvendit për ligjvënien në nivel vendi. Kuvendi, si pushtet legjislativ, “[...] përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, [...] nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër” (shih Aktgjykimin e Gjykatës [KO72/20](#), parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, Aktgjykim i 1 qershorit 2020, paragrafi 352, shih rastin [KO219/19](#), cituar më lart, paragrafi 259). Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të Republikës e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënien është që të respektojë procedurat ligjbërëse dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty.
312. Andaj, Gjykata potencon faktin se në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuar, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të caktuar. Gjykata veçse ka theksuar në praktikën e saj gjyqësore që në shqyrtim të kushtetutshmërisë së një Ligji, ajo asnjëherë nuk vlerëson se a është një ligj i bazuar në politika të mira publike apo jo (shih rastet e Gjykatës: Aktgjykimi [KO73/16](#), parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 52; Aktgjykimi [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafi 357; [KO12/18](#), me parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 11 qershorit 2018, paragrafi 117; dhe [KO219/19](#), cituar më lart paragrafi 259), por vetëm nëse, i njëjti mund të ketë cenuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
313. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata rikujton që pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës, është që neni 46 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së, që sipas sqarimeve të dhëna në parimet e përgjithshme më lart, nënkupton

vlerësimin e Gjykatës nëse dispozita përkatëse është në përputhje me hierarkinë e normave, përkatësisht për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret me paragrafin 2 të nenit 19 të Kushtetutës.

314. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që përmes Ligjit Nr. 05/L -069, Kuvendi kishte ratifikuar Marrëveshjen për Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike në anën tjetër. I njëjti ishte shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 1 dhjetor 2015 dhe kishte hyrë në fuqi po atë ditë, bazuar në nenin 3 (Hyrja në fuqi) të këtij ligji. Si e tillë marrëveshja e lartcekur ndërkombëtare, bazuar në nenin 19 të Kushtetutës, (i) është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, për aq sa zbatimi nuk kërkon nxjerrjen e një ligji; dhe (ii) ka epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

315. Më tej, Gjykata rikujton se neni 120 (Administrata Publike) i MSA-së përmban dy paragrafë që përcaktojnë se:

*“Bashkëpunimi dhe dialogu do të synojnë mundësimin e zhvillimit të mëtejshëm të një administrate publike profesionale, efiçente dhe llogaridhënëse në Kosovë, duke u bazuar në përpjekjet e ndërmarra për reforma në këtë fushë deri më tani, përfshirë reformat që ndërlidhen me procesin e decentralizimit dhe të krijimit të komunave të reja. Bashkëpunimi do të mbështes në veçanti sundimin e ligjit, funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë së Kosovës në tërësi si dhe zhvillimin normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës.*

*Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, transparencë dhe paanshmëri si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në kuadër të administratës publike. Bashkëpunimi do të përfshij gjithashtu përmirësimin e efikasitetit dhe kapacitetit të organeve të pavarura që shërbejnë për funksionimin e administratës publike dhe për një sistem efikas të kontrolleve dhe balancave.”*

316. Lidhur me këtë dhe në kontekst të administratës publike, neni 120 i MSA-së obligon Kosovës për: (i) bashkëpunim dhe dialog që synon mundësimin e zhvillimit të mëtejshëm të një administrate publike “profesionale, efiçente dhe llogaridhënëse” në Kosovë; dhe që (ii) bashkëpunimi në këtë fushë përqendrohet kryesisht në:

- a. ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në “merita, transparencë dhe paanshmëri”;
- b. menaxhimin e burimeve njerëzore dhe “zhvillimin e karrierës në shërbimin publik”, dhe
- c. trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në kuadër të administratës publike.

317. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se neni 120 i MSA-së përcakton obligimin për (i) bashkëpunim përkitazi me zhvillimin e administratës publike, profesionale, efiçente, dhe llogaridhënëse; (ii) zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, transparencë dhe paanshmëri; si dhe (iii) zhvillimin e karrierës. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përcakton obligim që administrata publike domosdoshmërisht dhe për të gjitha pozitat të bazohet në sistem të karrierës me mandat të pacaktuar.



318. Gjykata më tej vëren se OECD/SIGMA ka zhvilluar parimet e administratës publike për shtetet kandidate dhe kandidatët potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian në gjashtë fusha siç janë: (i) kuadri strategjik i reformës së administratës publike; (ii) zhvillimi dhe koordinimi i politikave; (iii) shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; (iv) llogaridhënia; (v) ofrimi i shërbimeve; dhe (vi) menaxhimi i financave publike (shih OECD/SIGMA, [Parimet e Administratës Publike](#), cituar më lart).

319. Parimet relevante të administratës publike në aspekt të rrethanave të rastit konkret përcaktojnë me sa vijon:

*“Menaxhimi i burimeve njerëzore*

*[...]*

*Parimi 3: Rekrutimi i nëpunësve publik bazohet në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për uljen në detyrë dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës së nëpunësve publik janë të qarta.*

*1. Procesi i rekrutimit dhe i përzgjedhjes në shërbimin publik, qoftë i brendshëm ose i jashtëm dhe pavarësisht kategorisë/klasës së nëpunësve publikë, është qartazi i bazuar në meritë, ofron mundësi të barabartë dhe është me konkurrencë të hapur.*

*2. Aktet ligjore (legjislacioni primar) kanë përcaktuar kriteret e përgjithshme të pranimit për të aplikuar për pozicione të shërbimit publik dhe dispozitat e përgjithshme që sigurojnë cilësinë e rekrutimit. Procedurat e hollësishme, duke përfshirë kërkesat specifike për hyrjen në secilën kategori/klasë, përshkrimet e vendeve të punës, profilet e kompetencës, metodat e përzgjedhjes, sistemet e pikëzimit dhe përbërjen e komisioneve të përzgjedhjes, mbulohen kryesisht nga aktet nënligjore.*

*3. Komisionet e rekrutimit dhe përzgjedhjes përfshijnë persona që kanë ekspertizë dhe përvojë në vlerësimin e aftësive dhe kompetencave të ndryshme të kandidatëve për pozicione të shërbimit publik, dhe nuk ka ndërhyrje politike.*

*4. Kandidatët që nuk emërohen kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve të padrejta të rekrutimit.*

*5. Mbrojtja kundër diskriminimi të personave që aplikojnë në shërbimin publik dhe atyre të punësuar sigurohet përmes të gjitha organeve administrative në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë. Përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe i barabartë merret në konsideratë në procesin e rekrutimit në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj.*

*6. Kriteret objektive për uljen në detyrë të nëpunësve publikë dhe për përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin publik janë të përcaktuara shprehimisht në ligj. Këto dispozita zbatohen në praktikë.*

*7. Nëpunësit publikë kanë të drejtën e ankesës kundër uljes në detyrë dhe lirim nga detyra në mënyrë të padrejtë.”*

320. Rrjedhimisht, bazuar në përmbajtjen e nenit 120 të MSA-së dhe faktin që e njëjta nuk përmban detyrime specifike në kontekst të kategorizimit dhe/ose mandateve të zyrtarëve publikë në administratën shtetërore, Gjykata konstaton që neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 120 të MSA-së dhe rrjedhimisht paragrafin 2 të nenit 19 të Kushtetutës.

321. Për më tepër, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës, dhe i cili në paragrafin e parë, përcakton që përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht, ndërsa në paragrafin e dytë, përcakton themelimin e një Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil i cili siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Bazuar në përmbajtjen e nenit të lartcekur, Gjykata vëren që dispozitat kushtetuese përkitazi me shërbimin civil në Republikën e Kosovës, nuk përcaktojnë sistemin e tij dhe/ose kohëzgjatjen e mandatave

përkatëse. Gjykata rikujton që përcaktimi i politikave publike është në kompetencë të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ respektivisht, dhe që nuk është roli i Gjykatës të vlerësojë përshtatshmërinë e politikave publike për saktësuar përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi, për aq sa të njëjtat nuk cenojnë dispozita kushtetuese.

322. Për pasojë dhe duke marrë parasysh që: (i) neni 101 i Kushtetutës dhe neni 120 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nuk përmbajnë detyrime specifike në kontekst të kategorizimit dhe/ose mandateve të zyrtarëve publikë në administratën shtetërore; dhe (ii) përmes nenit 46 të Ligjit të kontestuar afektohen zyrtarët publikë që emërohen/përzgjedhen në pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues pas hyrjes në fuqi të tij, Gjykata, konstaton që neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me (i) paragrafin 2 të nenit 19 të Kushtetutës; si dhe (iii) nenin 101 të Kushtetutës.
323. Gjykata thekson që përmes nenit 46 afektohen zyrtarët publikë që emërohen/përzgjedhen në pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar. Në një rrethanë të tillë, neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk afekton të drejtat e fituara të zyrtarëve publikë që aktualisht mbajnë pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike. Çdo pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues që fitohet pas hyrjes së Ligjit të kontestuar në fuqi, do të bëhet përmes dispozitave të Ligjit të ri, përkatësisht Ligjit të kontestuar, dhe nëpunësit përkatës civilë do të kenë paraprakisht të qarta të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Gjykata sqaron që të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve publikë/civilë të fituara bazuar në ligjin e aplikueshëm për shërbimin civil dhe/ose zyrtarët publikë, do të trajtohen ndaras në këtë Aktgjykim në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 99 të Ligjit të kontestuar.
324. Megjithatë dhe në vijim, Gjykata gjithashtu thekson ndërlidhshmërinë e neneve 46 dhe 67 të Ligjit të kontestuar. Konkretisht, Gjykata vëren se neni 46 i Ligjit të kontestuar, në paragrafët 8 dhe 9 të tij, parasheh se pas përfundimit të mandatit të përcaktuar në këtë nen, të emëruarat/it në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese, që kanë qenë në shërbimin civil para emërimit në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese, sistemohen nga njësia përgjegjëse në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që i plotësojnë kriteret për emërim në pozitën në fjalë, ndërsa të tjerët që nuk kanë qenë në shërbimin civil, lirohen nga shërbimi civil. Në përputhje me paragrafin 10 të po këtij neni, *“Deri në emërimin në një pozite të kategorisë profesionale, nëpunësja/i civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji”*.
325. Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit të kontestuar që përcakton si në vijim:
1. *Nëpunëset/it civil që pas shuarjes apo ristrukturimit të institucionit nuk janë transferuar sipas nenit 66 apo rasteve të tjera të parapara me ligj nuk mund të sistemohen, do të vendosen në listën e pritjes.*
  2. *Ministria përgjegjëse për administratë publike, kujdeset për sistemimin e nëpunësve/ve civil në pritje në kategori të njëjtë të shërbimit civil, si dhe trajnimin për pozitën përkatëse ku sistemohet.*
  3. *Refuzimi për t'iu nënshtruar trajnimit, sipas pikës 2. të këtij neni, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.*
  4. *Nëse brenda afatit prej nëntë (9) muajsh nëpunësja/i civil nuk ricaktohet në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.*
  5. *Të drejtat dhe detyrimet sipas këtij neni vlejné për aq kohe sa nëpunësja/i civil në listën e pritjes nuk ka marrëdhënie tjetër pune.*
  6. *Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve/ve civil në pritje, duke përfshirë pagat dhe trajnimin e tyre, përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të*

*ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa.”*

326. Gjykata vëren se bazuar në nenin 67 në lidhje me nenin 46 të Ligjit të kontestuar, nëpunësit civilë të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë, pas përfundimit të mandatit deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, vendosen në listë të pritjes, ku nëse nuk ricaktohen në ndonjë pozitë të lirë, brenda një periudhe nëntë (9) mujore dhe/ose refuzojnë një gjë të tillë, atëherë mund edhe të lirohen nga shërbimi civil dhe se brenda kësaj periudhe kohore kanë të drejta dhe detyrime, duke përfshirë pagat dhe të cilat, në paragrafin 6 të këtij neni, janë lënë të përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa.
327. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton parimet e lartcekura të Komisionit të Venecias por edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, të përcaktuara në paragrafët 227-230 të këtij Aktgjykimi në lidhje me sundimin e ligjit, gjegjësisht parimin e sigurisë juridike si element i saj, e të cilat, ndër të tjera, përcaktojnë se dispozitat relevante të ligjit duhet të jenë *“të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”*.
328. Gjykata vëren se paragrafët 1 deri 5 të nenit 67 të Ligjit të kontestuar përcaktojnë detyrimet ndaj nëpunësve civilë të cilët vendosen në listë të pritjes dhe atë: (i) rastet kur një nëpunës civil vendoset në listë të pritjes, që përfshijnë shuarjen apo ristrukturimin e institucionit; (ii) çështjen e detyrimit për t’u trajnuar gjatë periudhës sa janë në listë të pritjes dhe pasojat e refuzimit të trajnimit, që rezultojnë në shkak për lirim nga shërbimi civil; (iii) lirimin nga shërbimi civil në rast të mos sistemimit në një pozitë tjetër brenda afatit prej nëntë (9) muajve; si dhe përcakton (iv) se të drejtat dhe detyrimet gjatë periudhës së pritjes vlejnë për aq kohë sa të njëjtit nuk kanë marrëdhënie pune tjetër.
329. Gjykata në kontekstin e lartcekur vëren që paragrafi 6 i nenit 67 të Ligjit të kontestuar, përcakton të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civil në listë të pritjes. Gjykata gjithashtu vëren që përderisa kjo dispozitë, ndër të tjera, përcakton detyrimin e zyrtarëve në listë të pritjes që të mos kenë asnjë marrëdhënie tjetër pune gjatë kohës në të cilën janë të vendosur në listën e pritjes sepse në të kundërtën humbin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga lista e pritjes, i njëjti nen nuk përcakton të drejtën në pagë, përkatësisht nivelin e saj përgjatë të njëjtës periudhë, duke e referuar të njëjtën në rregullim përmes aktit nënligjor që mund të miratohet pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa.
330. Andaj, Gjykata vëren se përderisa neni 67 i Ligjit të kontestuar sa i përket detyrimeve të nëpunësve civil në listë të pritjes është specifik, përfshirë detyrimin për të mos patur një marrëdhënie tjetër pune përgjatë një periudhe kohore deri në nëntë (9) muaj përgjatë të cilës nuk ka qartësi përkitazi me të drejtën në pagë, e njëjta nuk saktëson të drejtat e nëpunësve civilë brenda periudhës së pritjes, e të cilat është lënë që të përcaktohen me akt nën-ligjor. Një qasje e tillë e ndjekur përmes Ligjit të kontestuar, nuk respekton parimin e proporcionalitetit në raport me çështjet që rregullohen me ligj dhe ato me akt nënligjor, përkatësisht raportin e proporcionalitetit në mes të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësve civilë në listën e pritjes.
331. Për më tepër, bazuar në parimet e lartcekura në lidhje me parimin e sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike si element i saj, Gjykata konsideron se paqartësia e plotë në nivel ligji përkitazi me të drejtat dhe detyrimet, duke përfshirë pagat e nëpunësve civil në fjalë, nuk plotëson kushtet që të jetë mjaftueshëm *“i qartë dhe i parashikueshëm”*. Kjo,

ndër të tjera, pasi që (i) i lejon pushtetit ekzekutiv diskrecion të gjerë dhe të pa kufizuar që përmes miratimit të aktit nënligjor të përcaktojë: (a) të drejtat e nëpunësit civil në listë të pritjes; si dhe (b) lartësinë e pagës/kompensimit, që i njëjti mund të përfitojë. Gjithashtu, kjo i pamundëson nëpunësit civil në listë të pritjes, që të rregullojë sjelljen përkatëse konform Ligjit dhe varet tërësisht nga të drejtat dhe detyrimet që do të përcaktohen me akt nënligjor.

332. Andaj, bazuar në parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës, GJEDNJ-së dhe parimeve të shtjelluara nga Komisioni i Venecias, e të elaboruara si më lart, Gjykata, konstaton se mospërkufizimi i të drejtave, përfshirë pagën përgjatë të vendosurit në listë të pritjes në ligj dhe delegimi i një përcaktimi të tillë me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për administratë publike, përderisa detyrimet e nëpunësve civil janë përcaktuar në Ligjin e kontestuar, e bëjnë paragrafin 6 të nenit 67 të Ligjit të kontestuar, joproportional por edhe të *“paqartë dhe të paparashikueshëm”* dhe në cenim të parimit të sigurisë juridike. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që paragrafi 6 i nenit 67 të Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të sundimit të ligjit siç është përcaktuar në paragrafët 1 të neneve 3 dhe 7 të Kushtetutës.
333. Ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Aktgjykimi, dhe në mënyrë që të ketë qartësi dhe parashikueshmëri, dhe për pasojë, siguri juridike përkitazi me dispozitat e Ligjit të kontestuar, Kuvendi është i detyruar që të plotësojë dhe ndryshojë nenin 67 (Lista e pritjes) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, duke përcaktuar edhe të drejtat e nëpunësit civil në listë të pritjes, përfshirë lartësinë e pagës/kompensimit.

#### **D. Përkitazi me pretendimet për mospërputhshmërinë e nenit 99 të Ligjit të kontestuar me nenet 7, 22, 46 dhe 49 të Kushtetutës**

##### *(a) Pretendimet dhe kundër-argumentet e palëve*

334. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 99 i Ligjit të kontestuar shkel nenet 7, 22, 46 dhe 49 të Kushtetutës për shkak se të gjithë personat që mbajnë pozitat e nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues do t'i humbin vendet e tyre të punës, pasi që për pozitat e tyre do të shpallen konkurset publike dhe nëse të njëjtit nuk përzgjidhen në pozitat e tyre aktuale, do të vendosen në listë të pritjes dhe nëse nuk ricaktohen në ndonjë pozitë tjetër të shërbimit civil dhe/ose nëse refuzojnë, atëherë eventualisht mund edhe të lirohen nga detyra. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës ngrisin argumentin e shkeljes së të drejtës ligjore të fituara dhe cenimin e pritshmërive legjitime në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, të mishëruar në nenin 7 të Kushtetutës dhe të elaboruar në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias. Kjo pasi të njëjtit procedurën e tyre të rekrutimit e kanë kryer shumë kohë më parë në bazë të ligjit të mëparshëm për shërbimin civil, i cili u siguron atyre mandat pa kufizim kohor, pra akt emërimi të përhershme.
335. Në këtë kontekst, Gjykata nënvizon se parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë edhe shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, respektivisht, të së drejtës në pronë, me arsyetimin se këta nëpunës civilë kanë një të drejtë të fituar që ndërlihet me nivelin e pagës së tyre dhe planifikimeve duke u bazuar në pagë, e cila konsiderohet një e drejtë pronësore e fituar gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amandamentimit të ligjeve ekzistuese, dhe në këtë rast të njëjtit thirren në një dispozitë të Kushtetutës së Sllovenisë, e cila ndalon efektin prapaveprues të akteve juridike sidomos kur ka të bëjë me cenimin e të drejtave të fituara. Parashtruesit e kërkesës tutje theksojnë se për shkak se nëpunësit civil kanë themeluar marrëdhënie pune, e cila rrezikohet, kjo përbën shkelje edhe të së drejtës në punë, të garantuar me

paragrafin 1 të nenit 49 të Kushtetutës. Gjykata nënvizon gjithashtu edhe komentet e Avokatit të Popullit, i cili sqaron se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare dhe se "*pritshmëria legjitime*" duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. I njëjti thekson se në rastin konkret, pritja legjitime e nëpunësve civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, bazohet në të drejtën e fituar nga dispozitat e Ligjit paraprak për Shërbimin Civil, gjatë periudhës sa ky ligj ka qenë në zbatim.

336. Në anën tjetër, Gjykata rithekson kundër-argumentet e Kryeministrit, i cili në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për humbjen e punës nga ana e nëpunësve civil të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë, ndër të tjera, thekson që nëpunësve civil aktual nuk do t'iu ndërpritet marrëdhënia e punës pa afat të caktuar, sipas aktit të emërimit sepse marrëdhënia e punës siç përcaktohet në secilin akt emërim buron nga statusi i të qenit nëpunës civil dhe jo me pozitën përkatëse në administratën publike dhe se e njëjta nuk mund të konsiderohet e drejtë e fituar. Në lidhje me këtë, Kryeministri thirret në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës, ku sipas tij, afirmohet e "*drejta e fituar*" për të garantuar përfitimin e benefiteve nga puna që kryhet në të ardhmen dhe se pritshmëritë legjitime trajtohen në rastet e posedimit, pasuritë dhe pronës ekzistuese, e ku pozita në shërbimin civil në asnjë rast nuk ndërlidhet me këto koncepte. Gjykata vëren se Kryeministri po ashtu thekson se nenet 99 dhe 67 të Ligjit të kontestuar respektojnë të drejtën e fituar, parashikueshmërinë dhe pritjet legjitime si elemente të sigurisë juridike, për faktin se edhe në rastet kur nëpunësi nuk rezulton kandidat i suksesshëm për pozitën e caktuar drejtuese, nëpunësit publik, për një periudhë të caktuar kohore (4 vite) i garantohet e drejta e pagës në përputhje me pozitën që ka gëzuar sipas ligjit paraprak.
337. Gjykata vëren se në thelb të njëjtat argumente si të Kryeministrit, i përsërit edhe grupi parlamentar i LVV-së në komentet e tij të 30 janarit 2023, i cili shton se shpallja e këtyre pozitave është reflektim i qëllimit të ligjvënësist që pozitat e ulëta dhe të mesme drejtuese të jenë pozita me afat të caktuar kohor, andaj, kjo duhet të kuptohet jo si kufizim por si zgjerim i mundësive.
338. Gjykata po ashtu rikujton edhe Opinionin ligjor të Zyrës së BE-së, të dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, në të cilin theksohet se asnjë administratë nuk i jep fund punësimit të një drejtuesi të njësisë me performancë të mirë vetëm sepse duhet që një mundësi t'i ofrohet kandidatëve të tjerë, potencialisht më të mirë, si dhe prezantimi i mandateve nuk do të adresojë asnjë nga problemet kyçe me të cilat përballet administrata e Kosovës, ndërsa do të krijojë jo-stabilitet dhe pasiguri. Në të njëjtën linjë, Gjykata vëren se edhe SIGMA në mendimin e saj ligjor i referohet organizimit të konkurseve për plotësimin e pozitave në fjalë si një periudhë pasigurie për të gjithë nëpunësit civilë në postet drejtuese, që është dëshmi e mosbesimit ndaj konkurseve të mëparshme (nevoja për t'u rikonfirmuar), dhe se kjo do të krijojë ngarkesë masive për institucionet përgjegjëse për konkurset e reja (më shumë që do të organizohen në të njëjtën kohë. Gjithashtu, SIGMA theksoi se ka shumë të ngjarë që numri i nëpunësve drejtues të mirë dhe me përvojë (të cilët thjesht nuk përzgjidhen në një konkurs) do të vendosen në listën e pritjes, veçanërisht pas valës së parë të konkurseve për nivelin e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese (të organizuara një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar) dhe në këtë kontekst, rekomandoi që në aspektin e pasojave të mos emërimit brenda nëntë muajve (lirimi) është me rëndësi të madhe që në ligj të vendoset llogaridhënie e qartë për listën e pritjes dhe mekanizma efektive për emërimin e këtyre nëpunësve civilë.

339. Lidhur me pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesë, Gjykata fillimisht do t'i trajtojë ato në kuadër të të drejtave të njeriut dhe kufizimit të mundshëm të tyre në kuadër të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, respektivisht nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht do elaborojë (i) parimet lidhur me kufizimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën në pronë dhe koncepti i “*pritjeve legjitime*” sipas Komisionit të Venecias dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe pastaj do të vlerësojë (ii) nëse ndaj kategorisë së shërbyesve civilë të përfshirë në nenin 99 Ligjit të kontestuar zbatohet e drejta në pronë; dhe nëse ky është rasti, kushtet që duhet plotësuar për të arsyetuar një kufizim të tillë.

*(b) Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimet themelore për të drejtën në pronë dhe koncepti i “pritjeve legjitime” sipas Komisionit të Venecias dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së*

340. Gjykata fillimisht vë theks në nenin 3 të Kushtetutës, sipas të cilit, (i) Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore; dhe (ii) ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Më tej, Gjykata gjithashtu vë theks, në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit, ndër të tjera, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

341. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, duke u referuar edhe në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, Gjykata vë theks në parimin e sigurisë juridike dhe rëndësinë e tij thelbësore për sundimin e ligjit. Ky parim, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, ngërthen në vetvete edhe (i) parimin e pritjeve legjitimeve; dhe (ii) jo-retroaktivitetit. Sa i përket të parës, Komisioni i Venecias, ndër të tjera, shpreh idenë se autoritetet publike nuk duhet të respektojnë vetëm ligjin, por edhe premtimet dhe pritshmëritë e tyre të ngritura. Sipas doktrinës së pritjes legjitime, ata që veprojnë me mirëbesim në bazë të ligjit aktual nuk duhet të zhgënjehen për pritjet e tyre legjitime. Megjithatë, situatat e reja mund të justifikojnë ndryshimet legjislative që zhgënjëjnë pritjet legjitime në raste të jashtëzakonshme. Kjo doktrinë zbatohet jo vetëm për legjislacionin, por edhe për vendimet individuale të autoriteteve publike. Ndërsa sa i përket të dytës, sipas Komisionit të Venecias, njerëzit duhet të informohen paraprakisht për pasojat e sjelljes së tyre. Kjo nënkupton parashikueshmëri dhe mosretroaktivitet veçanërisht në kuptim të legjislacionit penal. Në të drejtën civile dhe administrative, retroaktiviteti mund të ndikojë negativisht në të drejtat dhe interesat ligjore. Megjithatë, jashtë fushës penale, një kufizim prapaveprues i të drejtave të individëve ose vendosja e detyrave të reja mund të lejohet, por vetëm nëse është në interes të publikut dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit (përfshirë edhe atë kohor) (shih, Listën e Kontrolluesve të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, [CDL-AD \(2016\)007-e](#), cituar më lart, paragrafët 61-62).

342. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vë theks në nenet 21, 22 dhe 53 të Kushtetutës, bazuar në të cilat dhe ndër të tjera, (i) të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës dhe se kjo e fundit, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë; (ii) të drejtat dhe liritë e

njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, përfshirë KEDNJ-në, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike; dhe (iii) të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

343. Gjykata gjithashtu u referohet edhe dy të drejtave kushtetuese, përkatësisht atyre të përcaktuara në nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, respektivisht, lidhur me të drejtën në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, dhe të cilat ndër të tjera, përcaktojnë që (i) secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj; dhe (ii) çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton edhe parimin 3 në kuadër të Parimeve të Përgjithshme të OECD/SIGMA-s për Administratën Publike, ku në paragrafin e saj të 7, saktëson se: “Nëpunësit publikë kanë të drejtën e ankesës kundër uljes në detyrë dhe lirimit nga detyra në mënyrë të padrejtë.”

344. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

*“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

*2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*

*3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*

*4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*

*5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.”*

345. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata thekson se testi i nenit 55 të Kushtetutës, përcakton se kufizimi i një të drejte ose lirie: (i) mund të bëhet vetëm me “ligj”; (ii) duhet të ketë një “qëllim legjitim”; (iii) duhet të jetë i “domosdoshëm dhe proporcional”; dhe (iv) duhet të jetë “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”. Për qëllime interpretative të këtyre nocioneve dhe koncepteve, Gjykata thirret në faktin që edhe GJEDNJ përdorë të tilla teste për të vendosur se në një rast konkret a ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me KEDNJ (shih rastin [KO54/20](#), parashtrues, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 198; shih, *mutatis mutandis*, po ashtu rastin e Gjykatës [KO93/21](#) parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021, paragrafët 287-299). Të gjitha këto kritere duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që një kufizim të arsyetohet.

346. Gjykata në vijim thekson që koncepti i “*prijtjeve legjitime*” është gjithashtu i ngërthyer në të drejtat e fituara, përfshirë edhe të drejtën në pronë. Kjo e fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të

KEDNJ-së, përcakton konceptin e “pasurisë” dhe “pritjeve legjitimeve”. E para në parim, përfshinë si “pasuritë ekzistuese” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri legjitime”. Ndërsa e dyta, në parim, ngërthen në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për fitimin e një prone që mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së: [Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), nr. 17849/91, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31; [Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke](#) [GC], nr. 39794/98, Vendim për pranueshmërinë i 10 korrikut 2002, paragrafi 73). Që një “pritje” të jetë “legjitime”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor si vendimi gjyqësor, që ka të bëjë me interesin pasuror në fjalë ([Kopecký kundër Sllovakisë](#) [GC], nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafët 49-50; [Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë](#) [GC], nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi 173; [Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#), 18768/05, Aktgjykim i 13 janarit 2015, paragrafi 103; [Ceni kundër Italisë](#), 25376/06, Aktgjykim i 16 dhjetorit 2014, paragrafi 39; [Bélané Nagy kundër Hungarisë](#) [GC], nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 75).

347. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, “të hyrat e ardhshme” dhe “pensionet dhe përfitimet sociale” gjithashtu gëzojnë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në kushtet dhe parimet e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, këto të drejta nuk janë absolute, megjithatë kufizimi i tyre duhet të plotësojë disa kushte. Testi i përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është kompatibil me nenin 55 të Kushtetutës dhe i cili gjithashtu përcakton kriteret përkatëse bazuar në të cilat të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përfshirë të drejtën në pronë të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, mund të kufizohen, përkatësisht në rrethanat në të cilat ndërhyrja/kufizimi i të drejtave përkatëse është (i) “përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional” në raport me qëllimin legjitim të ndjekur.

(c) Vlerësimi i Gjykatës

348. Në adresimin e këtij pretendimi, fillimisht i referohet paragrafëve 2, 4, 5 dhe 6 të nenit 99 [Dispozitat kalimtare] të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton që:

*“1. Nëpunësja/i civil në marrëdhënie pune ë shërbimin civil, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësveve civil sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës/ës civil sipas nenit 2, paragrafi 3. të këtij ligji, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

*2. Më së voni një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të gjitha pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të shpallet procedura e rekrutimit sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik, përjashtimisht për pozitën të cilat kanë qenë të lira dhe janë plotësuar gjatë fazës transitore të rekrutimit sipas nenit 98 të këtij ligji.[...]*

*4. Nëse zyrtarja/i publik si në paragrafin 3. të këtij neni, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit nuk shpallet fitues për emërim në pozitën përkatëse apo nuk ka konkurrar fare, ajo/ai do të sistemohet në kategorinë profesionale, me kusht që plotëson kriteret për emërim në pozitën në fjalë.*

*5. Zyrtarja/i publik si në paragrafin 4. të këtij neni, do të përfitojë kompensim që është i barabartë me diferencën ndërmjet pagës bazë të pozitës drejtuese që ka ushtruar dhe pagës së kategorisë profesionale ku sistemohet, në:*



- 5.1. 100% të diferencës në pagë, gjatë vitit të parë pas sistemimit në kategorinë profesionale;
- 5.2. 75 % të diferencës në pagë, gjatë vitit të dytë pas sistemimit në kategorinë profesionale;
- 5.3. 50% të diferencës në pagë, gjatë vitit të tretë pas sistemimit në kategorinë profesionale;
- 5.4. 25 % të diferencës në pagë, gjatë vitit të katërt pas sistemimit në kategorinë profesionale.
6. Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, sipas paragrafit 5. të këtij neni, nëpunësja/i civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e kategorisë profesionale, përbën shkak për lirimin e nëpunësës/it nga shërbimi civil
7. Të drejtat nga paragrafët 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni vlejnjë vetëm një herë, për periudhën dhe rrethanat e përcaktuara sipas këtyre paragrafëve.  
[...]"

349. Gjykata rikujton po ashtu nenin 67 (Lista e pritjes) të Ligjit të kontestuar që përcakton si në vijim:

- “1. Nëpunëset/it civil që pas shuarjes apo ristrukturimit të institucionit nuk janë transferuar sipas nenit 66 apo rasteve të tjera të parapara me ligj nuk mund të sistemohen, do të vendosen në listën e pritjes.
2. Ministria përgjegjëse për administratë publike, kujdeset për sistemimin e nëpunësëve/ve civil në pritje në kategori të njëjtë të shërbimit civil, si dhe trajnimin për pozitën përkatëse ku sistemohet.
3. Refuzimi për t'iu nënshtruar trajnimit, sipas pikës 2. të këtij neni, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.
4. Nëse brenda afatit prej nëntë (9) muajsh nëpunësja/i civil nuk ricaktohet në ndonjë pozitë të lirë të shërbimit civil, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.
5. Të drejtat dhe detyrimet sipas këtij neni vlejnjë për aq kohe sa nëpunësja/i civil në listën e pritjes nuk ka marrëdhënie tjetër pune.
6. Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësëve/ve civil në pritje, duke përfshirë pagat dhe trajnimin e tyre, përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për Financa.”

350. Gjykata rikujton që, bazuar në paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar, të gjithë nëpunësve aktual civilë në pozitat e nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët do t'u shpallen procedurat e rekrutimit për pozitat e tyre sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik, përveç pozitave që kanë qenë të lira. Ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni, të gjithë ata zyrtarë publikë nga kjo kategori të cilët nuk rifitojnë pozitat e tyre apo nuk konkurrojnë fare, të njëjtit sistemohen në kategorinë profesionale për aq sa i plotësojnë kushtet për emërim, dhe derisa kjo të ndodhë të njëjtit vendosen në listën e pritjes dhe gëzojnë të drejtat në përputhje me nenin 67 të Ligjit të kontestuar, duke përfshirë mundësinë e lirimit nga shërbimi civil, nëse brenda nëntë (9) muajsh nuk ricaktohen në pozita profesionale ose refuzojnë ri-caktimin në të njëjtat. Gjykata po ashtu nënvizon se ligjvënësi ka vendosur që kësaj kategorie, përkatësisht atyre që emërohen në pozita profesionale pas përfundimit/mospërzgjedhjes në pozitën përkatëse drejtuese të nivelit të ulët ose të mesëm, t'iu sigurojë kompensim të barabartë me diferencën e pagës bazë të pozitës drejtuese që e ka ushtruar dhe pagës së kategorisë profesionale ku sistemohen, me një formulë të tillë që gjatë (i) vitit të parë përfitojnë 100% (njëqind përqind) të diferencës në pagë; (ii) vitit të dytë përfitojnë 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind); (iii) vitit të tretë përfitojnë 50% (pesëdhjetë përqind); si dhe (iv) vitin e katërt përfitojnë 25% (njëzet e pesë përqind) të saj. Thënë këtë, Gjykata rikujton që për kategorinë e nëpunësve të cilët nuk sistemohen në pozita profesionale por vendosen të

listën e pritjes të përcaktuar sipas nenit 67 të Ligjit të kontestuar, ky i fundit, nuk ka përcaktuar asnjë të drejtë në nivel ligji, duke e deleguar përcaktimin e të drejtave, përfshirë nivelin e pagës, në akte nënligjore, përpos mundësisë për të refuzuar sistemimin në kategori profesionale, por e cila rezulton në lirim nga shërbimi civil, pa të drejtën në mjet juridik.

351. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nëpunësit civil aktual të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë, të cilët kanë akt-emërime të përhershme bazuar në legjislacionin aktual apo paraprak për zyrtarët publikë, respektivisht shërbimin civil, kanë një të drejtë të fituar që ndërlidhet me “*të hyrat e ardhshme*” dhe “*pensionet dhe përfitimet sociale*”, përfshirë nivelin e pagës së tyre dhe planifikimeve përkatëse duke u bazuar në të drejtat përkatëse të fituara, dhe të cilat, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i kualifikon si të drejta pronësore. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës ngritin çështjen e të parimit “*të drejtave të fituara*”, ku referojnë në praktikën e Tribunalit Administrativ të ONP-së, e cila thekson se “[...] ndryshimi i një rregulli në dëm të një zyrtari dhe pa pëlqimin e tij përbën shkelje të një të drejte të fituar ku struktura e kontratës së emërimit është ndryshuar ose ka dëmtim të ndonjë afati themelor të emërimit në konsideratë të të cilit zyrtari e ka pranuar emërimin”, si dhe pretendojnë se nëpunësit civilë të lartcekur kanë “*pritshmëri legjitime*”, që i kanë ndërtuar në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë, bazuar në “*premtimin*” që shteti u ka dhënë atyre me ligjet që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të atyre të drejtave ligjore.
352. Për të adresuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse “*të drejtat e fituara*”, përfshirë (i) “*diferencën në pagë*” për nëpunësit civilë që sistemohen në kategorinë profesionale; apo (ii) “*pagën*” për nëpunësit civil që nuk sistemohen në asnjë pozitë dhe/ose lirohen nga shërbimi civil, përbëjnë “*pronë*” brenda kuptimit të këtyre dispozitave.
353. Gjykata rikujton edhe njëherë praktikën e GJEDNJ-së sa i përket konceptit të “*pasurisë*” i cili bën pjesë në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe i cili është një koncept autonom, që përfshin si “*pasuritë ekzistuese*” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “*pritshmëri legjitime*”. “*Pasuritë*” sipas këtij koncepti përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”, siç është pasuria e paluajtshme, e luajtshme dhe interesat e tjera pronësore (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI189/19](#), me parashtrues *Alban Miftaraj*, cituar më lart, paragrafi 81). GJEDNJ po ashtu thekson se parimet që zbatohen përgjithësisht në rastet sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë po aq të rëndësishme kur bëhet fjalë për pagat dhe përfitimet sociale (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, [Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë](#), nr. 66365/09, Vendim lidhur me pranueshmërinë i 15 tetorit 2013, paragrafi 91, dhe [Stummer kundër Austrisë](#), nr.37452/02, Aktgjykim i 7 korrikut 2011, paragrafi 82).
354. Në këtë kontekst, Gjykata ripërsërit, se në krahasim me ligjin aktual, ndryshimi që sjellë Ligji i kontestuar (i) ka pasojën e humbjes së një të drejtë të fituar, përkatësisht ushtrimin e një funksioni publik në kohë të pacaktuar apo edhe humbjen e marrëdhënies së punës në tërësi, si rezultat i ndryshimit të ligjit; dhe (ii) ka pasojën e zvogëlimin të pagës për nëpunësit civil të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë, të cilët aktualisht kanë akt-emërime me mandat të pacaktuar, por që pas 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e Ligjit të kontestuar kur shpallen konkurset publike për këto pozita, të njëjtit mund të mos rizgjedhen në pozitat e tyre apo edhe mund të lirohen nga shërbimi civil nëse nuk mund të sistemohen në pozita profesionale.

355. Gjykata, thekson se të drejtat e fituara e nëpunësve civil të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë burojnë nga kontratat përkatëse me administratën e shtetit, përkatësisht akt-emërimet me afat të pacaktuar bazuar në Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që *“pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”* e që në rastin konkret, nëpunësit civil të kategorisë së lartcekur kanë pritje legjitime për realizimin e të drejtave të fituara sipas pozitës që e kanë fituar me kontrata me afat të pacaktuar bazuar në legjislacionin në fuqi. Për më tepër, bazuar në ligjin mbi të cilin janë emëruar në pozitat përkatëse, kushtet mbi bazën e të cilave të drejtat e fituara do të mund të jenë kufizuara, janë qartësisht të përcaktuara, përkatësisht në nenet: 59 (Përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil), 60 (Përfundimi në rastet e përcaktuara nga ligji), 61 (Lirimi nga Shërbimi Civil), 62 (Dorëheqja), dhe 63 (Pensionimi i parakohshëm) të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Ligji i kontestuar, përcakton tashmë një rrethanë të re përmes nenit 99 të tij, dhe përmes të cilës, mund nëpunësit e lartcekur, mund t'i humbin të drejtat e fituara bazuar në ligjin paraprak.
356. Bazuar në sqarimet e dhëna dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se të drejtat e fituara, përfshirë *“të hyrat e ardhshme”* por edhe *“përfitimet sociale/pensionet”* e nëpunësve civilë në pozita drejtuese të ulëta dhe të mesme me akt-emërimet me afat të pacaktuar, në rastet kur të njëjtit ri-caktohen apo lirohen tërësisht nga shërbimi civil, përbëjnë *“pasuri”* dhe ngërthejnë në vetvete *“pritje legjitime”* në kuptim të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 46 të Kushtetutës.
357. Për të shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-se, duke pasur parasysh konstatimin e lartcekur të Gjykatës se *“të hyrat e ardhshme”*, përfshirë diferencën në pagë apo edhe humbjen e të njëjtës, në kushte të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara në momentin e fitimit të këtyre të drejtave dhe as nuk janë të saktësuara në kontratat/akt-emërimet e tyre, përbëjnë *“pasuri”* në kuptim të këtyre neneve, e njëjta duhet të zbatohet testin e përcaktuar tek parimet e përgjithshme, që përbëhet prej katër (4) hapave dhe respektivisht duhet të përcaktojë: (1) nëse ka pasur ndërhyrje/kufizime në gëzimin paqësor të pronës dhe nëse ky është rasti, më tej të përcaktojë (2) nëse ndërhyrja/kufizimi përkatës në gëzimin paqësor të pronës është i *“përcaktuar me ligj”*; (3) nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës ka pasur një *“qëllim legjitim”*; dhe (4) nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës është *“proporcionale”*.
- (1) Nëse ka pasur ndërhyrje/kufizime në gëzimin paqësor të pronës;*
358. Siç u theksua më lart, Gjykata vëren se nëpunësit civilë aktual të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë kanë akt-emërimet e tyre të përhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë, mbi bazën e të cilit i kanë fituar këto të drejta. Gjykata rikujton që rrethanat mbi bazën e të cilave të drejtat e fituara do të mund të ishin kufizuar janë qartësisht të përcaktuara në Ligjin aktual për Zyrtarët Publikë. Neni 99 i Ligjit të kontestuar është rrethanë e re dhe e paparashikueshme, mbi bazën e të cilit, nëpunësit përkatës, mund t'i humbin të drejtat e fituara bazuar në Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë.
359. Për më tepër dhe më tej, Gjykata vlerëson që nuk është kontestuese që neni 99 i Ligjit të kontestuar, mund të rezultojë në (i) humbjen e të drejtave të fituara të nëpunësve përkatës civilë; (ii) zvogëlimin e pagës për nëpunësit civilë të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë në nivelin e pagës së kategorisë profesionale, të cilët nëpunës civilë aktualisht kanë akt-emërimet me mandat të pacaktuar por që pas reformës, mund të mos rizgjedhen në pozitat paraprake; ose (iii) mund të humbin statusin e nëpunësit civil nëse nuk sistemohen në pozita të kategorisë profesionale sipas saktësimeve në nenin 67 të Ligjit të kontestuar. Për pasojë, Gjykata konstaton që neni 99 i Ligjit të kontestuar,

“ndërhynë” në gëzimin paqësor të të drejtave pronësore, përkatësisht në të drejtat e fituara të nëpunësve civilë aktual të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë në bazë të një ligji paraprak, përkatësisht Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publik.

360. Gjykata në këtë kontekst, rikujton rastin e GJEDNJ-së, *Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë*, ku në vitin 2010 Greqia uli pensionet dhe pagat e sektorit publik me efekt prapaveprues me përqindje që variojnë nga 12% (dymbëdhjetë përqind) në 30% (tridhjetë përqind), duke i ulur më tej ato më vonë atë vit me një shtesë prej 8% (tetë përqind), dhe reduktoi shtesat për pushime dhe Krishtlindje për punonjësit e sektorit publik që përfitonin të ardhura më të larta. Në këtë rast, GJEDNJ, ndër të tjera, vlerësoi se “[...] kufizimet e vendosura nga legjislati i kundërshtuar nuk duhet të konsiderohen si një "privim i pasurisë" siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës, por më tepër si ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të pronave për qëllimet e fjalisë së parë të paragrafit 2 të nenit 1 të Protokollit Nr. 1. (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë](#), nr. 57665/12 dhe nr. 57657/12, Aktvendim për pranueshmërinë i 7 majit 2013, paragrafi 34).

361. Duke qenë se Gjykata vlerëson që nenin 99 i Ligjit të kontestuar përbën “ndërhyrje/kufizim” në gëzimin paqësor të pronës, përkatësisht të të drejtave të fituara të kategorisë së lartcekur të nëpunësve civilë, në vijim dhe bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse “ndërhyrja/kufizimi” i tillë është (i) i “përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional”

(2) Nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës është “përcaktuar me ligj”;

362. Gjykata rikujton që neni 99 i Ligjit të kontestuar, ndër të tjera, parasheh që: “Më së voni një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të shpallet procedura e rekrutimit sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik [...]”, të cilët nëpunës civilë zgjedhën për mandat me kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve me mundësi vazhdimi edhe për 1 (një) mandat me kohëzgjatje të njëjtë në pajtim me nenin 46 të Ligjit të kontestuar. Gjykata i referohet edhe paragrafit 4 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se nëpunësit civilë që nuk rizgjedhen në pozitën e tyre apo nuk kanë konkurruar fare, sistemohen në kategorinë profesionale ose nëse nuk sistemohen në pozita të kategorisë profesionale, mund të lirohen nga shërbimi civil. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se të drejtat e fituara të të njëjtëve përmes një ligji paraprak, përmes Ligjit të kontestuar pësojnë kufizim të të drejtave të fituara, përfshirë (i) zvogëlim të pagës “ex-lege” me humbjen e pozitës drejtuese; apo edhe (ii) humbje në tërësi të së drejtës në marrëdhënien e punës në rast të mos-sistemimit në kategori profesionale, përfshirë në të gjitha rastet kur nëpunësit përkatës refuzojnë caktimin përkatës në pozitën profesionale dhe/ose vendosjen në listën e pritjes.

363. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se “ndërhyrja” në gëzimin paqësor të së drejtës në pronë, gjegjësisht të “të hyrave të ardhshme” të nëpunësve civilë të lartcekur, është ‘i paraparë me ligj’, përkatësisht me nenin 99 të Ligjit të kontestuar. Gjykata, edhe një herë thekson, që të drejtat e fituara dhe/ose ato pronësore, nuk janë absolute dhe mund t’i nënshtrohen kufizimeve dhe ndërhyrjeve dhe të mos rezultojnë në shkelje të të drejtave kushtetuese dhe/ose atyre të përcaktuara me KEDNJ-së. Thënë këtë dhe siç është sqaruar më lart, në mënyrë që “ndërhyrjet/kufizimet” e të drejtave, përfshirë të drejtave të fituara të jenë të pajtueshme me garancitë kushtetuese, të njëjtat përpos “përcaktueshmërisë me ligj”, duhet të ndjekin edhe një “qëllim legjitim” dhe të jenë “proporcionale”. Për pasojë, Gjykata më tej do të vazhdojë me vlerësimin e “qëllimit të ndjekur legjitim” dhe “proporcionalitetit” përkatës.

(3) Nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës ka pasur një “qëllim legjitim (interesi i përgjithshëm)”;

364. Lista e qëllimeve për të cilat “ndërhyrja/kufizimi” në të drejtat individuale do të binte në sferën e konceptit të interesit publik, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është e gjerë dhe mund të përfshijë qëllime të ndryshme që i nënshtrohen konsideratave të politikës publike në kontekste të ndryshme faktike. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe ndër të tjera, vendimi për të miratuar një ligj, sipas të cilit konfiskohet prona ose kompensimi nga sigurimi social, zakonisht përfshin shqyrtimin e çështjeve politike, shoqërore dhe sociale (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë](#), të cituar më lart, paragrafi 87; [Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë](#), të cituar më lart, paragrafi 106 dhe rastin e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “Co Colina”, Aktgjykim i 13 marsit 2023, paragrafi 203). Në këtë kontekst, Gjykata thekson rastin e GJEDNJ-së, [Mihăieș kundër Rumanisë](#), ku GJEDNJ vendosi që ligjvënësi në Rumani kur zvogëloi pagat e nëpunësve civilë për 25% (njëzet e pesë përqind) për një periudhë gjashtëmujore përmes një ligji, po ndiqte një qëllim të interesit publik, përkatësisht ruajtjen e balancit të buxhetit në mes shpenzimeve dhe të hyrat publike të shtetit, i cili u përball me një situatë mbarë botërore të krizë ekonomike (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Mihăieș kundër Rumanisë](#), nr. 44232/11 dhe 44605/11, Vendim për pranueshmërinë, i 6 dhjetorit 2011, paragrafi 18).
365. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rithekson komentet e Kryeministrit si përfaqësues i Qeverisë, e cila ka qenë hartuese e Ligjit të kontestuar, me ç’rast i njëjti, ndër të tjera, konsideron se: (i) “[...] *interesi i përgjithshëm publik i përcaktuar nga autoriteti publik në këtë rast përfshin por pa u kufizuar në krijimin e një administrate efikase, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe mbi bazën e meritokracisë për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve si e mirë e përbashkët e të gjithë shoqërisë*” si dhe që (ii): “*një aspekt tjetër thelbësor i interesit publik është hapja e mundësisë për përfshirjen e grave, komuniteteve jo shumicë dhe personave me aftësi të kufizuara në pozita drejtuese të mesme dhe të ulëta të shërbimit civil siç mundëson përmbajtja e ligjit të kontestuar*” për shkak se sipas tij ky përfaqësim aktualisht është ende i ulët.
366. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se reformimi i administratës publike paraqet një synim legjitim të shtetit në interes publik me qëllim të krijimit të një administrate efikase, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe mbi bazën e meritokracisë për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve të Republikës. Një qëllim i tillë është edhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përfshirë MSA-në. Gjykata rikujton se autoritetet shtetërore gëzojnë një marginë të gjerë të vlerësimit si në drejtim të zgjedhjes së mjeteve zbatuese, ashtu edhe në aspektin e konstatimit nëse pasojat e zbatimit justifikohen me interesin e përgjithshëm për të arritur qëllimin e ligjit të caktuar (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#), të cituar më lart, paragrafi 112, dhe rastin e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “Co Colina”, cituar më lart, paragrafi 209).
367. Siç është theksuar më lart, nëse një politikë publike e saktësuar përmes ligjit të miratuar në Kuvend është e duhura ose jo, është çështje e autoriteteve tjera publike dhe jo e Gjykatës, për aq sa, e njëjta nuk cenon dispozitat e Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson që “ndërhyrja” në të drejtat e fituara të nëpunësve civil të nivelit të ulët dhe të lartë drejtues, ndjek një “qëllim legjitim”. Andaj, në vazhdim Gjykata do të vlerësojë nëse masat e ndërmarra janë “proporcionale” në raport me qëllimin që synohet të arrihet, që është edhe hapi i fundit për të vlerësuar nëse “ndërhyrja/kufizimi” i të drejtave dhe lirive themelore mund të mos rezultojë edhe në cenimin e të njëjtave.

(4) Nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës ishte “proporcional”;

368. Për të qenë në pajtim me rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, “ndërhyrja” në të drejtën e gëzimit paqësor të “pronës”, përveç që duhet të jetë e “përcaktuar me ligj” dhe të ndjek një “qëllim legjitim”, duhet të rezultojë me “ekuilibër të drejtë” mes kërkesave të interesit publik dhe detyrimeve për të mbrojtur të drejtat themelore të individit (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, [Beyeler kundër Italisë](#) të cituar më lart, paragrafi 107; [Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), të cituar më lart, paragrafi 108 dhe rastin e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “Co Colina”, cituar më lart, paragrafi 211).
369. Më saktësisht, në rastet që përfshihen shkelje të pretenduara të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të vlerësojë nëse për arsye të veprimit apo mosveprimit të shtetit, individi bartë një barrë joproporcionale dhe të tepërt. Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë kërkesë, Gjykata, bazuar në praktikën lartcekur, duhet të bëjë një shqyrtim të gjithmbarshëm “të interesave të ndryshme në këtë çështje”, duke pasur parasysh se KEDNJ ka për qëllim të mbrojë të drejtat të cilat janë “praktike dhe efektive” dhe jo “iluzore”. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria - qoftë legjislative, administrative apo që lind nga praktikat e aplikuara nga autoritetet publike - është faktor që merret parasysh gjatë vlerësimit të veprimeve të një shteti (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Broniowski kundër Polonisë](#), të cituar më lart, paragrafi 151 dhe rastin e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “Co Colina”, cituar më lart, paragrafi 212).
370. Qëllimi i testit të proporcionalitetit është të vërtetojë së pari si dhe deri në ç’masë i është kufizuar individit, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, nëpunësve civilë të nivelit drejtues të mesëm dhe të ultë, ushtrimi i të drejtave të afektuara nga “ndërhyrja” në gëzimin e tyre paqësor të pronës dhe cilat janë pasojat negative të kufizimit të imponuar mbi ushtrimin e të drejtës të njëjtëve. Pas kësaj, ky ndikim krahasohet me rëndësinë e interesit publik, për shkak të të cilit ka ardhur deri te “ndërhyrja” përkatëse (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, [KI185/21](#), parashtrues SHPK “Co Colina”, cituar më lart, paragrafi 216).
371. Në rastin konkret, Gjykata nënvizon se paragrafi 2 i nenit 99 i Ligjit të kontestuar përcakton se të gjithë nëpunësve aktual civilë në pozitat e nivelit drejtues të mesëm dhe të ulët do t’u shpallen procedurat e rekrutimit për pozitat e tyre sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik, përveç pozitave që kanë qenë të lira dhe se ata të cilët nuk rifitojnë pozitat e tyre apo nuk konkurrojnë fare, sistemohen në kategorinë profesionale për aq sa i plotësojnë kushtet për emërim dhe derisa kjo të ndodhë vendosen në listën e pritjes dhe gëzojnë të drejtat në përputhje me nenin 67 të Ligjit të kontestuar, përfshirë mundësinë që të lirohen nga shërbimi civil në rast se nuk mund të sistemohen në pozita profesionale. Gjykata po ashtu nënvizon se ligjvënësi ka vendosur që kategorisë që sistemohet në pozita profesionale t’i sigurojë kompensim në raport me diferencën e pagës bazë të pozitës drejtuese që e ka ushtruar dhe pagës së kategorisë profesionale ku sistemohet, me një formulë që zvogëlohet proporcionalisht brenda një periudhe 4 (katër) vjeçare. Një e drejtë e tillë nuk është përcaktuar për nëpunësit përkatës dhe të cilët vendosen në listën e pritjes sipas nenit 67 të Ligjit të kontestuar.
372. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se bazuar në nenin 99 të Ligjit të kontestuar, të gjithë atë zyrtarë që afektohen nga shpallja e pozitave, mund të humbin pozitat aktuale sipas fuqisë së ligjit bazuar në një bazë ligjore e cila nuk ka ekzistuar kur ata kanë fituar të drejtën përkatëse sipas Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë.

373. Në këtë drejtim, Gjykata në vazhdim duhet të vlerësojë nëse qëllimi legjitim i reformës së administratës shtetërore, do të mund të arrihej edhe me mjete tjera, me barrë më të paktë dhe proporcionale në individin, përkatësisht të gjithë nëpunësit e administratës shtetërore dhe të cilët kanë fituar pozita të ulëta dhe të mesme drejtuese bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë.
374. Në këtë kontekst, fillimisht, Gjykata edhe një herë rikujton që asnjë nga Gjykatat Kushtetuese anëtare të Forumit të Venecias që kanë dorëzuar përgjigje në Gjykatë lidhur me Ligjin e kontestuar, nuk kanë ndërmarrë një reformë e cila ka shndërruar pozitat e karrierës me afat të pacaktuar në pozita me afat të caktuar, për më tepër, brenda një viti. Siç është sqaruar më lart, Austria është përjashtimi, por e cila e ka filluar reformën në vitin 1994 dhe e ka zbatuar gradualisht, duke u lënë nëpunësve civil përkatës mundësinë që të zgjedhin sistemin e karrierës apo pozitës dhe duke mos i afektuar të drejtat e tyre të fituara në mënyrë retroaktive. Për më tepër, përpos “*ndërhyrjes*” në gëzimin paqësor të pronës siç është sqaruar më lart, zbatimi i nenit 99 të Ligjit të kontestuar përkitazi me nëpunësit civil në pozita të drejtuese të nivelit të ulët dhe të mesëm bëhet edhe në përjashtim të të drejtës në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të përcaktuara përmes neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje edhe me nenin 13 (E drejta në mjet efektiv juridik) të KEDNJ-së, për faktin se të afektuarit nuk do të mund të përdorin një mjet juridik lidhur me shpalljen e konkursit të pozitave të tyre, ricaktimin në pozita profesionale dhe/ose lirim nga shërbimi civil. Këto të drejta përbëjnë ndër të drejtat më themelore të individëve, përfshirë në kontekst të parimit të qasjes në drejtësi, të përcaktuar përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta në gjykim të drejtë) të KEDNJ-së. Siç është cekur më lart, edhe OECD/SIGMA në parimet e saj për administratën publike, ua njeh specifikisht nëpunësve publikë të drejtën e ankesës kundër uljes në detyrë dhe lirim nga detyra në mënyrë të padrejtë (OECD/SIGMA, Parimet e Përgjithshme të Administratës Publike, cituar më lart, paragrafi 7 i parimit 3).
375. Në anën tjetër, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar, përcakton gjithashtu mekanizma të qartë mbi bazën e të cilave do të mund të arrihej qëllimi legjitim i ndërlidhur me interesin publik për një administratë shtetërore të bazuar në parimet e meritokracisë, profesionalizmit dhe gjithëpërfshirjes. Kjo sepse i njëjti, përcakton qartë edhe (i) çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë; (ii) rrethanat e pamjaftueshmërisë profesionale; si dhe (ii) çështjet disiplinore të shërbyesve civil. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se bazuar në paragrafin 1 të nenit 52 (Vlerësimi i rezultateve në punë) të Ligjit të kontestuar, “*Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësive të njësisë.*” Andaj, rezulton se nëpunësve civil në baza të rregullta u bëhet vlerësimi, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale. Të njëjtëve, sipas paragrafit 13 të nenit 52 të Ligjit të kontestuar, mund t’u jepet vlerësim: (i) arritje e jashtëzakonshme; (ii) tejkalon pritshmërisë; (iii) arrin pritshmëritë; (iv) ka nevojë për përmirësim; si dhe (v) e papranueshme. Në rast të këtyre dy të fundit, përcaktohet se mund të vendoset që të njëjtëve t’u bëhet vlerësim i veçantë, bazuar në paragrafin 15 të këtij neni.
376. Për më tepër, Ligji i kontestuar po ashtu përmban një nen të veçantë, përkatësisht nenin 54 (Pamjaftueshmëria profesionale) të Ligjit të kontestuar që përcakton procedurën për iniciimin dhe shqiptimin e masës për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe e cila mund të rezultojë në, mes tjerash, transferim në një pozitë tjetër, apo iniciim të procedurës në Komision Disiplinor, bazuar në nënparagrafët 3.2 dhe 3.3 të paragrafit 3 të po këtij neni.

377. Për më tepër, Ligji i kontestuar përmban Kapitullin IV (Ndryshimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil), ku përcaktohet edhe çështja e disiplinës në shërbimin civil. Në këtë kontekst, neni 57 (Masat disiplinore) përcakton masat për shkelje disiplinore përfshirë mospërbushjen e detyrave të punës, të cilat mund të rezultojnë në transferim, përkatësisht largim nga shërbimi civil. Gjithashtu, bazuar në nenin 74 (Lirimi nga Shërbimi Civil) të Ligjit të kontestuar, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, përfundon me lirim nga shërbimi civil, mes tjerash, pas dy (2) vlerësimeve “*e papranueshme*” të rezultateve të punës, dy (2) herë radhazi. Si herë e dytë radhazi, për nëpunësit civil konsiderohet edhe vlerësimi i veçantë i përcaktuar në paragrafin 15 të nenit 52 dhe nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 74 të Ligjit të kontestuar.
378. Andaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, Ligji i kontestuar, ka përcaktuar në mënyrë gjithëpërfshirëse edhe çështjen e (i) kryerjes së detyrave të punës; (ii) aftësisë profesionale për të kryer detyrat e punës; (iii) çështjen e vlerësimit të rezultateve të rregullt dhe të veçantë, ku përfshihen edhe aftësitë e punës; (iv) pasojat për shkak të shkeljeve disiplinore dhe vlerësimit të rezultateve të punës “*e papranueshme*” dhe të cilat mund të rezultojnë në transferim apo edhe largim nga shërbimi civil. Për më tepër, Ligji i kontestuar ka përcaktuar në mënyrë të detajuar edhe procedurat që duhet ndjekur dhe të drejtën në përdorimin e mjeteve juridike në rast të një procedurë e tillë iniciohet, duke iu siguruar të gjithë atyre që afektohen, të drejtën në mjet juridik si garanci kushtetuese.
379. Për dallim nga kjo, dhe siç është sqaruar më lart, neni 99 i Ligjit të kontestuar përcakton se brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e Ligjit të kontestuar, do të shpallet konkurs për pozitat e ulëta drejtuese dhe të mesme drejtuese, duke rezultuar në mundësinë e humbjes të pozitave të tyre të nëpunësve civilë në këto pozita me afat të pacaktuar, të cilat të njëjtit i kanë fituar dhe i gëzojnë bazuar në një ligj të miratuar nga Kuvendi, përkatësisht ligjin aktual për Zyrtarët Publik, në rast se nuk rizgjidhen dhe për më tepër, edhe në rast se rizgjidhen të njëjtit do të kenë pozita me afat të caktuar.
380. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se të njëjtat rezultate sikur në rastin konkret, përmes nenit 99 të Ligjit të kontestuar, do të mund të arrihet përmes procedurës së vlerësimit të rezultateve të punës, apo përmes procedurave disiplinore në rast të mos përbushjes së detyrave të punës, përkatësisht transferimit në një pozitë tjetër apo largimi nga shërbimi civil, sipas dispozitave specifike të përcaktuara në Ligjin e kontestuar. Për më tepër, mundësia e një reforme graduale të transferimit të pozitave me mandat të pacaktuar në mandat të caktuar, duke u mundësuar individëve përkatës të zgjedhin në mes mundësisht, siç tregon shembulli i Austrisë, do të mund të ishte një “*ndërhyrje*” më proporcionale në të drejtat e individëve, duke vendosur barrë të baraspeshuar në mes individit dhe shtetit.
381. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata konstaton që paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 i Ligjit të kontestuar, përmes të cilit, shpallen për konkurrencë të hapur të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike, duke afektuar të drejtat e fituara të të gjithë nëpunësve civil bazuar në ligje të Republikës së Kosovës përmes një ligji të ri që të njëjtit i afekton retroaktivisht, përbën “*ndërhyrje*” në të drejtat e tyre për pronë në kontekst të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Thënë këtë, dhe siç është sqaruar më lart, të drejtat e fituara nuk janë të drejta absolute dhe ato mund të kufizohen, nëse janë të “*përcaktuara me ligj*”, “*ndjekin një qëllim legjitim*” dhe janë “*proporcionale*” me qëllimin e ndjekur. Në rrethanat e paragrafëve 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar, Gjykata vlerëson që (i) “*ndërhyrja*” është e “*përcaktuar me ligj*”; dhe (ii) “*ndjek një qëllim legjitim*”, përkatësisht interesin publik të reformën e administratës shtetërore me theks në parimet e meritokracisë, profesionalizmit, efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes.



382. Thënë këtë, Gjykata, bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, vlerëson që zgjidhja e përcaktuar përmes nenit 99 të Ligjit të kontestuar nuk paraqet “*ekuilibër të drejtë*” mes qëllimit të deklaruar të interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore dhe rrjedhimisht nuk është “*proporcionale*”, ndër të tjera, sepse (i) “*qëllimi legjitim*” i njëjtë do të mund të arrihej përmes mekanizmave më pak kufizues/ndërhyrës në të drejtat dhe liritë themelore përmes zbatimit të dispozitave ekzistuese të Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë, përfshirë edhe dispozitat e detajuara të Ligjit të kontestuar e që ndërlidhen, ndër të tjera, me vlerësimin e performancës dhe/ose masat disiplinore, përfshirë në rast të mos përmbushjes së detyrave të punës; (ii) kategorisë ekzistuese të zyrtarëve të administratës shtetërore që mbajnë pozita të nivelit të ulët ose të mesëm drejtues, në kundërshtim me të drejtat kushtetuese për mjet juridik efektiv dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, respektivisht, u është mohuar në tërësi e drejta në ankesë për sa i përket sistemit në pozitën përkatëse profesionale, vendosjes në “*Listën e Pritjes*” ose lirimit nga shërbimi civil; dhe se (iii) bazuar në parimin e sigurisë juridike por edhe në përgjigjet e pranura nga gjykatat kushtetuese dhe/ose ekuivalentet përkatëse anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, rezultojnë që një reformë e tillë e administratës publike, ose nuk është ndërmarrë, ose nuk e ka kaluar testin e vlerësimit të kushtetutshmërisë, me përjashtim të sqarimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë, lidhur me reformën përkatëse e cila është zbatuar gradualisht dhe pa efekt ndaj zyrtarëve që kishin mandate/kontrata të përhershme, duke u mundësuar të njëjtëve që të zgjedhin vet në mes të sistemit të karrierës ose atij të pozitës, me beneficionet përkatëse nëse vullnetarisht pranojnë kalimin në sistem të pozitës në administratën publike.
383. Gjykata rikujton po ashtu se lidhur me ndërprerjen e parakohshme të mandatit të fituar përmes një ligji të ri të miratuar nga Kuvendi, megjithëse më specifik dhe në rrethana të tjera, Gjykata kishte gjetur shkelje edhe lidhur me shkurtimin e mandatit të një numri të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Aktgjykimit të saj në rastet KO100/22 dhe KO101/22. Në këtë rast, ndër të tjera, Gjykata kishte vlerësuar që neni 18 i Ligjit të kontestuar, përkatësisht i ligjit për ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial përmes së cilit plotësohej, përkatësisht shtohet neni 23/A i Ligjit bazik për Këshillin Prokurorial, nuk ishte në përputhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Kjo pasi ndërprerja e mandatit të një pjese të anëtarëve të Këshillit përmes shortit përkatës, në mungesë të plotë të mjetit juridik efektiv, cenonte sigurinë e mandateve të anëtarëve të Këshillit Prokurorial, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (shih rastet KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, ndër të tjera, paragrafi 403).
384. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 të Ligjit të kontestuar nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

#### **E. Përkitazi me të Drejtën për Mjet Juridik të Zyrtarëve Publik**

385. Gjykata në pjesë e mësipërme dhe në ndërlidhje me nenet e kontestuara ka sqaruar rëndësinë e të drejtës në mjet juridik të përcaktuar në nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNJ-së, të cilat garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës

- [KI48/18](#), parashtrues: *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 198 dhe KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 346). Po ashtu, në kontekst të parimeve të OECD/SIGMA-s për administratën publike, Gjykata rikujton se e drejta e ankesës kundër uljes në detyrë dhe lirimit nga detyra në mënyrë të padrejtë iu takon specifikisht edhe nëpunësve publikë (OECD/SIGMA, Parimet e Përgjithshme për Administratën Publike, cituar më lart, paragrafi 7 i parimit 3).
386. Për më tepër, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore duke i'u referuar asaj të GJEDNJ-së lidhur me të drejtë në mjet juridik në kontekst të së drejtës për “*qasje në Gjykatë*”, ndër të tjera, ka theksuar se: “[...] në mënyrë që shtetit të kërkojë para GJEDNJ-së përjashtimin e mbrojtjes së mishëruar nga neni 6 i KEDNJ-së, në lidhje me statusin e parashtruesit të kërkesës, si nëpunës civil, duhet përmbushur dy kushte. Së pari, shteti duhet të ketë përjashtuar shprehimisht të drejtën për qasje në gjykatë për postin ose kategorinë e stafit në fjalë, në legjislacionin e tij kombëtar. Së dyti, në interesin e shtetit, përjashtimi duhet të justifikohet mbi baza objektive. (Shih rastin e Gjykatës [KI214/21](#), parashtrues: *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafi 124)”.
387. Rrjedhimisht, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, siç u theksua më lart, e drejta në mjet juridik efektiv ndaj cilido akt të autoritetit publik që mund të ketë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit të përcaktuara me ligj dhe/ose Kushtetutë, në parim, nuk mund të kufizohet përveç nëse kufizimi është “i përcaktuar në ligj”, ka ndjekur “një qëllim legjitim” dhe masa e ndërmarrë ka qenë “proporcionale” me qëllimin që është synuar të realizohet (shih rastet e Gjykatës, KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 337; dhe [KI214/21](#), me parashtrues *Avni Kastrati*, cituar më lart, paragrafi 124).
388. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar përcakton të drejtë për mjet juridik për dy kategori: (i) nëpunësit civilë; dhe (ii) nëpunësit e shërbimit publik.
389. Më konkretisht, Gjykata vëren se neni 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) i Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me nenin 88 (E drejta për ankesë e nëpunësve/it të shërbimit publik) të tij, ndër të tjera, përcaktojnë se (i) nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, “në rastet e parapara sipas këtij ligji”; ndërsa (ii) shqyrtimi i ankesave të nëpunësve/it të shërbimit publik është në kompetencë të Inspektoratit të Punës. Gjykata konsideron se dispozitat në fjalë ngritin çështje serioze kushtetuese në kontekst të të drejtave kushtetuese të lartcekura.
- (i) *Lidhur me nëpunësit civilë*
390. Së pari dhe në kontekst të nëpunësve civilë, neni 27 i Ligjit të kontestuar ka përcaktuar të drejtën e nëpunësit civil për të paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe më pas në gjykatën kompetente. Këto të drejta, sa i përket ankesës para Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, janë kushtëzuar vetëm “në rastet e parapara sipas këtij ligji”.
391. Lidhur me këtë, vet Ligji i kontestuar i referohet të drejtës në ankesë në një numër të kufizuar rastesh, siç është rasti me (i) paragrafin 12 të nenit 39 (Procedura e pranimit në Shërbim Civil); (ii) paragrafin 10 të nenit 44 (Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese); dhe (iii) nenin 59 (Procedura disiplinore), ndërsa duke përjashtuar, ndër të tjera, tërësisht ankesën sa i përket çështjeve që ndërlidhen me pozitën e mesme dhe të ulëta drejtuese që përcaktohen përmes nenit 67 dhe nenit 99 të Ligjit të kontestuar.

392. Në këtë kontekst, sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, për të përjashtuar të drejtën në mjet juridik, (i) duhet të argumentohet se ligji vendor përjashton në tërësi të drejtën për mjet juridik në llojin e caktuar të kontesteve; dhe për më tepër (ii) përjashtimi i tillë mbështetet në arsye objektive të interesit shtetëror (shih, rastin e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 381, dhe rastin e GJEDNJ-së, *Grzęda kundër Polonisë*, nr. 43572/18, Aktgjykim i 15 marsit 2022, paragrafi 290).
393. Megjithatë, në rastin konkret, paragrafi 3 i nenit 27 të Ligjit të kontestuar (i) ka përcaktuar të drejtën në ankesë të nëpunësve civil vetëm në rastet kur kjo parashihet sipas Ligjit të kontestuar, dhe për më tepër, (ii) Gjykata vëren se nga dosja e lëndës nuk rezulton të ketë një qëllim legjitim sipas së cilit do të arsyetohet dispozita e cila kufizon ankesat e shërbyesve civilë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës vetëm “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*”. Andaj, bazuar edhe në praktikën e lartcekur të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, përderisa neni 27 i Ligjit të kontestuar, në parim, i’u njeh të drejtën në ankesë nëpunësve civilë para Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, formulimi “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*”, kufizon të drejtën për mjet juridik, pa një justifikim të caktuar.
394. Rrjedhimisht, në këto rrethana, formulimi “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*” i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
- (ii) *Lidhur me nëpunësit e shërbimit publikë*
395. Së dyti, dhe në kontekst të të drejtës në ankesë të nëpunësve të shërbimit publik, bazuar në nenet 27 dhe 88 të Ligjit të kontestuar, është përcaktuar e drejta e nëpunësit të shërbimit publik për ankesë, përkatësisht mjet juridik, në Inspektoratin e Punës dhe më pas në gjykatën kompetente.
396. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se sipas paragrafit 1 të nenit 1 (Fushëveprimi i Inspektoratit të Punës) të Ligjit për Inspektoratin e Punës, nr. 2002/9, i ndryshuar dhe plotësuar përmes Ligjit Nr. 03/L-017 (më tutje: Ligji për Inspektoratin e Punës), Inspektorati i Punës mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lëminë e punës, duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientin e punës.
397. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se sipas nenit 2 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, funksionet e Inspektoratit të Punës janë: (i) mbikëqyrja efektive e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar nga marrëdhënia e punës, siguria dhe shëndeti në punë; (ii) ofrimi informatave dhe këshillave të natyrës teknike për të punësuarin dhe punëdhënësin; (iii) njoftimi i MPMS-së ose ndonjë organi tjetër kompetent për moszbatim apo mosrespektim të mundshëm të ligjit të aplikueshëm; (iv) identifikimi i mangësive që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese; si dhe (v) dhënia e informatave dhe këshillave të të punësuarve dhe punëdhënësve në raste të riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje (shih, rastin e Gjykatës, [KO27/21](#), parashtrues: *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafi, 98).
398. Gjykata po ashtu ka theksuar se funksionet, përkatësisht përgjegjësitë apo juridiksioni i Inspektoratit të Punës është përcaktuar në mënyrë specifike në Ligjin nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO27/21, Inspektorati i Punës ushtron funksionin e tij në kuadër të përgjegjësive që i janë dhënë nga ligjvënësi përmes Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Ajo çfarë

i është lejuar Inspektoratit të Punës me nenin 83 [Masat ndëshkuese] të Ligjit të Punës dhe nenin 25 [Gjobat] të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin, është mundësia e zbatimit të masave ndëshkuese (gjobave) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit, si dhe raportimi i këtyre parregullsive në MPMS ose tek ndonjë autoritetet tjetër kompetent (shih, rastin e Gjykatës, cituar më lart, paragrafi, 99).

399. Për më tepër, siç ka theksuar Gjykata në Aktgjykimin e lartcekur (i) Inspektorati i Punës, bazuar në ligjin për themelimin e tij, është autoritet ekzekutiv që themelohet nga Ministria përgjegjëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe rrjedhimisht, është pjesë përbërëse e pushtetit ekzekutiv; dhe (ii) në rendin juridik të Republikës së Kosovës, i cili bazohet në vlerat dhe parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, është pushteti gjyqësor dhe jo ai ekzekutiv, që ka kompetencën për të vendosur në lidhje me kontestet lidhur me të drejta dhe detyrime, përfshirë ato që burojnë nga marrëdhënia e punës (shih, rastin e Gjykatës, KO27/21, cituar më lart, paragrafi 95 dhe 106).
400. Duke ju rikthyer rastit konkret, Gjykata përsërit edhe njëherë se Ligji i kontestuar ka përcaktuar Inspektoratin e Punës si trupë ankimore për të gjithë nëpunësit e shërbimit publik në Republikën e Kosovës, para se të njëjtit t'i drejtohen gjykatave. Lidhur me këtë, duke qenë se Gjykata në rastin KO27/21 ka definuar qartë rolin dhe kompetencat e Inspektoratit të Punës në kontestet e punës bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës, të cilat nuk përfshijnë zgjidhjen e kontesteve të punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit por i cili ka kompetencë mbikëqyrëse në kuptim të (i) zbatimit të masave ndëshkuese (gjobave) në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e punëdhënësit; si dhe (ii) raportimit të këtyre parregullsive në ministrinë përkatëse ose te ndonjë autoritetet tjetër kompetent, mvëshja e të njëjtit me kompetencë për të vendosur lidhur me ankesën e nëpunësve të shërbimit publik, nuk përkon me natyrën e punës së këtij institucioni si trupë ekzekutive të cilin e themelon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe si e tillë nuk është në përputhje me të drejtën për mjet juridik dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.
401. Andaj, bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstaton se paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
402. Ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Aktgjykimi, dhe në mënyrë që të ketë qartësi dhe parashikueshmëri, dhe për pasojë, siguri juridike përkitazi me dispozitat e Ligjit të kontestuar, Kuvendi është i detyruar që të plotësojë dhe ndryshojë nenin 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe nenin 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, për të përcaktuar të drejtën në mjet juridik lidhur me nëpunësit e shërbimit publik, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim.

### **Kërkesa për Masën e Përkohshme dhe pezullimi i hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar**

403. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave kanë kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për të pezulluar hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Ligjit të kontestuar, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesat nga Gjykata.
404. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 (Afati) të Ligjit, përcakton efektin suspensiv të hyrjes në fuqi të ligjeve që kontestohen sipas paragrafit 5 të nenit

113 të Kushtetutës, duke theksuar se “[...] në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”. Bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata më 4 korrik 2022, kishte kërkuar nga Kryetari i Kuvendit, Presidentja dhe Sekretari i Kuvendit që të marrin parasysh kërkesat e paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit.

405. Andaj, duke marrë parasysh që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike pa nxjerrjen e vendimit nga Gjykata, si dhe në pajtim me nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO43/19, parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 113, dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 411).

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113 (5) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 2 gusht 2023:

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesat të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në kundërshtim me nenet 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË, njëzëri, se kriteri i “përshtatshmërisë” i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË, njëzëri, se formulimi “si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre” i pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË, njëzëri, se formulimi “në rastet e parapara sipas këtij ligji” i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- VI. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- VII. TË KONSTATOJË, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, se neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- VIII. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafi 6 i nenit 67 (Lista e pritjes) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IX. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- X. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafi 2 i nenit 104 (Shfuqizimi) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- XI. TË SHPALLË, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje:
- a. pa formulimin *“përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo”* në paragrafin 2 dhe *“përshtatshmëria dhe/apo”* në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik);
  - b. pa formulimin *“si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre”* të pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe pa paragrafin 2 të nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe pa nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 të paragrafit 1 dhe pa paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike);
  - c. pa formulimin *“në rastet e parapara sipas këtij ligji”* të paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës);
  - d. pa paragrafin 6 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe pa paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik);
  - e. pa paragrafin 6 të nenit 67 (Lista e pritjes);
  - f. pa paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare); dhe
  - g. pa paragrafin 2 të nenit 104 (Shfuqizimi).

- XII. TË URDHËROJË, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, Kuvendin e Republikës së Kosovës, që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme:
- për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim;
  - për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; dhe
  - për plotësimin dhe ndryshimin e nenit 6 (Nëpunësja/i civil me status të veçantë) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në raport me Agjencitë e Pavarura sipas nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim;
- XIII. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme;
- XIV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- XV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues



Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 tetor 2023  
Nr. ref.: UK 2288/23

Në pajtim me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me paragrafin 1.4 të nenit 11 (Kryetari dhe Zëvendës Kryetari) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 59 (Përmirësimi i vendimeve) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në lidhje me Aktgjykimin e publikuar në rastet KO216/22 dhe KO220/22 të 2 gushtit 2023, më 28 shtator 2023, nxjerr Urdhrin për korrigjim si në vijim:

## **URDHËR PËR KORRIGJIM**

### **të një gabimi teknik në Aktgjykimin në rastet KO216/22 dhe KO220/22, i 2 gushtit 2023 dhe i publikuar më 13 shtator 2023**

1. Më 21 shtator 2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), pranoi kërkesën për korrigjim të Aktgjykimit të saj në rastet KO216/22 dhe KO220/22, nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në rastin KO216/22. Në vijim, Gjykata do të paraqesë faktet dhe pretendimet që ndërlidhen me kërkesën për korrigjimin e Aktgjykimit të lartcekur.
2. Më 2 gusht 2023, Gjykata, i deklaroi kërkesat KO216/22 dhe KO220/22 të pranueshme dhe vendosi të konstatojë, që: (i) paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e Përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik); (ii) formulimi “*si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre*” i pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike); (iii) formulimi “*në rastet e parapara sipas këtij ligji*” i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës); (iv) paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik); (v) paragrafi 6 i nenit 67 (Lista e pritjes); (vi) paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare); dhe (vii) paragrafi 2 i nenit 104 (Shfuqizimi) i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri Kushtetutën, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin e publikuar.



3. Një ndër përcaktimet e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i vlerësuar si në kundërshtim me Kushtetutën, sipas Aktgjykimit të publikuar, është edhe kriteri i “përshtatshmërisë” për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik. Ky kriter është saktësuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Gjykata, përmes Aktgjykimit të publikuar, ka saktësuar që referenca e kriterit të “përshtatshmërisë” në të dy këta paragrafë të nenit 9 të ligjit të lartcekur, është në kundërshtim me Kushtetutën.
4. Gjykata, rikujton që paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar para Gjykatës kanë përcaktuar si në vijim:

#### **Neni 9**

#### **(Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik)**

“[...]

*2. Përjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohet përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo kritere specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kritereve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.*

[...]

*5. Përshtatshmëria dhe/apo kritere specifike shtesë për emërim në pozitë sipas këtij neni, për të punësuarat/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”*

5. Më saktësisht, Gjykata në (i) pikën III të Dispozitivit të Aktgjykimit, ka konstatuar, që “kriteri i “përshtatshmërisë” i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”; ndërsa (ii) në pikën XI të Dispozitivit të Aktgjykimit shpalli që Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i dërgohet Presidentes të Republikës së Kosovës për shpallje, mes tjerash, “a. pa formulimin “përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo” në paragrafin 2 dhe “përshtatshmëria dhe/apo” në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik)”.
6. Më 13 shtator 2023, Aktgjykimi në rastet KO216/22 dhe KO220/22, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare), si dhe në të njëjtën ditë, i është dorëzuar palëve, përfshirë parashtruesit e kërkesës.
7. Më 18 shtator 2023, Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është publikuar në Gazetën Zyrtare. Përderisa, (i) referenca në kriterin e “përshtatshmërisë” është eliminuar nga paragrafi 5 i nenit 9 të Ligjit të kontestuar; (ii) në paragrafin 2 të të njëjtit nen, ajo është eliminuar vetëm në fjalinë e parë të paragrafit 2 të nenit 9, por jo edhe në fjalinë e dytë të paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.
8. Gjykata, rikujton që paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare përmban si në vijim:

#### **Neni 9**

#### **(Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik)**

“[...]

2. Përjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohen kritere specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kritereve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

[...]

5. Kriteret specifike shtesë për emërim në pozitë sipas këtij neni, për të punësuarat/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.”

9. Më 21 shtator 2023, siç është cekur më lart, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në rastin KO216/22, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 59 (Përmirësimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës, parashtrroi kërkesë për korrigjim e Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO216/22 dhe KO220/22, ndër tjerash, me arsyetimin se pika XI (a) e Dispozitivit të saj “edhe pse e ka përfshirë përjashtimin nga shpallja të këtij kriteri [“përshtatshmërisë”] edhe në paragrafin 2 të nenit 9 [të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë], shpallja e tij [ligjit] është bërë duke e zbatuar këtë pikë të aktgjykimit vetëm në pjesën e parë të paragrafit 2 të këtij neni por jo edhe në pjesën e dytë të të njëjtit paragraf (2). Si rezultat, ligji i shpallur në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 9 [të ligjit] vazhdon të përmbajë kriterin e “përshtatshmërisë”, edhe përkundër vlerësimit jo kushtetues të tij.” Për pasojë, parashtruesi i kërkesës në rastin KO216/22, kërkojnë nga Gjykata që “[...] të plotësoj në aspektin teknik aktgjykimin, përkatësisht pikën (a) të dispozitivit XI dhe të mundësoj që përmes urdhrit për korrigjim të qartësohet përfundimisht se ky kriter (përshtatshmëria), në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë pjesë e përmbajtjes (tekstit) së Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik duke bërë që ky urdhër ti bashkëngjitet aktgjykimit dhe të publikohet krahas tij”.
10. Në kontekst të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari i referohet rregullit përkatës të Rregullores së të punës lidhur me mundësinë e korrigjimit/përmirësimit të vendimeve në kontekst të gabimeve të mundshme teknike dhe/ose numerike. Përmes të njëjtit, që nga themelimi i Gjykatës, janë lëshuar Urdhra për Korrigjim, me kërkesë të palës dhe/ose sipas detyrës zyrtare, në rastet në vijim: (i) [KI81/10](#), parashtrues Nazif Reka, Aktvendim për papranueshmëri i 15 shtatorit 2012; (ii) [KI122/17](#), parashtrues Česká Exportní Banka A.S., Aktgjykim i 18 prillit 2018; (iii) [KI35/19](#), parashtrues Ramiz Hajdini, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 qershorit 2019; (iv) [KI44/22](#), parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 shtatorit 2022; dhe (v) [KI179/22](#), parashtrues Blerim Leka, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2023. Më saktësisht, rregulli përkatës i Rregullores së punës së Gjykatës, përcakton si në vijim:

Rregulli 59  
(Përmirësimi i vendimeve)

“(1) Gjykata mund të korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik në vendime.  
(2) Korrigjimi i vendimeve mund të bëhet ex officio ose me kërkesën e palës, të paraqitur brenda dy (2) javësh nga dorëzimi i vendimit.  
(3) Urdhri për korrigjim i bashkëngjitet vendimit fillestar dhe publikohet.”

11. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata në vijim sqaron që përmes Aktgjykimit në rastet KO216/22 dhe KO220/22, është plotësisht e qartë që kriteri i “përshtatshmërisë” i përcaktuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe rrjedhimisht, si i tillë, nuk mund të jetë pjesë përbërëse e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Sqarime të detajuara në këtë kontekst janë dhënë në paragrafët 225-237 të Aktgjykimit në rastet KO216/22 dhe KO220/22.

12. Për më tepër, Dispozitivi i Aktgjykimit në rastet KO216/22 dhe KO220/22 gjithashtu saktësisht përcakton (i) në pikën III të tij, që *“kriteri i “përshtatshmërisë” i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*; dhe për pasojë, (ii) Ligji i kontestuar i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës sipas përcaktimeve në pikën XI (a) të tij, *“pa formulimin “përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo” në paragrafin 2 dhe “përshtatshmëria dhe/apo” në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik);”*.
13. Thënë këtë, Gjykata vëren që Ligji i shpallur në Gazetën Zyrtare, përkundër faktit që kriteri i *“përshtatshmërisë”* është shpallur në kundërshtim me Kushtetutën në tërësinë e tij, vazhdon të përmbajë këtë kriter në fjalinë e dytë të paragrafit 2 të nenit 9 të tij. Kjo për faktin që në pikën XI (a) të Dispozitivit të Aktgjykimit që ndërlidhet me kriterin e *“përshtatshmërisë”*, Gjykata i është referuar paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, por jo edhe të dy fjalive të këtij paragrafi veç e veç.
14. Në këtë kontekst, Gjykata thekson, që përderisa (i) në pikën III të Dispozitivit të Aktgjykimit të saj, është përcaktuar qartësisht që paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë janë në kundërshtim me dispozitat respektive të Kushtetutës; (ii) pika XI (a) e Dispozitivit të Aktgjykimit i referohet përmbajtjes së paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në tërësinë e tij, por kjo pikë nuk i referohet ndaras të dy fjalive të paragrafit të lartcekur. Duke marrë parasysh që mund të mos ketë qenë plotësisht e qartë për autoritetet respektive në Republikën e Kosovës, që referenca në paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, përmban të dy fjalitë e tij, Gjykata, bazuar në rregullin 59 (Përmirësimi i vendimeve) të Rregullores së punës, sqaron, përkatësisht korigjon Dispozitivin e Aktgjykimit në rastet KO216/22 dhe KO220/22, duke përcaktuar në pikën XI (a) të Dispozitivit të Aktgjykimit që Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë duhet të shpallet *“a. pa formulimin “përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo” në fjalinë e parë të paragrafit 2; “përshtatshmërisë dhe/apo të” në fjalinë e dytë të paragrafit 2, si dhe “përshtatshmëria dhe/apo” në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik);”*.
15. Andaj, marrë parasysh (i) kërkesën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës në rastin KO216/22; (ii) faktin se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është publikuar në Gazetën Zyrtare me formulimin e *“përshtatshmërisë dhe/apo të”* në fjalinë e dytë të paragrafit 2 të nenit 9 të tij; ndërsa (iii) që sipas pikës III të Dispozitivit të Aktgjykimit, kriteri i *“përshtatshmërisë”* është konstatuar nga Gjykata që nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, me qëllim të qartësisimit që referenca në paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në Dispozitivin e Aktgjykimit e publikuar të Gjykatës, përfshinë që të dy fjalitë e të njëjtit paragraf, Gjykata bazuar në Rregullin 59 (Përmirësimi i vendimeve) të Rregullores së Punës, nxjerr këtë:

## URDHËR

- I. Dispozitivi i Aktgjykimit në rastet KO216/22 dhe KO220/22, në pikën XI (a) të tij, korrigohehet si në vijim:  
*“a. pa formulimin “përshtatshmëria për emërim në pozitë dhe/apo” në fjalinë e parë të paragrafit 2; “përshtatshmërisë dhe/apo të” në fjalinë e dytë të paragrafit 2, si dhe “përshtatshmëria dhe/apo” në paragrafin 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik);”*
- II. Ky Urdhër do t'i bashkëngjitet Aktgjykimit fillestar të Gjykatës, në pajtim me paragrafin 3 të rregullin 59 të Rregullores së punës;
- III. Ky Urdhër do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË që ky Urdhër hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

### Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

*Gresa Caka-Nimani*  
Gresa Caka-Nimani

